

# LIGJ PËR MENAXHIM ME HEDHURINAT

TEKST I KONSOLIDUAR 1

**Teksti në**

**gjuhën**

**Maqedonase**

Закон за  
управување со  
отпадот

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Lënda e rregullimit

Me këtë nen rregullohet administrimi me hedhurinat; parimet dhe qëllimet për administrim me hedhurinat; planet dhe programet për administrim me hedhurinat; të drejtat dhe obligimet e personave juridikë dhe fizikë në lidhje me administrimin me hedhurinat; kërkesat dhe obligimet e personave juridikë dhe fizikë që prodhojnë produkte dhe paketime e që në fund të ciklit jetësor e ngarkojnë mjedisin jetësor; mënyrën dhe kushtet në të cilat mund të bëhet grumbullimi, transporti, trajtimi, depozitimi, përpunimi dhe largimi i hedhurinës, importi, eksporti dhe transiti i hedhurinave; monitorimi; sistemi informativ; financimi dhe mbikëqyrja mbi administrimin me hedhurinat.

### Neni 2

#### Zbatimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë me të gjitha llojet e hedhurinave në Listën e llojeve të hedhurinave, përvçe:

- 1) hedhurinës radioaktive;
- 2) hedhurinës e cila shkaktohet gjatë hulumtimit, eksplotimit, përpunimit dhe vendosjes së lëndëve të para minerale dhe punës së gurthyesve;
- 3) gazrave që lëshohen në atmosferë;
- 4) ujërave të ndotura, me përjashtim të hedhurinës së lëngshme;
- 5) hedhurinave e kafshëve (stërvina, plehra, jashtëqitja etj.), si dhe llojet tjera të materialeve të parrezikshme me prejardhje natyrore, të cilat mund të shfrytëzohen në bujqësi, dhe
- 6) eksploziveve të deaktivizuara dhe mjeteve dhe materjeve shpërthyese.

### Neni 3

#### Qëllimet e ligjit

Qëllimet e këtij ligji janë që të sigurohet:

- 1) evitimi dhe, në masë më të madhe të mundshme, zvogëlimi i sasisë së hedhurinës së krijuar;
- 2) shfrytëzimi i përbërjeve të përdorura të hedhurinës;
- 3) zhvillimi i qëndrueshëm, përmes ruajtjes dhe kursimit të resurseve natyrore;
- 4) pengimi i ndikimeve negative të hedhurinave në mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- 5) mënjanimi i hedhurinës, në mënyrë që është e kapshme për mjedisin jetësor, dhe
- 6) shkalla e lartë e mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e

njerëzve.

## Neni 4

### Veprimtari me interes publik

Menaxhimi me hedhurinën është veprimtari me interes publik, e cila bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullave të nxjerra në bazë të këtij ligji.

## Neni 5

### Zbatimi i dispozitave të ligjit

(1) Në menaxhimin me hedhurinën zbatohet edhe Ligji për mjedisin jetësor, nëse nuk është rregulluar më ndryshe me këtë ligj.

(2) Ndaj procedurave të vërtetuara me këtë ligj zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar më ndryshe.

## Neni 6

### Definicionet

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. **Hedhurinë** është secila materje ose lëndë që i takojnë kategorisë së hedhurinës nga neni 25 i këtij ligji që krijuesi ose poseduesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë ose nga ai kërkohet të hidhet

2. **Hedhurinë e rrezikshme** është hedhurina që sipas përbërjes së saj ose koncentrimit të substancave të rrezikshme mund të shkaktojë rrezik ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe që kanë një ose më shumë cilësi të rrezikshme, siç janë: eksploziviteti, riaktivizimi (oksidanset), ndezja, ngacmimi, helmimi, infeksioni, kancerogjenoziteti, mutagjenoza, helmimi për reproduksion, ekotoksiciteti dhe cilësi të lëshimit të gazrave helmuese gjatë kontaktit me ujin, ajrin ose thartirës, të vërtetuara në pajtim me këtë ligj ose rregull tjetër, ndërsa me këtë rast në Listën e llojeve të hedhurinave është theksuar dhe shënuar veçanërisht si hedhurinë e rrezikshme, duke e përfshirë edhe secilën hedhurinë që është përzier me hedhurinë të rrezikshme;

3. **Hedhurinë e parrezikshme** që nuk i posedon karakteristikat e hedhurinës së rrezikshme;

4. **Hedhurinë inerte** është hedhurina që është rezistente dhe nuk i nënshtrohet asnjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik ose biologjik, nuk tretet, nuk digjet dhe nuk reagon në mënyrë tjetër fizike ose kimike, nuk bioshkatërröhët, ndërsa hedhurina dhe lëngu i saj nuk ndikojnë në materie tjetër me të cilën vijnë në kontakt, në mënyrë më të cilën mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve me ç'rast sasia dhe përbajtja e substancave ndotëse në hedhurinë dhe ekotoksiciteti i kullimit detyrimisht duhet të jetë jo shumë e madhe që të mos e rrezikojë kualitetin e ujërave sipërfaqësore dhe/ose ujërave nëntokësore;

5. **Hedhurinë komunale** është hedhurina që krijohet nga personat fizikë nga amvisëritë (hedhurinat nga amvisëritë) dhe hedhurina komerciale. Hedhurina nga amvisëritë është hedhurina që çdo ditë grumbullohet nga amvisëritë, si dhe hedhurina e rrezikshme e grumbulluar veçanërisht nga amvisëritë, hedhurina kaba, hedhurina kopshtarie etj.

6. **Hedhurinë komerciale** është secila hedhurinë tjetër nga personat juridikë dhe fizikë gjatë kryerjes së veprimtarisë komerciale, industriale, zejtare, shërbyese, administrative etj, që sipas natyrës së tyre ose sipas përbërjes së tyre është i ngjashëm me hedhurinën e amvisërisë;

**7. Hedhurina industriale e parrezikshme** është hedhurina që krijohet gjatë proceseve prodhuese në industri dhe nuk përmban karakteristika të rrezikshme, ndërsa sipas cilësisë, përbërjes dhe sasisë dallohen nga hedhurina komunale;

**8. Hedhurinë bioshkaterruese** është secila hedhurinë që mund të jetë shkatërruese me procese shkatërruese anaerobe (pa praninë e oksigjenit) ose procese aerobe (me praninë e oksigjenit) shkatërruese siç është hedhurina nga ushqimi ose hedhurina kopshtarie, si dhe letra dhe kartoni;

**9. Hedhurinë vajrash** janë vajrat mineralë, sintetikë ose industrialë, në gjendjen e lëngët ose gjysmë të lëngët, të cilat janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin për të cilën fillimisht kanë qenë të dedikuar, e veçanërisht vajrat e përdorur për motorët me djegie të brendshme, vajrat për kutitë e ndërrimit, si dhe vajrat për turbinat dhe vajrat hidraulikë duke përfshirë edhe mbeturinat e yndyrshme nga rezervarët, përzierje nga uji dhe të yndyrave dhe emulsioneve;

**10. Bifenilët e polikloruar** janë bifenilët e polikloruar (në tekstin e mëtejmë: TPK), terfenili i polikloruar (në tekstin e mëtejmë: TPK), metani monometil-terakloro-difenil, metani monometil-dikloro-difenil, metani monometildibromo-difenil, si dhe çdo përzierje e cila përmban ndonjëren nga substancat e përmendura më lart, në sasi të përgjithshme prej mbi 0,005 përqindje të masës;

**11. Pajisja e cila përmban PHB** është pajisja e cila përmban ose ka përbajtur PHB si për shembull transformatorë, kondensatorë, kontejnerë dhe enë të tjera që përbajnjë hedhurina nga PHB, si dhe pajisje tjetër që përmban ose ka përbajtur PHB dhe që nuk ka qenë e dekontaminuar (në tekstin e mëtejmë pajisja);

**12. TPK të shfrytëzuar** janë të gjitha TPK të cilat krijuesi ose poseduesi i hedh, ka për qëllim t'i hedhë ose nga ai kërkohet t'i hedhë;

13. Jashtë fuqisë **[2]**

14. Jashtë fuqisë;

15. Jashtë fuqisë **[3]**

**16. Paketim** janë të gjitha prodhimet të bëra nga cili do qoftë material që shfrytëzohen për magazinim, mbrojtje, përdorim, dërgim dhe për prezantimin e mallrave, prej prodhuesit deri te shfrytëzuesi ose deri te konsumuesi, pa marrë parasysh se mallrat a janë lëndë të para ose të përpunuara. Paketimet mund të janë të vetme (shitëse ose paketime primare), përbledhës ose (grupore ose paketime sekondare), ose transportuese (paketime terciare).

**17. Hedhurinë nga paketimi** është secili paketim ose material për paketim që krijuesi ose poseduesi i hedh, ka për qëllim t'i hedhë ose nga ai kërkohet t'i hedhë, përvëç mbeturinave nga prodhimi;

**18. Automjete të shfrytëzuarra** janë automjetet funksioni përdorues i të cilave ka përfunduar dhe të cilat pronari i ka hedhur, ka për qëllim t'i hedhë ose nga ai kërkohet t'i hedhë;

**19. Hedhurinë medicinale** është hedhurinë që krijohet në institucionet medicinale dhe shëndetësore (stacionarë, spitale, poliklinika dhe ambulanca, ordinanca stomatologjike, shoqëritë veterinare etj.), që shkaktohet si prodhim i mjeteve të përdorura dhe materialeve gjatë diagnostikimit, shërimit, tretmanit dhe prevencës të sëmundjeve te njeriu dhe te kafshët;

**20. Hedhurinë nga institucionet shkencoro-hulumtuese** është hedhurina që është shkaktuar me përdorimin e mjeteve dhe materialeve gjatë veprimtarive hulumtuese dhe zhvilluese;

**21. Titaniumdioksid i hedhur** është secila mbeturinë e prodhimit,

përpunimit dhe përdorimit të titaniumdioksidit, që krijuesi e hedh, ka për qëllim t'i hedhë ose nga ai kërkohet t'i hedhë;

**22. Hedhurina nga azbesti** janë mbeturinat nga prodhimi, përpunimi dhe përdorimi i azbestit, si dhe substancat, materialet dhe prodhimet të cilat përbajnë azbest, të cilat krijuesi i hedh, ka qëllim t'i hedhë ose nga ai kërkohet t'i hedhë;

**23. Hedhurina gome** janë gomat nga automjete motorike (autobusë, kamionë, rimorkio, motoçikleta etj.), makina bujqësore, makina ndërtimtarie etj., funksioni përdorues i të cilave ka përfunduar, pronari ka ndërmend t'i hedhë, i hedh ose nga ai kërkohet t'i hedhë.

**24. Krijues** është personi juridik ose fizik i cili krijon hedhurina si rezultat i veprimtarisë ose aktivitetit që e bën (krijues i parë) dhe/ose secili person i cili bën operacione të trajtimit, përzierjes ose disa operacione tjera për shkak të së cilave ndryshon karakteri ose përbërja e hedhurinës së krijuar (krijues sekundar);

**25. Posedues** është krijuesi i hedhurinës ose personi juridik ose fizik që ka hedhurina në zotërim të tij.

**26. Prodhues** është personi juridik ose fizik i cili prodhon, importon, eksporton ose distribuon prodhime dhe/ose paketime që në fund të ciklit jetësor e ngarkojnë mjedisin jetësor.

**27. Veprimi me hedhurinën** është grumbullimi, selektimi, transportimi, trajtimi, përpunimi, vendosja dhe mënjanimi i hedhurinës, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen ndaj këtyre operacioneve, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, jeta dhe shëndeti i njerëzve gjatë kohës së punës të objekteve dhe të instalimeve për mënjanimin e hedhurinës dhe kujdesi për të pas përfundimit të punës së tyre;

**28. Dhënës i shërbimit** është ndërmarrja publike e themeluar nga komunat ose Qyteti i Shkupit dhe personi fizik dhe juridik, i cili ka lidhur marrëveshje për dhënien e shërbimit me interes publik me rëndësi lokale;

**29. Menaxhim me hedhurina** është shuma e aktiviteteve, masave dhe vendimeve të dedikuara për largimin dhe zvogëlimin e sasisë së hedhurinës së krijuar dhe ndikimi i saj negativ ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, duke përfshirë edhe veprimin me hedhurinën;

**30. Menaxhues i hedhurinave** është personi përgjegjës për menaxhim dhe/ose veprim me hedhurina te personi juridik apo fizik i cili krijon, posedon apo vepron me hedhurina;

**31. Përpunimi i hedhurinës** janë operacionet e caktuara me nenin 29 të këtij ligji, të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen materjet e përdorura dhe përbërjet e hedhurinës, kurse me këtë rast i përfshin procedurat për rishfrytëzim të hedhurinës, për riciklim dhe shfrytëzim të hedhurinës si burim i energjisë, duke përjashtuar djegien e hedhurinës për shkak të mënjanimit të saj definitiv;

**32. Përpunues i hedhurinës** është personi juridik ose fizik i cili e përpunon hedhurinën, pa marrë parasysh se a e ka krijuar hedhurinën ose përpunimin e bën për persona të tretë;

**33. Trajtim i hedhurinës** janë proceset mekanike, fizike, termike, kimike ose biologjike, duke e inkadruar edhe sortimin, me të cilin ndryshohen cilësitë e hedhurinës, me qëllim të zvogëlohen vëllimi i tij ose natyra e tij e rrezikshme, të lehtësohet përdorimi me të ose të bëhet më i përshtatshëm për përpunim;

**34. Reciklim i hedhurinës** është fitimi i substancës nga hedhurina (lëndët e para sekundare) dhe shfrytëzimi i tyre si zëvendësim për lëndët e para primare ose shfrytëzimin e cilësive të substancave të përbajtura në hedhurina për dedikimin e tyre të parë ose për dedikime tjera, duke

pëjashtuar shfrytëzimin e drejtpërdrejtë të energjisë së hedhurinës;

**35. Përdorimi i sërishëm** i hedhurinës është secila procedurë ose metodë me të cilat sigurohet që hedhurina të jetë e përdorshme përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin fillimisht ka qenë e dedikuar në pajtim me këtë ligj ose me dispozitë tjetër.

**36. Mënjanim i hedhurinës** janë operacionet nga neni 35 i këtij ligji që sigurojnë vendim definitiv për hedhurinën që sërisht nuk mund përdoret ose përpunohet, kurse me këtë rast nuk rrezikohet mjedisi jetësor, jeta dhe shëndeti i njerëzve;

**37. Grumbullimi** i hedhurinës nënkupton aktivitete të grumbullimit, klasifikimit dhe/ose përzierjes së hedhurinës për shkak të transportit;

**38. Grumbullues i hedhurinave** është personi fizik ose juridik që ka leje për kryerjen e veprimitarës për grumbullim dhe/ose transportim të hedhurinave, të marrë në pajtim me këtë ligj;

**39. Grumbullues individual** i hedhurinave është personi fizik që herë pas here apo rregullisht grumbullon dhe i shet hedhurina të parrezikshme personit juridik ose fizik, i cili posedon leje për kryerjen e veprimitarës magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave dhe për çfarë është i evidentuar te ai person juridik ose fizik;

**40. Stacion ringarkimi** është lokacioni ose objekti për depozitim të përkohshëm, përgatitje dhe ringarkim të hedhurinave të destinuara për transport deri në objekte të tjera ose instalime për depozitim, përpunim, trajtim ose mënjanim

**41. Deponim** nënkupton ruajtje të përkohshme të hedhurinës së krijuar në objekte të cilat i plotësojnë kushtet e parapara për atë qëllim, për periudhë më të shkurtër se tre vjet, nëse hedhurina e deponuar është dedikuar për trajtim dhe për përpunim, ose për periudhë më të shkurtër se një vit, nëse hedhurina është dedikuar për mënjanim;

**42. Plehërishte** është objekti i dedikuar për mënjanimin sipërfaqësor (mbi tokë) dhe nën tokë (në tokë) të bërllokut, duke përfshirë:

- lokacionet e brendshme për largim të hedhurinave ku krijuesi i hedhurinës e mënjanon hedhurinën e tij në vendin e krijimit,
- lokacionin e caktuar që shfrytëzohet vazhdimesht për depozitimin e përkohshëm të hedhurinave (për më shumë se një vit) me përjashtim të lokacioneve për stacione ringarkimi dhe lokacione për depozitimin e hedhurinave nga neni 33 paragrafi (4) i këtij ligji

**43. Deponimi** është operacion për mënjanimin e hedhurinës së deponive;

**44. Vendi grumbullues** është vendi ku janë vendosur një ose më shumë enë që shërbejnë për grumbullimin e masave të hedhurinave për shkak të dorëzimit të tyre në qendrën për grumbullim.

**45. Qendër e grumbullimit** nënkupton objekt ose pjesë e objektit me pajisjen e duhur për depozitimin dhe sortimin e përkohshëm të vajrave të përdorura dhe procedurat e tjera lidhur me dorëzimin e tyre për shkak të përpunimit ose mënjanimit

**46. Instalimi për djegie** është njësi teknike dhe pajisje e lëvizshme ose e palëvizshme për trajtim termik të hedhurinës, me ose pa shfrytëzimin e ngrohjes së fituar gjatë djegies, duke e inkuadruar edhe djegien e hedhurinës përmes oksidimit, si dhe proceseve tjera për trajtim termik, siç janë piroliza, gazifikimi ose plazma-proceset, me atë që substancat e fituara me trajtimin më pas digjen. Instalimi i inkuadron edhe lokacionin, të gjitha linjat për trajtim termik, objektet dhe fabrikat për pranim, deponim dhe për paratrajtim të hedhurinës në lokacion, sistemeve për shkarkim të hedhurinave, karburantit dhe ajrit, kazanit, fabrikave për trajtimin e gazrave të hedhura, për trajtim dhe për deponim të ujërave të hedhura dhe mbeturinat nga djegia, si dhe oxhaku, pajisjet dhe sistemet

për kontroll, shënim dhe monitorim të kushteve pér djegie.

**47. Instalimi pér djegie** është çdo stabiliment lëvizës ose jolëvizës qëllim i të cilët kryesishës është krijimi i energjisë ose prodhimi i prodhimeve materiale, me ç'rast hedhurina shfrytëzohet si karburant i rregullt ose plotësues, përkatësisht fabrikë në të cilën hedhurina trajtohet termikisht pér shkak të mënjanimit, duke inkuadruar edhe lokacionin, të gjitha linjat pér trajtim termik, objektet dhe fabrikat pér pranim, depojim dhe paratrajtim të hedhurinës në lokacion, sistemet pér ngarkim të hedhurinës, karburantit dhe ajrit, kazanit, aparateve pér trajtim të gazrave të hedhura, pér trajtim dhe depojim të ujërave të hedhura dhe mbeturinat nga djegia, si dhe oxhaku, aparatet dhe sistemet pér kontroll, shënim dhe monitorim të kushteve të djegies

**48. Organ kompetent pér kryerjen e punëve profesionale e mjedisit jetësor** është organi i themeluar me Ligjin pér mjedisin jetësor.

**49. Person fizik**, në kuptim të pikave 26, 28, 30 të këtij neni, është tregtari individ i cili në pajtim me Ligjin pér shoqëritë tregtare është regjistruar në regjistrin e gjykatës pér kryerjen e veprimitarisë përkatëse.

## Neni 7

### Përparësia gjatë menaxhimit me hedhurinën

(1) Krijuesit e hedhurinës janë të obliguar që, në masë të madhe të mundshme, t'i ikin krijimit të hedhurinës dhe t'i zvogëlojnë ndikimet e dëmshme të hedhurinës ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(2) Gjatë menaxhimit me hedhurina, pas seleksionimit të bërë paraprak, hedhurina duhet:

- të përpunohet përmes reciklimit, ripërdorimit ose në proces tjetër pér ekstraksionin e lëndëve të para sekundare, ose
- të shfrytëzohet si burim i energjisë.

## Neni 8

### Parimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor gjatë menaxhimit me hedhurinën

(1) Gjatë ndërmarrjes së veprimitarive dhe aktiviteteve të caktuara lidhur me menaxhimin me hedhurinat, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar të sigurojnë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët ndërmarrin aktivitete të caktuara në procesin e prodhimit, janë të obliguar të përdorin lëndë të para me përpunimin e të cilave krijohet më pak hedhurinë, të përdorin teknologji e cila siguron prodhim më të pastër dhe të cilat i kursejnë resurset natyrore, përkatësisht të prohjonjë prodhime të cilat gjatë prodhimit dhe përdorimit të tyre, nuk e ndotin mjedisin jetësor ose ndotjen ta zbresin në masën më të vogël të mundshme, në pajtim me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

(3) Gjatë përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinës doemos duhet të shfrytëzohen teknikat dhe teknologjitë e kapshme.

## Neni 9

### Parimi i kujdesit

Nëse, në bazë të njohurive bashkëkohore shkencoro-teknologjike, konstatohet se aktiviteti i caktuuar ose kryerja e ndonjë veprimitarive të caktuara gjatë menaxhimit me hedhurinën do të shkaktonte pasoja të dëmshme pér mjedisin jetësor, jetën dhe pér shëndetin e njerëzve, do të

ndërmerren masa dhe aktivitete adekuate për mënjanimin e rrezikut, para se të fitohen dëshmi shkencore se do të mund të vinte deri te pasojat e dëmshme.

## **Neni 10**

### **Parimi i afërsisë**

(1) Hedhurina duhet në radhë të parë të përpunohet në vendin ku është krijuar.

(2) Hedhurina e cila për shkak të shkaqeve të arsyeshme tekniko-teknologjike ose ekonomike nuk mund të përpunohet në vendin ku është krijuar, doemos duhet të bartet në përpunim ose të mënjanohet në vendet më të afërta të caktuara për atë dedikim përkatësisht në rajonin ku është prodhuar.

(3) Menaxhimi rajonal me mbeturina sigurohet me anë të miratimit, zhvillimit dhe aplikimit të dokumenteve strategjike dhe të planifikuara.

## **Neni 11**

### **Parimi i univerzalitetit të shërbimeve**

Universiteti i shërbimeve të cilat kanë të bëjnë në menaxhimin me hedhurinë duhet të sigurohet përmes:

- 1) jodiskriminimit;
- 2) qëndrueshmërisë së shërbimit;
- 3) kualitetit dhe efikasitetit;
- 4) transparencës;
- 5) çmimit të kapshëm ekonomik, dhe
- 6) mbulimit të tërësishëm të lëmit të kryerjes së shërbimit.

## **Neni 12**

### **Parimi “ndotësi paguan”**

Krijuesit dhe/ose poseduesit e hedhurinës janë të obliguar t'i bartin të gjitha harxhimet e shkaktuara gjatë menaxhimit me hedhurinat, duke inkudruar edhe harxhimet për grumbullimin, transportin, trajtimin, deponimin, mënjanimin, preventivën dhe monitorimin e hedhurinës, si dhe harxhimet për masat e sanimit për dëmin të cilin e ka shkaktuar hedhurina ose dëmi i cili do të ishte shkaktuar me hedhurinën.

## **Neni 12-a**

### **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit**

Prodhuesi ose importuesi i prodhimeve dhe paketimeve të cilat në fund të ciklit jetësor të prodhimeve që i prodhojnë, përkatësisht importojnë krijojnë mbeturina të cilat e ngarkojnë ambientin jetësor janë përgjegjës për menaxhim me mbeturinat që krijojen si rezultat i veprimtarive të tyre.

## **Neni 13**

### **Sistemi i kaucionit**

Gjatë blerjes së prodhimeve të caktuara, blerësi do të detyrohet të paguaj shpenzim të caktuar të çmimit të prodhimit, i cili do të kthehet atëherë kur blerësit do t'ia kthejë prodhimet e shfrytëzuara dhe paketimin, nëse prodhimet e shfrytëzuara dhe paketimi mund të përpunojen, ndërsa ajo është shënuar në mënyrë siç është përcaktuar në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitë tjetër.

**Neni 14****Parimet e përbashkëta**

Organet e administratës shtetërore, komunat dhe Qyteti i Shkupit, edhe personat fizikë dhe juridikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinën janë të obliguar që gjatë marrjes së masave dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me menaxhimin me hedhurinën të udhëhiqen sipas parimit dhe dispozitave nga nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, dhe 13 nga ky ligj, si dhe sipas parimeve të theksuara në Ligjin për mjedisin jetësor.

## **II. STRATEGJIA, PLANET DHE PROGRAMET ME HEDHURINËN**

**Neni 15****Planifikimi gjatë menaxhimit me hedhurinën**

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë, komunave dhe të Qytetit të Shkupit, si dhe personat fizikë dhe juridikë, të cilët administrojnë me hedhurinën, në pajtim me këtë ligj, janë të obliguar që të miratojnë dhe të zbatojnë dokument strategjk, planor për menaxhimin me hedhurinën, me qëllim të sigurohet:

- 1) mbrojtja e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve;
- 2) realizimi i qëllimeve dhe kahjeve të caktuara në Planin nacional ekologjik;
- 3) realizimi i parimeve të përgjithshme dhe kahjeve për menaxhim me hedhurinën;
- 4) themelimi i rrjetit të integruar nacional të instalimeve dhe instalimeve për përpunimin dhe për mënjanimin e hedhurinës, dhe
- 5) realizimi i obligimeve lidhur me menaxhimin me hedhurinën, të cilat Republika e Maqedonisë i ka marrë në nivel ndërkontëtar.

(2) Në procedurën për miratimin e strategjive, planeve dhe programeve të parapara me këtë ligj, bëhet vlerësimi strategjik i ndikimit ndaj mjedisit jetësor, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

**Neni 16****Strategjia e menaxhimit me hedhurinën**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Organit të administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor, miraton Strategji për menaxhim me hedhurinën.

(2) Me strategjinë për menaxhim me hedhurinën nga paragrafi (1) i këtij nenit përcaktohen:

- 1) kahjet themelore për menaxhim me të gjitha llojet e hedhurinës;
- 2) përmirësimi i gjendjes së përgjithshme në menaxhim e përgjithshëm;
- 3) masat e nevojshme juridike për realizimin e planit për menaxhim me hedhurinën;
- 4) nevojat afatgjate të Republikës së Maqedonisë në lëmin e menaxhimit me hedhurinën;
- 5) qasja strategjike drejt zhvillimit të vetëdijes publike dhe edukimit lidhur me menaxhimin me hedhurinën, dhe
- 6) çështje tjera të rëndësishme për zhvillimin e menaxhimit me hedhurinën.

(3) Strategjia nga paragrafi (1) i këtij nenit ka të bëjë me periudhën prej dy mbëdhjetë vjetësh.

**Neni 17**

## **Plani për menaxhim me hedhurinën e Republikës së Maqedonisë**

(1) Për realizimin e Strategjisë për menaxhim me hedhurinën, Organi i administratës shtetërore për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, miraton Plan për menaxhim me hedhurinën e Republikës së Maqedonisë.

(2) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet për periudhën prej dhjetë vjetësh dhe përmban veçanërisht:

- 1) përkrimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese lidhur me menaxhimin me hedhurinën;
- 2) parashikimin e gjendjeve të ardhshme lidhur me menaxhimin me hedhurinën;
- 3) kahet dhe qëllimet në lidhje me administrimin me hedhurina duke përfshirë edhe orarin kohor të realizimit të tyre;
- 4) realizimi i masave, aktiviteteve dhe mënyra për arritjen e qëllimeve për veprim me lloje të veçanta të hedhurinave, orari kohor dhe vëllimi i realizimit të tyre;
- 5) masat stimulative për realizimin e aktiviteteve për mënjanimin dhe përvogëlimin e sasisë së hedhurinës së krijuar, si dhe rishfrytëzimin, riciklimin dhe shfrytëzimin e hedhurinës si burim i energjisë;
- 6) mënyrën për mënjanimin e hedhurinës që nuk mund t'i iket dhe të përpunohet;
- 7) përcaktimin e llojit dhe të sasisë së hedhurinës sipas të cilave përcaktohet obligimi për personat juridikë dhe fizikë të hartojnë programe për menaxhim me hedhurinën;
- 8) realizimin e sistemit për monitorim gjatë menaxhimit me hedhurinën;
- 9) masat konkrete dhe aktivitetet për zvogëlimin e përbërjes bioshkatërruese në hedhurinë të dedikuar për mënjanimin dhe orarin dhe vëllimin e realizimit të tyre;
- 10) përcaktimin e nevojave të Republikës së Maqedonisë për ndërtimin e objekteve dhe instalimeve për përpunimin dhe për mënjanimin e hedhurinës duke përfshirë masat dhe afatet për realizim;
- 11) lokacioneve dhe instalimeve për mënjanimin e hedhurinës;
- 12) të dhënat përrjetin e integruar nacional për mënjanimin e hedhurinës dhe instalimet për përpunimin e hedhurinës;
- 13) kushtet teknike dhe tjera të cilat duhen të plotësohen gjatë menaxhimit me hedhurinën;
- 14) masat për sanim të deponive të egra dhe të rajoneve të ndotura;
- 15) aktivitetet të cilat ndërmerren nga ana e njësive të vetmenaxhimit lokal lidhur me menaxhimin me hedhurinën;
- 16) caktimi i rajoneve për menaxhim me hedhurina
- 17) masat për edukim dhe për ngritjen e vetëdijes publike për menaxhim me hedhurinën;
- 18) vlerësimin e harxhimeve për operacionet e përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinës, dhe
- 19) instrumentet financiare për realizimin e planit për menaxhim me hedhurinën.

(3) Organ kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor është përgjegjës për realizimin e Planit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Organi kompetent nga paragrafi (3) i këtij neni, mundet në çdo dy vite të propozojë ndryshime dhe plotësime të Planit për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë.

(5) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor çdo dy vjet nga fillimi i realizimit të Planit për administrim me hedhurina në Republikën e Maqedonisë paraqet raport për realizimin e Planit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për të cilën paraprakisht ka marrë pëlgim nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

### **Neni 18**

## **Planet për menaxhim me hedhurinën e komunave dhe të Qytetit të Shkupit**

(1) Për realizimin e Planit për menaxhim me hedhurinën e Republikës së Maqedonisë, këshilli komunës dhe Qytetit të Shkupit, miratojnë plan për menaxhim me hedhurinën e komunës përkatësisht të Qytetit të Shkupit, me propozim të prefektit të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

(2) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet për periudhën jo më të vogël se 3 vjet, por jo më gjatë së 6 vjet.

(3) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht i përmban të dhënat e planit të Republikës së Maqedonisë nga neni 17 paragrafi (2) për territorin e komunës dhe Qytetit të Shkupit.

(4) Prefekti i komunës dhe Qytetit të Shkupit janë përgjegjës për realizimin e Planit nga paragrafi 1 i këtij neni.

(5) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni para se të miratohet nga këshilli i komunave dhe nga qyteti i Shkupit, kryetari i komunave dhe i qytetit të Shkupit e dorëzon për miratim te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

### **Neni 18-a**

#### **Planet rajonale**

(1) Këshillat komunale dhe këshilli i qytetit të Shkupit, me propozim të këshillit ndërkomunal për menaxhim me hedhurina nga neni 23-b i këtij ligji, miratojnë plan rajonal për menaxhim me hedhurina për rajonin për menaxhim me hedhurina të përcaktuara me Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejmë: plani rajonal).

(2) Me planin rajonal rregullohen dhe harmonizohen qëllimet e përbashkëta në menaxhimin me hedhurina të komunave dhe qytetit të Shkupit në nivel rajonal, në pajtim me Strategjinë për menaxhim me hedhurina dhe Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë.

(3) Plani rajonal miratohet për periudhë prej dhjetë vitesh.

(4) Këshilli ndërkomunal për menaxhim me hedhurina nga neni 23-b i këtij ligji, mundet sipas nevojës çdo dy vite të propozojë ndryshimin dhe plotësimin e planit rajonal.

(5) Plani rajonal para se të miratohet nga ana e këshillave komunale, respektivisht këshilli i qytetit të Shkupit, dorëzohet për miratim te organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton përbajtjen e planit rajonal.

(7) Këshilli ndërkomunal për menaxhim me hedhurina nga neni 23-b i këtij ligji, në çdo dy vite nga fillimi i realizimit të planit rajonal parashtron raport për realizimin e planit rajonal te këshilli komunal, respektivisht këshilli i qytetit të Shkupit.

### **Neni 19**

#### **Programe për menaxhim me hedhurinën**

(1) Realizimi i planit të Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën të cilat i miratojnë:

- 1) Organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor,
- 2) këshilli i komunave dhe Qytetit të Shkupit, me propozim të prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, dhe
- 3) personat juridikë dhe fizikë të cilët administrojnë hedhurinën, të përcaktuar në pajtim me këtë ligj dhe dispozita tjera.

(2) Programet nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të janë në pajtim me Planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën dhe Planin për menaxhim me hedhurinën të komunave dhe Qytetit të Shkupit, me ç'rast programet nga pikat 2 dhe 3 nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të janë në pajtim edhe me programin nga pika 1 e paragrafit (1) i këtij neni.

(3) Në programet nga paragrafi (1) i këtij neni do të përcaktohen burimet e financimit të masave dhe aktiviteteve, si dhe instrumentet për realizimin e programeve për menaxhim me hedhurinën.

(4) Programet nga paragrafi (1) pika 1 dhe 2 miratohen për periudhën prej një viti, ndërsa programet nga paragrafi (1) pika 3 miratohen për periudhën prej tre vjetësh.

(5) programet nga paragrafi (1) pika 2 të këtij neni veçanërisht i përfshinë të dhënat e Programit nga neni 20 paragrafi (2) të këtij ligji përvèç pikës 11.

## Neni 20

### **Përbajtja e programit për menaxhim me hedhurinën, të cilin e miraton organi kompetent për kryerjen e çështjeve profesionale në mjedisin jetësor**

(1) Me programin për menaxhim me hedhurinën, që e miraton Organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor me propozim të organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, përcaktohen masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren nga ana e subjekteve të cilat administrojnë me hedhurinën, si dhe masat konkrete për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në menaxhimin me hedhurinën dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

(2) Programi nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht përmban:

- 1) vlerësimin e llojit dhe të sasisë së hedhurinës që krijohet në Republikën e Maqedonisë në nivel vjetor;
- 2) masat dhe aktivitetet për mënjanimin dhe përvogësimin e sasisë së hedhurinës së krijuar;
- 3) mënyrën e realizimit të obligimeve të personave fizikë dhe juridikë, të cilët administrojnë me hedhurinën;
- 4) masat dhe aktivitetet për seleksionimin e hedhurinës, duke e inkuduar edhe ndarjen e përbërjeve të rrezikshme nga hedhurina;
- 5) masat dhe aktivitetet për nxitjen e kompostimit të hedhurinës bioshkatërruese;
- 6) mënyrat për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve lidhur me menaxhimin e hedhurinës;
- 7) realizimin e obligimeve përvogësimin e sasisë së hedhurinës bioshkatërruese që mënjanohet në deponitë;
- 8) mënyrën e punës së objekteve dhe instalimeve përpunimin dhe përmënjanimin e hedhurinës;
- 9) mënyrën e funksionimit të rrjetit integrues përpunimin dhe përmënjanimin e hedhurinës;
- 10) realizimin e monitorimit dhe të sistemit informativ në lëmin e menaxhimit me hedhurinën;
- 11) realizimin e masave për realizimin e importit, eksportit dhe transitit të hedhurinës nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe
- 12) masat tjera të rëndësishme për realizimin e planit për menaxhim me

hedhurinën.

(3) Programin nga paragrafi (1) i këtij neni për vitin e ardhshëm, Organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet e mjedisit jetësor është i obliguar ta bëjë të kapshëm për opinionin, gjatë muajit shtator në muajin në vijim.

## Neni 21

### **Programet e personave fizikë dhe juridikë për menaxhim me hedhurinën**

(1) Personat juridikë dhe fizikë që në kryerjen e veprimtarisë së tyre gjatë një viti kalendarik krijojnë më shumë se 200 kilogramë hedhurina të rrezikshme dhe/ose më shumë se 150 tonë hedhurinë jo të rrezikshme janë të detyruar të përgatisin dhe të realizojnë Program për administrim me hedhurina, në pajtim me nenin 19 të këtij ligji.

(2) Personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që prefektëve të komunave dhe Qytetit të Shkupit t'ua paraqesin programet për menaxhim me hedhurinën për periudhën e ardhshme më së shpejti gjatë muajit shtatorë në vitit në vijim.

(3) Personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (1) i këtij neni, programet për menaxhim me hedhurinën i paraqesin edhe në organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet e lëmisë së mjedisit jetësor.

(4) Programi i personave fizikë dhe juridikë për menaxhim me hedhurinën veçanërisht përban:

- 1) nivelin konstant të krijimit të hedhurinës, sipas llojeve, sasive dhe burimeve të krijimit dhe parashikimit të llojit dhe sasisë së hedhurinës që krijohet gjatë vitit të ardhshëm;
- 2) masat ekzistuese dhe të planifikuara teknike, organizative dhe masa tjera për mënjanim dhe për zvogëlimin e krijimit të hedhurinës dhe zvogëlimin e démit të hedhurinës;
- 3) të dhënat për kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara organizativo-teknike të personave fizikë dhe juridikë;
- 4) masat ekzistuese dhe të planifikuara teknike, organizative dhe masat tjera (duke inkadruar edhe përfshirjen investuese) për veprim me hedhurinën (selektimin, trajtimin, përpunimin, shfrytëzimin e energjisë, deponimin dhe mënjanimin);
- 5) afatet për realizimin e kërkesave të veçanta nga plani për administrim me hedhurina dhe afatet për realizim të fazave të veçanta nga plani;
- 6) korniza kohore për realizimin e standardeve që kanë të bëjnë me përbajtjen e përpunimit të produkteve dhe paketimeve të veçanta dhe përputhshmëria e tyre për përdorim ose përpunim dytësor duke përfshirë edhe riciklimin
- 7) masat për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i hedhurinës ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve;
- 8) aprovimin e sistemeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor. (ISO 14000 etj.)
- 9) aktivitetet e planifikuara për edukimin dhe përfshirjen e kuadrit që administron me hedhurinën, dhe
- 10) masat tjera që kanë rëndësi për realizimin e programit për menaxhim me hedhurinën.

(5) Organet nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni nga personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (1) të këtij neni mund të kërkojnë ndryshime dhe plotësimë të programeve të tyre, kur do të konstatojnë se ato janë në kundërshtim me Planin për menaxhim me hedhurinën të Republikës së Maqedonisë, si dhe me Programin për menaxhim me hedhurinën nga nen 20 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji.

## Neni 22

## **Obligimet e komunave dhe Qytetit të Shkupit për menaxhim me hedhurinën komunale dhe hedhurinën tjetër të parrezikshme**

(1) Këshilli i komunave dhe këshilli i Qytetit të Shkupit, në pajtim me planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën dhe planin rajonal, janë të obliguar të:

- 1) kujdesen për pastërtinë publike dhe për hedhurinën e lëshuar;
- 2) miratojnë akte me të cilat do ta rregullojnë selektimin, grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve tjera të hedhurinës së parrezikshme;
- 3) bashkëpunojnë dhe/ose bashkohen me komunat tjera dhe Qytetin e Shkupit lidhur me menaxhimin me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të hedhurinës të parrezikshme;
- 4) realizojnë projekte dhe ndërmarrin aktivitete investuese për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme me menaxhimin me hedhurinën, dhe
- 5) vaprojnë në pajtim me rregullat e përgjithshme për veprim me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të hedhurinës.

(2) Dy ose më tepër komuna, mund të miratojnë program të përbashkët për menaxhim me hedhurinën dhe me llojet e hedhurinave tjera.

### **Neni 23**

#### **Informimi për realizimin e programeve për menaxhim me hedhurinën**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor është i obliguar që çdo vit gjatë muajit mars të vitit në vijim, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë t'i japë raport për realizimin e Programit për menaxhim me hedhurinën për vitin e kaluar.

(2) Prefekti i komunave dhe prefekti i Qytetit janë të obliguar që çdo vit Organit të administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor t'i paraqesin raport për realizimin e programeve të veta për menaxhimin me hedhurinën për të cilat paraprakisht është marrë pëlqim nga këshilli i komunave dhe këshilli i Qytetit të Shkupit.

(3) Raportet nga paragrafi (2) të këtij neni dërgohen deri me 28 shkurt gjatë vitit në vijim për programin e vitit të kaluar.

(4) Personat juridikë dhe fizikë nga neni 21 parografi (1) janë të obliguar t'i paraqesin raport vjetor për realizimin e programeve të tyre prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, më së voni deri 31 janar gjatë vitit në vijim për programin e vitit të kaluar.

(5) Personat fizikë dhe juridikë nga neni 21 parografi (1) të cilët administrojnë me hedhurinë të rrezikshme raportet nga paragrafi (4) të këtij neni ia paraqesin organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(6) Në bazë të rezultateve të fituara nga raportet për realizimin e programeve për menaxhim me hedhurina, Organi i administratës shtetërore nga lëmi i mjedisit jetësor mund të bëjë ndryshime dhe plotësime të Planit për menaxhim me hedhurinën të Republikës së Maqedonisë.

### **II-a. MENAXHIMI ME HEDHURINA NË NIVEL RAJONAL**

#### **Neni 23-a**

## **Menaxhimi me hedhurina në nivel rajonal**

(1) Për nxitjen dhe zhvillimin e menaxhimit me hedhurina në nivel rajonal në pajtim me Strategjinë për menaxhim me hedhurina dhe Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë, këshillat komunale dhe këshilli i qytetit të Shkupit në rajonin adekuat për menaxhim me hedhurina, miratojnë vendim për lidhjen e marrëveshjes për bashkim për vendosjen e sistemit për menaxhim me hedhurina në nivel rajonal (në tekstin e mëtejmë: menaxhim rajonal).

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni në veçanti rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të komunave dhe qytetit të Shkupit në bashkimin për vendosjen dhe sigurimin e kushteve përfunksionimin e menaxhimit rajonal dhe zhvillimit të sistemit rajonal nga paragrafi (3) i këtij neni, mënyra e bashkimit të mjeteve financiare, mjetet materiale dhe të tjera për realizimin e kërkesave të bashkimit, mënyra e miratimit të vendimeve në rastet e mosharmonizimit në mes të komunave dhe qytetit të Shkupit për çështje të caktuara në lidhje me funksionimin e menaxhimit rajonal, si dhe çështje tjera me interes të përbashkët për organizimin dhe zbatimin e menaxhimit rajonal.

(3) Me menaxhimin rajonal vendoset dhe organizohet sistemi rajonal për menaxhim me hedhurina (në tekstin e mëtejmë: sistemi rajonal) që në veçanti përbëhet nga deponia rajonale për hedhurina dhe/ose objekte dhe instalime tjera për veprim me hedhurina.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, këshilli komunal dhe këshilli i qytetit të Shkupit, mund të vendl që të bashkohet me rajon tjetër për menaxhim me hedhurina, i ndryshëm nga rajoni i përcaktuar me Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë, nëse kjo nuk e pengon, respektivisht nuk e vështirëson procedurën e vendosjes dhe/ose organizimit dhe funksionimit të sistemit rajonal në rajonin adekuat për menaxhim me hedhurina, si dhe me pëlqim të marrë paraprakisht nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Komunat dhe qyteti i Shkupit që janë bashkuar për vendosjen e menaxhimit rajonal janë të obliguar që ta njoftojnë organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe t'i dorëzojnë aktet për bashkimin e vendosur, në afat prej 30 ditësh nga dita e bashkimit.

(6) Në rastet kur komunat, respektivisht qyteti i Shkupit nuk do të bashkohen ose lidhin marrëveshje sipas paragrafit (2) të këtij neni, e me këtë prishen qëllimet për menaxhim me hedhurina, të përcaktuara në Strategjinë për menaxhim me hedhurina dhe Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për punët e mjedisit jetësor, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim me të cilin do ta përcaktojë rajonin me komunat për vendosjen e sistemit rajonal, si dhe afatin në të cilin komunat duhet të zbatojnë vendimin për bashkim në sistemin rajonal.

### **Neni 23-b**

#### **Këshilli ndërkomunal për menaxhim me hedhurina**

(1) Për zbatimin e menaxhimit rajonal, zbatimit të planit rajonal nga neni 18-a i këtij ligji, dhe realizimit të marrëveshjes nga neni 23-a paragrafi (1) i këtij ligji, formohet Këshill ndërkomunal për menaxhim me hedhurina (në tekstin e mëtejmë: këshilli).

(2) Këshilli formohet për çdo rajon të menaxhimit me hedhurina.

(3) Mbledhjen konstitutive të këshillit e thirr kryetari i komunës së njësisë së vetadministrimit lokal me numër më të madh të banorëve në rajonin e menaxhimit me hedhurina.

(4) Anëtarë të këshillit janë kryetarët e komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit që e kanë lidhur marrëveshjen nga neni 23-a paragrafi (1) i këtij ligji, ose persona tjerë të autorizuar nga kryetarët e komunave dhe qytetit të Shkupit.

(5) Me këshillin kryeson kryesuesi që zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit, për periudhë prej dy vitesh, periudhë që nuk e tejkalon mandatin si kryetar komune.

(6) Këshilli vendos në seanca për mbajtjen e të cilave nevojitet prania e së paku gjysmës së anëtarëve të këshillit.

(7) Vendimet e këshillit miratohen me shumicën e dy të tretave nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

## Neni 23-v

### Kompetencat e këshillit

Këshilli i kryen punët, si vijojnë:

- 1) e përcakton projektplanin rajonal për menaxhim me mbeturina;
- 2) i përcjell, vlerëson dhe koordinon aktivitetet për zbatimin e planit rajonal;
- 3) i miraton propozimprojektet për realizimin e planit rajonal, si dhe projektet tjera me interes për zhvillimin e sistemit rajonal;
- 4) propozon te këshilli komunal dhe këshilli i qytetit të Shkupit miratimin e vendimeve për çështje që janë të lidhura me veprimtaritë dhe shërbimet për veprim me hedhurina që janë në kompetencë të tyre, në pajtim me këtë ligj, ligjin për koncesione dhe partneritet publik privat, furnizimet publike, si dhe çështje tjera në lidhje me zhvillimin e menaxhimit rajonal dhe çështje tjera në kompetencë të tyre;
- 5) e përcakton strukturën e instalimeve dhe objekteve për veprim me hedhurina, si dhe strukturën e zhvillimit të sistemit rajonal;
- 6) i propozon këshillit komunal dhe këshillit të qytetit të Shkupit vendosjen e metodologjisë për njësinë e çmimit për shërbimet e kryera dhe kompensimet tjera në kuadër të sistemit rajonal;
- 7) miraton propozime për çështje në lidhje me menaxhimin me hedhurina në kuadër të sistemit rajonal;
- 8) e miraton projektraportin vjetor për realizimin e planit rajonal;
- 9) e miraton buxhetin e qendrës rajonale për menaxhim me hedhurina;
- 10) e miraton raportin vjetor për punën e qendrës rajonale për menaxhim me hedhurina;
- 11) e miraton programin vjetor për punën e qendrës rajonale për menaxhim me hedhurina;
- 12) i koordinon aktivitetet për zbatimin e projekteve investuese për nxitjen dhe zhvillimin e menaxhimit rajonal me hedhurina komunale dhe lloje tjera të hedhurinave të parrezikshme, të financuar nga fondet e Bashkimit Evropian, burime tjera ndërkombëtare, si dhe nga buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- 13) e kryen zgjedhjen e operatorit të sistemit rajonal;
- 14) i miraton propozim-marrëveshjet për dhëni e shërbimeve dhe sigurimin e kapaciteteve për veprim me hedhurina komunale dhe hedhurina tjera në kuadër të sistemit rajonal;
- 15) e kryen zgjedhjen e drejtorit të qendrës rajonale;
- 16) e iniciacion shqyrtimin e çështjeve në lidhje me sistemin rajonal për të cilin është i domosdoshëm koordinimi në mes të komunave ose qytetit të Shkupit dhe partnerët e sektorit privat dhe civil;
- 17) e siguron koordinimin e aktiviteteve të komunave ose qytetit të Shkupit, agjencive dhe institucioneve shtetërore, shoqatave të qytetarëve në kuadër të sistemit përkatës rajonal adekuat dhe
- 18) kryen edhe veprimitari tjera në fushën e menaxhimit të hedhurinave në sistemin përkatës rajonal, që do t'ia delegojë Këshillit komunal dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit.

## Neni 23-g

## **Mënyra e bashkëpunimit të këshillit**

(1) Mënyra e punës së këshillit rregullohet me rregullore.

(2) Çështjet profesionale administrative dhe teknike, planifikimin, udhëheqjen e projekteve investuese dhe punët me rëndësi të menaxhimit rajonal, zbatimin e planit rajonal dhe zhvillimin e sistemit të monitorimit të vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe çështje tjera me rëndësi për zhvillimin e menaxhimit rajonal, i kryen Qendra Rajonale për Menaxhim me Hedhurina.

### **Neni 23-d**

#### **Qendra rajonale për menaxhim me hedhurina**

(1) Qendra rajonale për menaxhim me hedhurina (në tekstin e mëtejmë: qendra rajonale) themelohet nga komunat ose qyteti i Shkupit nga rajoni përkatës për menaxhim me hedhurina që e kanë lidhur marrëveshjen nga nenii 23-a paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Qendra rajonale themelohet për çdo rajon të menaxhimit me hedhurina.

(3) Me aktin për themelimin e qendrës rajonale rregullohet organizimi, puna dhe mënyra e financimit të tij.

(4) Qendra rajonale e ka cilësinë e personit juridik.

(5) Selia e qendrës rajonale është në njësinë e vetadministrimit lokal me numër më të madh të banorëve në rajonin përkatës për menaxhim me hedhurina, nëse me aktin e themelimit nga paragrafi (3) i këtij nenii, nuk është e përcaktuar ndryshe.

### **Neni 23-gj**

(1) Qendra rajonale ka drejtor që zgjidhet përmes konkursit publik.

(2) Drejtori i qendrës rajonale zgjidhet nga këshilli për periudhë prej katër vitesh.

(3) Drejtor mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet si vijojnë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë të kryer arsimin e lartë,
- të njohë aktivisht një prej gjuhëve botërore,
- të ketë aftësi profesionale dhe organizative dhe
- të ketë së paku pesë vite përvojë pune nga sfera e menaxhimit me mjedisin jetësor ose menaxhimit me hedhurina.

### **Neni 23-e**

(1) Qendra rajonale i kryen punët, si vijojnë:

- 1) e përpilon planin rajonal;
- 2) përpilon dhe propozon projekte dhe aktivitete tjera për realizimin e planit rajonal si dhe projekte tjera me interes për zhvillimin e sistemit rajonal;
- 3) realizon dhe menaxhon me projekte dhe ndërmerr aktivitetet tjera në lidhje me zbatimin e planit rajonal për zhvillimin e sistemit rajonal;
- 4) siguron marrëveshje dhe kapacitete kontraktuese për veprim me hedhurina komunale dhe hedhurina tjera në kuadër të sistemit rajonal;
- 5) përgatit dhe zbaton procedura për zgjedhjen e operatorit të sistemit rajonal dhe propozon zgjedhje të operatorit të sistemit rajonal;
- 6) realizon dhe menaxhon me projekte investuese për nxitje dhe zhvillim të menaxhimit rajonal me hedhurina komunale dhe lloj tjetër hedhurinash të parrezikshme, të finançuara nga fondet e Bashkimit Evropian, burim tjetër ndërkombëtar, si dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- 7) kryen mbikëqyrje mbi vëllimin dhe kualitetin e shërbimeve të kryera në

kuadër të sistemit rajonal;

- 8) përgatit raport për realizimin e planit rajonal;
- 9) përgatit raport vjetor për punën e qendrës rajonale;
- 10) përgatit program vjetor për punën e qendrës rajonale;
- 11) sipas nevojës mund t'i koordinojë aktivitetet lidhur me zbatimin e Programit për menaxhim me hedhurinë nga nenet 19 paragrafi (1) pika 2 dhe 22 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 12) u siguron ndihmë profesionale dhe teknike komunave ose Qytetit të Shkupit nga rajoni përkatës për menaxhim me hedhurina, gjatë përgatitjes së programeve dhe projekteve për menaxhim me hedhurina;
- 13) mban bazë të të dhënave për menaxhim me hedhurina në nivel rajonal dhe u siguron informata palëve të interesuara për çështje të lidhura me sistemin rajonal si dhe aktivitete tjera të komunikimit me publikun;
- 14) përpilon propozim-vendime për çështje të lidhura me veprimtaritë dhe shërbimet e veprimit me hedhurina nga neni 23-v pika 4 të këtij ligji, si dhe çështje tjera për zhvillimin e menaxhimit rajonal dhe
- 15) kryen edhe punë tjera nga sfera e menaxhimit me hedhurina në sistemin përkatës rajonal që do t'ia ngarkojë këshilli.

(2) Në rastet kur Qendra rajonale nuk i plotëson qëllimet e përcaktuara në planin rajonal nga neni 18-a të këtij ligji në periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, e me këtë prishen qëllimet për menaxhim me hedhurina të përcaktuara me Strategjinë për menaxhim me hedhurina dhe Planin për menaxhim me hedhurina të Republikës së Maqedonisë, si dhe nuk i plotëson obligimet e përcaktuara në mënyrë ligjore në periudhë më të gjatë se tre muaj, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësorë, miraton aktvendim për vendosje nën administrim të detyrueshëm të përkohshëm (sekuestër).

(3) Vendimi nga paragafi (2) i këtij neni veçanërisht i përmban:

- 1) shkaqet për të cilat Qendra rajonale vendoset nën administrim të detyrueshëm të përkohshëm;
- 2) personin juridik që e kryen administrimin e detyrueshëm të përkohshëm;
- 3) afatin në të cilin kryhet administrimi i detyrueshëm i përkohshëm dhe
- 4) kushtet e administrimit të detyrueshëm të përkohshëm dhe mënyra e punës.

(4) Administrimin e detyrueshëm të përkohshëm nga paragafi (2) i këtij neni mund ta kryejë personi juridik i autorizuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Personi nga paragafi (4) i këtij neni përgjigjet për aktet dhe veprimtaritë e marra për kohëzgjatjen e administrimit të detyrueshëm të përkohshëm.

(6) Kundër aktvendimit nga paragafi (2) i këtij neni, Qendra rajonale në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga paragafi (2) i këtij ligji, ka të drejtë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Ankesa nuk prolongon zbatimin e aktvendimit.

(8) Pas skadimit të afatit të caktuar me aktvendimin nga paragafi (2) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësorë, miraton aktvendim me të cilin e shfuqizon aktvendimin nga paragafi (2) i këtij neni.

(9) Personi juridik nga paragafi (4) i këtij neni që të jetë i autorizuar duhet të ketë të punësuar së paku tre persona me arsim të lartë nga të cilët njëri duhet të posedojë vërtetim për provimin e dhënë profesional për Menaxhues me hedhurina, si dhe të ketë të angazhuar person që e ka dhënë provimin për vlerësues të vlerës së të mirave dhe ndikimeve mbi

mjedisin jetësor dhe një person që e ka të kryer fakultetin juridik ose fakultetin ekonomik me së paku pesë vjet përvojë në sferën e menaxhimit me hedhurina.

(10) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht i përcaktion kushtet që duhet t'i plotësojë personi juridik nga paragrafi (4) i këtij neni, si dhe mënyrën e zgjedhjes së personit juridik për kryerje të administrimit të detyrueshëm.

(11) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i regjistrion në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni dhe aktvendimin nga paragrafi (8) i këtij neni.

### **III. VEPRIMI ME HEDHURINËN**

#### **Neni 24**

##### **Rregullat për veprim me hedhurinën**

Veprimi me hedhurinën doemos duhet të realizohet me vëmendje të përkushtuar dhe në mënyrë me të cilën i iket:

- 1) rrezikimit të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve;
- 2) ndotjes së ujërave, ajrit dhe tokës mbi kufijtë e përcaktuara;
- 3) krijimit të zhurmës dhe erës së pakëndshme;
- 4) zhdukjes së kushteve natyrore për jetën e kafshëve dhe të bimëve;
- 5) shkatërrimit të rajoneve të mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë së mbrojtur kulturore, dhe
- 6) fëlliqjes dhe mosrregullimit të objekteve dhe hapësirës në zonat urbane dhe në rajonet jashtë zonave urbane.

#### **Neni 24-a**

##### **Mënjanimi i pakontrolluar i hedhurinave**

Ndalohet lënia, hedhja, lëshimi, ndezja ose mënjanimi i pakontrolluar i hedhurinave.

#### **Neni 25**

##### **Listë e hedhurinave**

(1) Kategoritë e hedhurinave, në aspekt të këtij ligji, janë:

- 1) mbeturinat nga prodhimi ose nga konsumimi i prodhimeve që nuk janë specifikuar më poshtë;
- 2) prodhimet të cilat nuk i përbushin specifikacionet e përcaktuara për kualitet;
- 3) prodhimet të cilave u ka kaluar afati për shfrytëzim;
- 4) materialet të cilat kanë qenë të derdhura, humbura ose që kanë pësuar fatkeqësi tjetër, duke përfshirë edhe të gjitha materialet, pajisjet etj., të cilat janë ndotur si rezultat i asaj fatkeqësie;
- 5) materialet të cilat janë të ndotur ose përlyer si rezultat i veprimeve të planifikuara (të mbeturat nga operacioni i pastrimit, materialet për paketim, kontejnerët etj.);
- 6) pjessët e papërdorura (bateritë e harxhuara, katalizatorët e harxhuar etj.);
- 7) substancat të cilat nuk funksionojnë në mënyrë të duhur (acide të ndotura, tretës të ndotur, kripërat e përdorura nga kalitja etj.);
- 8) mbeturinat nga proceset industriale (zgjyrat, mbeturinat nga destilimet etj.);
- 9) mbeturinat nga proceset për zvogëlimin e ndotjes (skruber-pastruesit e gazrave, pluhurit nga filtrat e ajrit, filtrat e përdorura etj.);
- 10) mbeturinat nga përpunimi mainerik/përfundimtar i mbeturinave

- (għdhendjeve laminerisë, farkētarisë, etj.);  
 11) mbeturinat nga eksplorati mi dha u pērpunimi i lēndēve tē para (mbeturinave nē xehetari etj.);  
 12) materialet e papastērta (vajet tē ndotura me BPK/TPK etj.);  
 13) tē gjitha materialet, materiet ose prodhimet pērdorimi i tē cilave ēshtē i ndaluar me ligj;  
 14) prodhimet tē cilat pronari mē nuk do t'i shfrytēzoj (bujqësore, tē zyra, hedhurinat komerciale dha u hedhurinat nga dyqanet dha u nga amviserit etj.);  
 15) materialet e ndotura, materiet ose prodhimet qē dalin nga veprimet qəllimi i tē cilave ēshtē rikultivimi i tokës, dha  
 16) tē gjitha materialet, materiet ose prodhimet tē cilat nuk pērfshihen nē kategoritē e pērmendura mē lart.

(2) Nē bazē tē kategorive hedhurina nga paragrafi (1) i kētij nen, ministri i cili uhdhéheq me organin e administratifs shtetērore kompetent pēr çeshtjet nga lēmi i mjedisit jetēsor e pērcakton Listēn e llojeve tē hedhurinave,

(3) Nē Listēn e hedhurinave nē mēn-yrē tē veċanté do tē shēnoħen hedhurinat tē cilat, sipas karakteristikave tē saja, bien nē kategorinē e hedhurinave tē rrezikshme.

## Neni 26

### Obligimet e krijuesit dhe poseduesit tē hedhurinēs

- (1) Krijuesi dha/ose poseduesi ēshtē i obliguar qē hedhurinēn:  
 1) ta selektoj;   
 2) ta klasifikojip sipas Listēs sē hedhurinēs;   
 3) t'i pērcaktoj karakteristiket e hedhurinēs,   
 4) tē bęjże kontrollin e ndikimeve tē hedhurinave ndaj mjedisit jetēsor, jetēs dha u shendetit tē njeriez;   
 5) ta deponoġi hedhurinēn nē vendet tē parapara pēr atē qəllim, dha  
 6) ta pērpunoġi hedhurinēn, e nēse pērpunimi i saj teknikisht ēshtē i pamundshem dha ekonomikisht i papaguar, t'ia dorēzoj personit fizik ose juridik qē ka leje pēr grumbullimin dha transportimin, pērpunimin, mēnjanimin dha/ose eksportimin e hedhurinēs.

(2) Nēse hedhurina ka njē ose mē shumē karakteristika tē rrezikshme, krijuesi dha/ose poseduesi janē tē obliguar ta klasifikojnē hedhurinēn nē kategorinē hedhurinē e rrezikshme dha tē veprojē me atē si me hedhurinē tē rrezikshem.

(3) Personat fizik ē nē amviseri janē tē obliguar t'i kryejnē obligimet nga paragrafi (1) pika 1 dha 5.

## Neni 27

### Grumbullimi dha transportimi i hedhurinēs

(1) Grumbullimi i hedhurinave bęhet nga ana e grumbulluesve tē hedhurinēs me ćaka hedhurina grumbullohet nga krijuesi ose zotēruesi i hedhurinēs dha transportohet deri nē vendet e caktuara pēr procedim me hedhurina.

(2) Personat juridik dha fizik qē grumbullojnē hedhurina janē pērgjegjés pēr grumbullim dha transportim tē siguruar tē hedhurinave nga vendi i grumbullimit tē tyre deri nē vendin e dorēzimit.

(3) Hedhurina mund tē transportohet me automjete speciale tē dedikuar pēr transportin e hedhurinave, automjete tē mbyllura, kontejneri ose me automjete tē tjera adekuata me tē cilat pengohet shpērndarja, derdhja e hedhurinēs gjatē grumbullimit, transportit, ngarkimit dha/ose shkarkimit.

(4) Nē rast tē ndotjes sē mjedisit jetēsor qē mund tē krijuhet gjatē kohēs

së grumbullimit dhe transportimit të hedhurinës, grumbulluesi i hedhurinave është përgjegjës për largimin e ndotjeve të krijuara dhe dëmin e krijuar ndaj mjedisit jetësor.

(5) Hedhurinat transportohen deri në vendin e caktuar nga krijuesi ose poseduesi i hedhurinës. Si vend i caktuar nga krijuesi ose poseduesi mund të jetë vetëm vendi që siguron se me hedhurinën e dorëzuar do të veprohet në pajtim me mënyrat e përcaktuara ligjore.

(6) Nëse hedhurina nuk mund të transportohet deri në vendin e caktuar nga krijuesi ose poseduesi i hedhurinës, respektivisht në vende ku nuk mund të veprohet në pajtim me mënyrat ligjore të përcaktuara, grumbulluesi, respektivisht transportuesi është i detyruar t'ia kthejë hedhurinën krijuesit ose poseduesit.

## Neni 28

### Përpunimi i hedhurinës

(1) Hedhurina që përban materie të përdorura duhet të përpunohet, nëse është i mundshëm shfrytëzimi i saj i mëtejmë dhe përdorimi i mëtejmë i përbërjes së saj dhe nëse ekzistojnë kushte adekuate teknike dhe teknologjike.

(2) Përpunimi i hedhurinës doemos duhet të bëhet pa zbatimin e proceseve ose metodave të cilat e rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

(3) Nëse përpunimi i hedhurinës mund të shkaktojë rrezikim të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe/ose harxhimet për përpunim të hedhurinës janë në mënyrë të pakrahasueshme të mëdha dhe ekonomikisht të paqëndrueshme, hedhurina duhet përkohësisht ose përherë të eksportohet nga Republika e Maqedonisë në shtetet më të afërta ku hedhurina mund të përpunohet ose të mënjanohet.

(4) Obligimi për përpunimin e detyrueshëm të hedhurinës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të zbatohet nëse mënjanimi i hedhurinës shkakton rrezikim më të vogël të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve se sa përpunimi, me ç'rast duhet të kihet parasysh:

- 1) konsumimi i resurseve natyrore;
- 2) energjia e cila do të ishte përdorur për përpunim ose e fituar nga hedhurina, dhe
- 3) përbajtja e materieve të rrezikshme në hedhurinë të krijuar pas përpunimit
- 4) emisioni i substancave dhe energjisë në ajër, ujë dhe në tokë.

## Neni 29

### Operacione për përpunimin e hedhurinës

(1) Hedhurina përpunohet me zbatimin e një ose më shumë operacioneve vijuese:

- 1) shfrytëzimin si lëndë djegëse për dedikim primar ose si ndonjë mjet tjetër për prodhimin e energjisë;
- 2) rigjenerimin/përmirësimin e cilësive të tretësve;
- 3) riciklimin/përmirësimin e cilësive të materieve organike të cilat nuk shfrytëzohen si tretës (duke inkuadruar këtu edhe kompostimin dhe proceset tjera të transformimit biologjik);
- 4) riciklimin/përmirësimin e cilësive të metaleve dhe të bashkimeve të metaleve;
- 5) riciklimin/përmirësimin e cilësive të materialeve tjera joorganike;
- 6) rigjenerimin e acideve ose të bazave;
- 7) përpunimin e përbërësve që shfrytëzohen për zvogëlimin e ndotjes;
- 8) përpunimin e përbërësve nga katalizatorët;
- 9) rirafinerimin e naftës së shfrytëzuar ose forma tjera të rishfrytëzimit të

naftës;

- 10) trajtimin e tokës, në dobi të bujqësisë dhe të mjedisit jetësor;
- 11) shfrytëzimin e hedhurinës të fituar me ndonjë prej operacioneve të theksuara në pikat prej 1 deri 10 të këtij paragrafi;
- 12) shkëmbimin e hedhurinës për shkak të nënshtrimit të ndonjë prej operacioneve të theksuara në pikat prej 1 deri 11 të këtij paragrafi, dhe
- 13) deponimin e hedhurinës që duhet t'i nënshtrohet ndonjëri nga operacionet e theksuara në pikat prej 1 deri 12 në këtë paragraf (me përjashtim të deponimit të përkohshëm, para grumbullimit, në vendin ku është krijuar hedhurina).

(2) Operacionet nga paragrafi (1) të këtij nenit gjatë importit, eksportit dhe transitit të hedhurinës në dokumentet shoqëruese shënohen me shkronjën latine (R) pas së cilës pason numri i operacionit adekuat për përpunim.

### **Neni 30**

#### **Leja për ndërtim të institucioneve për përpunim, trajtim, deponim dhe për mënjanimin e hedhurinës**

(1) Kërkesa për marrjen e lejes për ndërtim të instalimit për deponim, trajtim, përpunim dhe për mënjanimin e hedhurinës, investitori ia dorëzon organit kompetent për dhënen e lejes në pajtim me ligjin për ndërtim.

(2) Në suazat e projektit për ndërtim të instalimeve për deponim, trajtim, përpunim dhe për mënjanimin e hedhurinës, zbatohet procedurë për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar në Ligjin për mjedisin jetësor.

(3) Leje për ndërtimin e instalimit për depojim, trajtim, përpunim dhe për mënjanimin e hedhurinës nuk do të jepet nëse investitori nuk ka marrë vendim për lejimin e studimit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor, në mënyrë dhe me procedurë të përcaktuar me Ligjin për mjedis jetësor.

(4) Investuesi është i obliguar që me kërkesën për dhënen e lejes për ndërtim të ofrojë dëshmi nga organi kompetent për procedurën e filluar për marrjen e lejes integruese ekologjike, në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

(5) Vendimi për përdorim të instalimit për deponim, trajtim, përpunim dhe për mënjanim të hedhurinës nuk do të jepet deri sa nuk fitohet leje integruese ekologjike nga organi kompetent, në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

### **Neni 31**

#### **Planet operative dhe revizioni ekologjik për instalimet për përpunimin, deponimin dhe mënjanimin e hedhurinës**

(1) Instalimet ekzistuese për deponim, përpunim dhe për mënjanim të hedhurinës, janë të obliguar të paraqesin kërkesë për marrjen e lejes për harmonizimin me plane operative në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Nëse operatorët e instalimeve për deponim, përpunim dhe për mënjanim të hedhurinës posedojnë A ose B leje integruese ekologjike, ato janë të obliguar të sigurojnë revizion të përgjithshëm ekologjik, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

### **Neni 32**

#### **Leje për ushtrimin e veprimtarisë magazinim, trajtim**

## **dhe/ose përpunim të mbeturinave**

(1) Personat juridikë dhe fizikë që bëjnë magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të mbeturinave detyrimisht duhet të posedojnë leje për ushtrim të veprimtarisë përpunim, trajtim dhe/ose magazinim të mbeturinave.

(2) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) i këtij neni që të mund ta kryejnë veprimtarinë depozitim, trajtim dhe/ose ripërpunim të hedhurinave, duhet:

- t'i plotësojnë kushtet minimale-teknike në aspekt të lokacionit, instalimit të nevojshëm dhe pajisjes për depozitim, trajtim dhe/ose ripërpunim të hedhurinave dhe identifikimin e tyre, si dhe sistemin për ndjekje dhe video mbikëqyrje të hedhurinave,

- lokacioni në të cilin do të kryhet veprimtaria e depozitimit, trajtimit dhe/ose ripërpunimit të hedhurinave, të gjendet jashtë vendbanimeve, përkatësisht i njëjtë të parashikohet në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe/ose qytetit të Shkupit

- të posedojnë vërtetim përkatës të lëshuar nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe/ose qyteti i Shkupit për plotësimin e kushtit nga alineja 2 e këtij paragrafi.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni paraqesin kërkesë më shkrim për fitimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të mbeturinave organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor.

(4) Lejen nga paragrafi (1) i këtij neni e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor, për një periudhë kohore që nuk mund të jetë më e gjatë se 15 vjet.

(5) Para lëshimit të lejes nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori shtetëror për mjedisin jetësor kryen kontroll në vendin e ngjarjes, për konfirmimin e plotësimit të kushteve për marrjen e lejes në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat që dalin në pajtim me këtë ligj apo me ligj tjetër. Në inspektim marrin pjesë edhe përfaqësues nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor, i cili e udhëheq procedurën përlëshimin e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Në qoftë se vjen deri te ndryshimi i kushteve minimale-teknike të përcaktuara me lejen nga paragrafi (1) i këtij neni, personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të paraqesin kërkesë për ndërrimin e lejes.

(7) Kërkesa për ndërrimin e lejes medoemos të paraqitet më së voni në afat prej dy muajsh, nga momenti i kryerjes së ndryshimeve nga paragrafi (5) i këtij neni.

(8) Kërkesa për përtëritje të lejes medoemos të paraqitet më së voni në afat prej dy muajsh para skadimit të afatit të vlefshmërisë së lejes.

(9) Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për fitimin e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi mund t'i paraqesë ankesë Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

(10) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që të vendosin video mbikëqyrje në vendin e pranimit të hedhurinave, si dhe në vende tjera në lokacionin ose objektet nëpërmjet të cilat do të vërehet pranimi, menaxhim, ruajtja dhe dërgimi i hedhurinave.

(11) Të dhënat nga video mbikëqyrja nga paragrafi (10) i këtij neni, personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar t'i ruajnë së paku tri vjet.

(12) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore

kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor më për së afërmë i përcakton kushtet minimale teknike për ushtrimin e veprimitarise nga parografi (2) i këtij neni, formën dhe përbajtjen e formularit të kërkesës për marrje, ndërrim dhe përtëritje të lejes për përpunim, trajtim dhe/ose magazinim të mbeturinave, si dhe formën dhe përbajtjen e formularit të lejes.

## Neni 32-a

### **Ndalim për kryerje të tregtisë me hedhurina të parrezikshme**

(1) Ndalohet kryerja e veprimitarise tregti me hedhurina të parrezikshme, përveç nëse personi juridik ose personi fizik posedon leje për kryerjen e veprimitarise magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave.

(2) Me përjashtim nga parografi (1) i këtij neni, nuk nevojitet posedim i lejes për kryerjen e veprimitarise magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave, në rastet në vijim:

- 1) për hedhurina të parrezikshme me origjinë nga prodhimi personal;
- 2) për hedhurina të parrezikshme me origjinë nga pajisja e dëmtuar dhe e përdorur dhe
- 3) për shitje të hedhurinave të parrezikshme nga grumbulluesit individualë të hedhurinave, nëse blerësit posedojnë leje në pajtim me paragrin (1) të këtij neni.

(3) Personat fizikë dhe juridikë nga parografi (1) i këtij neni, detyrohen të mbajnë evidencë dhe ta përcaktojnë origjinën e hedhurinave të pranuara ose të dërguara në formularë të veçantë të hedhurina të pranuara ose të dërguara, si dhe të mbajë evidencë të grumbulluesve individualë të hedhurinave të parrezikshme prej të cilëve kanë pranuar dhe blerë hedhurina.

(4) Personat fizikë dhe juridikë evidencën nga parografi (3) të këtij neni, detyrohen ta ruajnë së paku pesë vjet.

(5) Personat fizikë dhe juridikë nga parografi (1) i këtij neni, nëse nuk mund ta përcaktojnë origjinën e hedhurinave të pranuara apo të dërguara, nuk guxojnë t'i blejnë ato.

(6) Mënyrën e mbajtjes së evidencës, formën dhe përbajtjen e formularëve nga parografi (3) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Në rastet nga parografi (5) i këtij neni, personat juridikë dhe fizikë detyrohen që ta paraqesin rastin në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme.

(8) Prodhimet dhe materialet që janë në përdorim të përgjithshëm, siç janë: pjesët metalike dhe elektrike nga pajisja hekurudhore, pjesët metalike nga përcuesit dhe largpërcuesit elektrikë; pjesët metalike dhe teli metalik nga përcuesit ajrorë telefonikë, të gjitha llojet e shahtave, pusetat për kanalizim atmosferik dhe kufizues të shahtave; kabllo të bakrit me prerje të lartë, kabllo alumini; rrrethoja elastike-mbrojtëse për rrugë; të gjitha llojet e shenjave të komunikacionit dhe udhërrëfyesit; rrufepritësit; bustet, monumentet dhe sendet e tjera artistike dhe arkeologjike dhe pjesë nga to (shkronja nga mbishkrimet dhe ngjashëm) dhe prodhime dhe materiale tjera me dëmtimin ose marrjen e të cilave mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, siguria e komunikacionit publik ose e objekteve të instalacioneve publike, si dhe funksionimi i tyre normal (në tekstin e mëtutjeshëm: prodhime dhe materiale në përdorim të përgjithshëm), personat fizikë dhe juridikë nga parografi (1) i këtij neni, nuk guxojnë t'i blejnë nga grumbulluesit individualë.

(9) Kryerësit e veprimitarise magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të

hedhurinave mund të blejnë prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm vetëm nga personat fizikë dhe juridikë, nëse ata paraqesin dëshmi se prodhimet dhe materialet që janë në përdorim të përgjithshëm, janë në pronësi të tyre.

### **Neni 32-b**

#### **Heqja e lejes për magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor me propozim të inspektorit shtetëror pér mjedis jetësor miraton aktvendim pér heqjen e lejes për magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave nëse personat juridikë dhe fizikë:

- dy herë në periudhë prej një viti i kanë shkelur kushtet minimale teknike pér kryerje të veprimtarisë magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave,
- kanë kryer ndryshime në aktivitete për të cilat e kanë marrë lejen nga neni 32 i këtij ligji dhe
- kryejnë tregti me prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga neni 32-a paragrafi (7) të këtij ligji, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtronhet ankesë te Komisioni Shtetëror pér Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedura të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

### **Neni 32-v**

#### **Heqja e lejes për tregti me hedhurina të parrezikshme**

*I fshirë* 4

### **Neni 32-g**

*I fshirë* 5

### **Neni 33**

#### **Deponimi i hedhurinës**

(1) Hedhurina që mund përsëri të përdoret, përpunohet dhe/ose shfrytëzohet si burim i energjisë, mund të deponohet në vende të vecanta të parapara pér atë dedikim, nëse deponimi nuk do të shkaktojë rrezik pér mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

(2) Hedhurina vendoset në vende që janë të pajisura teknikisht pér vendosjen e përkohshme të hedhurinës në lokacione të krijuesit të hedhurinës, në vendet pér grumbullim, në stacione ringarkimi dhe në lokacione tjera pér grumbullim në pajtim me këtë ligj

(3) Personat juridikë dhe fizikë që krijojnë hedhurinë, munden hedhurinën përkohësisht ta vendosin në afërsinë e vendit të krijimit të saj, por më së gjati një vit duke konsideruar nga dita e krijimit të saj nëse hedhurina është e dedikuar pér largim, respektivisht më së gjati deri tre vjet duke konsideruar nga dita e krijimit të saj nëse hedhurina është e dedikuar pér trajtim dhe pér përpunim

(4) Për depozitim i hedhurinës nga paragrafi (3) të këtij neni, krijuesi ose poseduesi i hedhurinës është i detyruar paraprakisht të sigurojë pëlqim nga organi kompetent pér kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor. Pëlqimi jepet nëse janë plotësuar kushtet pér vendosjen e hedhurinës në pajtim me këtë ligj ose me dispozitë tjetër

(5) Mënyra dhe kushtet për depononin e hedhurinës, si dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë lokacionet të cilëve u bëhet deponimi i hedhurinës, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor,

## Neni 34

### Mënjanimi i hedhurinës

(1) Hedhurinë që nuk mund të përdoret, përpunohet ose të shfrytëzohet serish si burim i energjisë, mënjanohet me zbatimin e operacioneve të veçanta për mënjanim, të përcaktuar në pajtim me nenin 35, paragrafi (1) nga ky ligj.

(2) Para se të mënjanohet, hedhurina duhet t'i nënshtrohet trajtimit mekanik, kimik, fizik, termik ose biologjik, me qëllim që të zvogëlohet sasia e hedhurinës, vëllimi i saj dhe ndikimet negative ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(3) Para se të merret me mënjanimin e hedhurinës, ajo duhet të selektohet dhe klasifikohet në pajtim me Listën e llojeve të hedhurinës.

(4) Hedhurina e cila nuk mund të selektohet dhe të klasifikohet sipas Listës të llojeve të hedhurinës, detyrimisht bëhet vlerësimi i karakteristikave të rrezikshme, me qëllim që të përcaktohet se si do të veprohet me këtë hedhurinë.

(5) Mënjanimi i hedhurinës bëhet në vende dhe lokacione të veçanta të përcaktuara, si dhe në objekte dhe instalime të ndërtuara të veçanta të dedikuara për mënjanimin e hedhurinës, të cilat kanë marrë A ose B – leje integruese ekologjike.

## Neni 35

### Operacione për mënjanimin e hedhurinës

(1) Operacionet për mënjanimin e hedhurinës janë:

- 1) Deponimi-lëshimi në tokë ose mbi tokë (si p.sh., deponia, etj.);
- 2) Trajtimi i tokës (si p.sh., bioshkatërrimi i hedhurinës së lëngët dhe pështjellur në tokë, etj.);
- 3) Injektimi i thellë (si p.sh., injektimi i hedhurinës e cila mund të thithet në puse ose në shpella, gropë natyrore të zbrazëta etj.);
- 4) Kaptimi sipërfaqësor (si p.sh., vendosja e hedhurinës së lëngët ose të quilltë në gropë, liqene ose në këneta, etj.);
- 5) Konstruktimi i veçantë i deponive (si p.sh., vendosjen në qeli të veçantë të cilat janë të mbyllura dhe të izoluara njëra prej tjetrës dhe nga mjedisit jetësor, etj.);
- 6) Vendosja në trupa të mëdhenj të ujut përveç deteve/oqeaneve;
- 7) Vendosja në detëra/oqeane duke përfshirë ngulitje në thellësinë e detit;
- 8) Trajtimi biologjik që nuk është definuar në vend tjeter në këtë ligj, ndërsa nga i cili dalin bashkëngjitje finale ose përzierje të cilat mënjanohen me ndonjë prej operacioneve të përmendura në pikat 1-12 të këtij paragrafi;
- 9) Trajtimi - kimik që nuk është definuar në vend tjeter në këtë ligj, ndërsa nga i cili dalin bashkëngjitje finale ose përzierje të cilat mënjanohen me ndonjë prej operacioneve të përmendura në pikat 1-12 të këtij paragrafi (si p.sh., tretje, tharje, kalcinim, etj.);
- 10) Djegia në tokë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat tjera që kanë të bëjnë në djegien;
- 11) Djegie në det;
- 12) Deponim të përhershëm (si p.sh., vendosja e kontejnerëve në xehore, etj.);
- 13) Përzierja para nënshtimit të ndonjë prej operacioneve të përmendura në pikat 1-12 të këtij paragrafi;
- 14) Ripaketimi para nënshtimit të ndonjë prej operacioneve të

përmendura në pikat 1-12 të këtij paragrafi dhe

15) Deponimi deri në kryerjen e ndonjërit prej operacioneve të përmendura në pikat 1-14 të këtij paragrafi (me përjashtim të deponimit me kohë, para grumbullimit, në vedin ku është krijuar hedhurina);

(2) Mënjanimi i hedhurinës me zbatimin e operacioneve nga paragrafi (1) nga ky neni do të konstatohet për zgjidhje të pérhershme gjatë menaxhimit me hedhurinën.

(3) Operacionet nga paragrafi (1) të këtij nenit gjatë importit, eksportit dhe tranzitit të hedhurinës në dokumentet shoqëruese shënohen me shkronjën latine (D) pas së cilës pason numri i operacionit adekuat për përpunim.

## Neni 36

### Rrjeti integrues për mënjanimin e hedhurinës

(1) Me qëllim që të mundësohet mënjanimi më i sigurt dhe ekonomik i hedhurinës në instalimet të cilat janë më të afërta në vedin e krijimit të hedhurinës, si dhe shfrytëzimin e metodave dhe teknologjive më adekuate me të cilat sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, objektet dhe instalimet e dedikuara për mënjanimin e hedhurinës duhet të janë të lidhura në mes tyre në rrjetin integrues për mënjanimin e hedhurinës.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përcakton mënyrën dhe kushtet e funksionimit të rrjetit integrues për mënjanimin e hedhurinës, në pajtim me planin për menaxhim me hedhurinën në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 37

### Stacionet ringarkuese për hedhurina

(1) Hedhurina e cila është e dedikuar për deponim, përpunim ose për mënjanim, mund të transportohet nga vendi i krijimit të saj deri në stacionet ringarkuese, prej ku hedhurina transportohet deri te objektet dhe deri te instalimet për deponim, përpunim dhe për mënjanim.

(2) Hedhurina e parrezikshme mund të ruhet në stacionin ringarkues jo më gjatë se afati i caktuar në dispozitën nga paragrafi (5) i këtij nenit.

(3) Prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit i caktojnë lokacionet ku mund të ndërtohen, përkatësisht vendosen stacionet ringarkuese.

(4) Stacionet ringarkuese janë pjesë integrale të rrjetit për mënjanimin e hedhurinës.

(5) Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në pajtim me ministrin e Transportit dhe Lidhjeve, i përcakton kushtet minimale teknike dhe kushtet në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor të cilat duhet t'i plotësojnë stacionet ringarkuese, kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë lokacionet në të cilat ndërtohen, përkatësisht vendosen stacionet ringarkuese, si dhe afatet për ruajtje të hedhurinës në stacionin ringarkues sipas llojit të hedhurinës.

## Neni 38

### Menaxhuesi i hedhurinave

(1) Personat juridikë dhe fizikë nga nenit 21 paragrafi (1) i këtij ligji, janë të obliguar që të emërojnë së paku një person të aftësuar profesionalisht - menaxhes të hedhurinave.

(2) Menaxhuesi i hedhurinave i kryen aktivitetet në vijim:

- kujdeset për realizimin dhe e realizon programin vjetor të personave juridikë dhe fizikë,
- e përcjell gjendjen rrjedhëse në menaxhimin me hedhurina,
- të ndërmarrë aktivitete dhe masa për zvogëlimin dhe mënjanimin e hedhurinave të krijuara,
- kujdeset për realizimin dhe zbatimin e procedurave për veprim me hedhurina në pajtim me këtë ligj apo dispozitë tjeter,
- mban evidencë dhe përgatit raport dhe i zbaton obligimet në pajtim me nenin 39 të këtij ligji dhe dispozitat për menaxhim me hedhurina,
- përgatit raporte për fatkeqësi më të mëdha apo avari të cilat mund të shkaktohen gjatë veprimit me hedhurina,
- i informon organet udhëheqëse dhe subjektet e personit juridik apo fizik për rrezikimin e mundshëm të mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve që është rezultat i prodhimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinave dhe propozon zgjidhje konkrete,
- është përgjegjës për veprim të rregullt me hedhurina,
- e kontrollon llojin dhe sasinë e hedhurinave që krijohen, përpunohen dhe mënjanohen dhe
- e përcjell gjendjen rrjedhëse në menaxhimin me hedhurina.

### **Neni 38-a**

(1) Provimi profesional për menaxhues me hedhurina (në tekstin e mëtejmë: provim profesional) jepet për kontroll të njohurisë së nevojshme profesionale nga sfera e menaxhimit me hedhurina.

(2) Provim profesional mund të japë personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë,
- të ketë kryer së paku shkallën VI të arsimit të lartë ose arsimit universitar me së paku shkallën VII/1 përkatësisht diplomë me së paku 180 kredi sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK),
- me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë kumtuar ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa zgjasin pasoja nga ndalimi dhe
- të ketë së paku pesë vite përvjë pune pas diplomimit, në menaxhimin me hedhurina dhe/ose mjedisin jetësor.

### **Neni 38-b**

Mënyra e realizimit të provimit

(1) Provimi profesional përbëhet prej dy pjesëve edhe atë:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (shembull praktik), me të cilën kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve.

(2) Pjesa e parë nga provimi profesional nga paragrafi (1) i këtij neni, jepet me shkrim në mënyrë elektronike, me përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(3) Pjesa e dytë e provimit profesional përbëhet nga:

- shembulli praktik dhe
- pyetje të cilave kandidati duhet t'u përgjigjet në bazë të analizës së shembullit praktik.

### **Neni 38-v**

(1) Provimi jepet sipas programit në të cilin përbahen materiali, rregullat dhe literatura.

(2) Programin për dhënie të provimit nga sfera përkatëse e miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 38-g**

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit dhe bazat e shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit nga nen 38-m të këtij ligji, i përpilojnë persona profesionistë dhe profesorë nga sfera përkatëse që kanë së paku dhjetë vjet përvojë pune në sferën e menaxhimit me hedhurina dhe/ose mbrojtje të mjedisit jetësor, të përcaktuara nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit profesional dhe pyetjet dhe shembujt praktikë nga pjesa e dytë e provimit i verifikon Komisioni i përbërë nga:

- dy përfaqësues dhe zëvendës të tyre nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, të emëruar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor,
- një përfaqësues dhe zëvendësi i tij nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve komunale
- një përfaqësues dhe zëvendësi i tij nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë dhe
- një përfaqësues dhe zëvendësi i tij nga radhët e personave profesionalë dhe profesorët nga sfera përkatëse të cilët kanë së paku dhjetë vite përvojë pune në sferën e menaxhimit me hedhurina dhe/ose mbrojtjen e mjedisit jetësor.

(3) Komisioni nga paragafi (2) i këtij neni, kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë nga nen 38-m të këtij ligji së paku një herë në vit.

(4) Gjatë revizionit Komisioni veçanërisht i merr parasysh ndryshimet e rregullave në të cilat bazohet pyetja, përkatësisht shembulli praktik, numrin e kandidatëve që i janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kritere tjera të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të bazave nga nen 38-m i këtij ligji.

(5) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë, Komisioni vendos që pyetjet dhe shembujt praktikë të ndryshohen apo të mënjanohen plotësisht nga bazat nga nen 38-m i këtij ligji.

(6) Personat profesionalë dhe profesorët dhe personat nga paragafi (1) i këtij neni dhe anëtarët e Komisionit për Verifikim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, kanë të drejtë kompensim në para që e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Shuma e kompensimit në para nga paragafi (6) i këtij neni, caktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara dhe shembujve praktikë, si dhe ndërlikueshmërisë së materies.

(8) Shuma vjetore e kompensimit në para nga paragafi (6) nuk e tejkalon nivelin e tri rrogave mesatare mujore të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës.

## **Neni 38-d**

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit profesional i kryen organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, të cilin teknikisht e realizon personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë i zgjedhur nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 38-gj**

Provimi profesional realizohet së paku dy herë në vit.

### **Neni 38-e**

(1) Kërkesën për dhënie të provimit kandidati e parashtron te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Me kërkesën për dhënie të provimit kandidati detyrohet të parashtrojë dëshmi për plotësimin e kushteve për dhënie të provimit profesional, të përcaktuara me këtë lig.

### **Neni 38-zh**

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor ose personi i autorizuar nga ai, konstaton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhëni e provimit.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për dhënie të provimit, mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

### **Neni 38-z**

(1) Kandidatit të cilit i është miratuar kërkesa për dhënie të provimit, i caktohet koha dhe vendi për dhënie të provimit, e kandidati njoftohet më së voni në afat prej tetë ditësh para dhëni së provimit.

(2) Kandidatit i mundësohet që të fillojë ta japë provimin në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënie të provimit.

### **Neni 38-x**

(1) Provimi jepet në lokal për dhëni e provimit, të pajisur veçanërisht për dhëni e provimit profesional me pajisje materiale teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizimin e dhëni.

(2) Publiku informohet për datën dhe kohën e dhëni së provimit së paku tri ditë para mbajtjes së provimit.

(3) Dhënia e provimit incizohet dhe drejtëpërdrejt emitohet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Personi juridik që e realizon provimin profesional duhet t'i përmbushë kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale teknike dhe informatike në lokatë për dhënie të provimit profesional, kushte të cilat më afersisht i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Në lokalini për dhënie të provimit, gjatë kohës së dhëni së provimit janë të pranishëm dy përfaqësues nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe një përfaqësues nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (informaticentë).

### **Neni 38-i**

(1) Para fillimit të dhëni së provimit profesional, përfaqësuesi i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit, gjatë kohës së dhëni së pjesës së parë të provimit, nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, ligjeve me koment dhe sqarim, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe

informatike, lëndëve të përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit, i lejohet shfrytëzimi vetëm i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në version elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep provimin.

(4) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informaticientët nga neni 38-x parografi (5) i këtij ligji, në rast se ka problem teknik me kompjuterin.

(5) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat, provimi ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanohen në afat prej pesë minutash provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(7) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij nenit, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar.

(8) Në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin profesional dhe kjo konstatohet në procesverbal për dhënien e provimit profesional.

(9) Përfaqësuesit e autorizuar nga nenit 38-x parografi (5) gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që e jep provimin, përveç në rast të mënjanimit të problemit teknik, kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

## **Neni 38-j**

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit profesional krijohen shkaqe të arsyeshme për të cilat kandidati nuk mund ta vazhdojë dhëni e provimit (sëmundje, pushim i lindjes dhe ngjashëm), do të ndërpritet provimi për një kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(2) Aktvendim për vazhdimin e provimit miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor. Lutja parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga ndërprerja e shkaqeve për prolongimin e provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh.

(3) Nëse kandidati nuk parashtron lutje për vazhdimin e provimit në afatin e caktuar në paragrafin (2) të këtij neni do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

(4) Kundër aktvendimit të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nga paragrafi (2) i këtij neni, kandidati mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Në vazhdimin e provimit, kandidati nuk e jep atë pjesë të provimit të cilën paraprakisht tanimë e ka dhënë.

## **Neni 38-k**

(1) Provimi profesional fillon me dhënien e pjesës së parë (pjesës teorike), e pastaj të pjesës së dytë (shembull praktik).

(2) Pjesa e dytë jepet në afat prej së paku 15 ditësh pas dhënies së

suksesshme të pjesës së parë.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor me Rregullore e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve në pjesën e parë dhe të dytë të provimit.

### **Neni 38-II**

(1) Pjesa e parë e provimit jepet për çdo sferë përkatëse dhe përmban së paku 50 pyetje me pesë opsione për rrethim prej të cilave një është i saktë, dy janë të ngjashëm, një është i pasaktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël pikësh) dhe një është i pasaktë në masë të madhe (në të humben numër i madh pikësh)).

(2) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit është kandidati ta japë pjesën e parë të provimit.

(3) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e parë të provimit në pajtim me paragrin (2) të këtij neni, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

### **Neni 38-I**

(1) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga shembulli praktik.

(2) Pyetjet të cilat janë pjesë përbërëse e shembullit praktik janë nga sfera përkatëse dhe kanë dhjetë opsione të mundshme përgjigjesh prej të cilave një është i saktë, pesë janë të ngjashëm dhe katër janë të ndryshëm.

(3) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

### **Neni 38-m**

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit profesional bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit profesional kryhet me studim të shembullit praktik dhe përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve që dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes softuerike elektronike (në tekstin e mëtutjeshëm: shembull praktik elektronik).

(4) Pyetjet nga shembulli praktik varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e themelon Sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional.

(6) Pyetjet e përbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit profesional dhe përgjigjet e tyre, si dhe shembulli praktik dhe pyetjet që dalin nga shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional.

(7) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përban edhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 300 pyetjesh, si dhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 50 shembujve praktikë, për nevojat e pjesës së dytë të provimit.

(8) Në sistemin elektronik përbahet edhe udhëzim për rregullat dhe literaturën në të cilat përbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e

provimit dhe rregullat për pjesën e dytë të provimit.

(9) Numri i pyetjeve dhe shembujve praktikë në bazat nga paragafi (6) i këtij neni zmadhohet për 10 % në vit, duke filluar nga viti 2015.

(10) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të ti.

### **Neni 38-n**

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë, përkatësisht pjesës së dytë të provimit, përfaqësuesi i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, kandidatit i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 38-m paragafi (5) i këtij ligji.

(2) Pas lejimit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përbajtjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga bazat nga neni 38-m paragafi 7 i këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit, përmbajnë udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së tij, për të cilin përfaqësuesi i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, jep sqarim, para fillimit të dhënies së provimit.

(4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit nuk mund të lejojë ekzistimin e përbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembullin praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

### **Neni 38-nj**

(1) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë ose të dytë të provimit për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 38-m paragafi (5) i këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(2) Nëse shkaqet nga paragafi (1) i këtij neni mënjanohen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(3) Nëse shkaqet nga paragafi (1) i këtij neni nuk mënjanohen në afatin nga paragafi (2) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

### **Neni 38-o**

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

### **Neni 38-p**

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës e caktuar për përgjigje të pyetjeve nga secili prej shembullit praktik të pjesës së dytë, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga shembulli praktik, ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

## **Neni 38-r**

(1) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin u lëshohet certifikatë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit.

(2) Formën dhe përbajtjen e certifikatës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 38-s**

Me kërkesë të kandidatit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e informon për gabimet e bëra në testin për dhënien e provimit profesional, me mundësimin e shikimit të drejtpërdrejtë të testit.

## **Neni 38-t**

(1) Testet dhe shembujt praktikë shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënieve së provimit profesional.

(2) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga Testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit profesional dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura ruhen në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura, i cili në punën e vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (2) i këtij neni dhe në të cilin, përvèç përfaqësuesit nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, marrin pjesë edhe përfaqësuesi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe informatikani nga Ministria e Shoqërisë së Informatikës dhe Administratës i caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, mban mbledhje së paku njëherë në vit dhe kryen revizion të mënyrës së realizimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

(5) Komisioni ka të drejtë të kryejë revizion edhe të mënyrës së realizimit të provimeve të mbajtura në pesë vitet e fundit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së komisionit, por jo më herët nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(6) Nëse Komisioni konstaton parregullsi në realizimin e provimit nga individë sipas nenit 38-n të këtij ligji, propozon heqje të certifikatës nga neni 38-r i këtij ligji.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor miraton Aktvendim për heqjen e Certifikatës në bazë të propozimit të Komisionit në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit.

(8) Kundër Aktvendimit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

## **Neni 38-q**

(1) Shpenzimet për dhënien e provimit i bart kandidati, nëse institucioni ku është i punësuar nuk i paguan.

(2) Lartësinë e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit, të domosdoshme për realizimin e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, përgatitjes së bazave të pyetjeve, realizimin

e testit elektronik, përgatitjen e materialeve dhe ftesave dhe përgatitjen e certifikatave.

(3) Shpenzimet për dhënien e provimit paguhen në llogarinë e të hyrave personale të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Nëse shpenzimet nuk paguhen në llogarinë përkatëse të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për realizimin e provimit, kandidatit nuk i lejohet dhënie e provimit.

(5) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagimit të mjeteve nuk e jep provimin, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligjin.

## **Neni 38-u**

(1) Licencat e dhëna, të hequra dhe të vazhduara të menaxhuesve me hedhurina, si dhe licencat e menaxhuesve që janë shfuqizuar, evidentohen në Regjistrin të cilin e mban organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Regjistri nga paragrafi (1) i këtij neni, publikohet në ueb faqen dhe në tabelën e shpalljeve të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Formën dhe përbajtjen e Regjistrat dhe mënyrën e mbajtjes së tij, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 39**

### **Obligimi për mbajtjen e evidencës dhe informimit**

(1) Personat fizikë dhe juridikë të cilët i bëjnë veprimtaritë e grumbullimit, transportit, deponimit, trajtimit, përpunimit, mënjanimit dhe qarkullimit (import, eksport dhe transit) të hedhurinës janë të obliguar të mbajnë evidencë për:

- 1) llojin, sasinë dhe prejardhjen e hedhurinës me të cilën kanë të bëjnë;
- 2) hedhurinën e përkohshme të deponuar;
- 3) hedhurinën e cila i është dorëzuar grumbulluesit dhe transportuesit të hedhurinës;
- 4) hedhurinën e cila është shfrytëzuar ose përpunuar nga vetë krijuesit;
- 5) hedhurinën e cila i është dorëzuar personave tjerë juridikë ose fizikë të cilët përpunojnë hedhurinë, nëse përpunimi nuk është bërë nga vetë krijuesi i hedhurinës;
- 6) të dhënat për zbatimin e operacioneve për përpunim nga neni 35, paragrafi 1 i këtij ligji;
- 7) hedhurinën e cila është e dedikuar për mënjanim;
- 8) hedhurinën e cila përpunohet ose mënjanohet në vend të huaj;
- 9) për destinacionin fillestar dhe atë të fundit të transportit të hedhurinës, dhe
- 10) sasitë dhe llojit të hedhurinës e cila është importuar, eksportuar dhe tranzituar në/prej/nëpër Republikën e Maqedonisë.

(2) Evidencia nga paragrafi (1) i këtij neni udhëhiqet çdo ditë në ditar.

(3) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që personit të autorizuar për transport të hedhurinës gjatë dorëzimit të hedhurinës për transport t'i jalin formularë identifikimi dhe transporti për hedhurinën.

(4) Gjatë importit të mbeturinave, personat juridikë dhe fizikë që e bëjnë transportin janë të detyruar t'ia paraqesin organit kompetent për ushtrimin e detyrave doganore, një kopje të formularit identifikues dhe të transportit gjatë daljes së mbeturinave nga territori i Republikë së

Maqedonisë, i cili është i detyruar formularin e transportit ta vërtetojë.

(5) Në rastet e paragrafit (4) të këtij ligji organi kompetent për kryerjen e punëve doganore është i detyruar që një kopje nga formulari i vërtetuar i transportit dhe identifikimit t'ia paraqesë organit kompetent për ushtrimin e punëve profesionale të ambientit jetësor.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e ditarit nga parografi (2) i këtij nenit si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e veprimit me formularët nga parografi (3) i këtij nenit.

(7) Personat fizikë dhe juridikë nga parografi (1) i këtij nenit janë të obliguar që formularët nga parografi (3) i këtij nenit t'i ruajnë si pjesë përbërëse të evidentimit të plotë për veprim me hedhurinë.

(8) Personat juridikë dhe fizikë nga parografi (1) i këtij nenit janë të obliguar që, një herë në vit, të dhënat nga evidencat – në formë të raportit të konsoliduar në formular të përcaktuar – t'ia paraqesin organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor, më së voni deri më 31 janar në vitin në vijim për vitin e kaluar.

(9) Me përjashtim nga parografi (8) i këtij nenit, personat fizikë dhe juridikë të cilët grumbullojnë dhe transportojnë hedhurinë komunale dhe lloj tjeter të hedhurinës të parrezikshme janë të obliguar që një herë në vit të dhënat nga evidencat t'ia dërgojnë prefektit të komunës dhe Qytetit të Shkupit, në formë të raportit të konsoliduar në formular të përcaktuar, më së voni deri më 31 janar në vitin në vijim për vitin e kaluar.

(10) Prefekti i komunave dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguar që të dhënat nga parografi (9) i këtij nenit, në formë të raportit vjetor të konsoliduar të përgatitur në formular të përcaktuar, t'ia dërgojë organit kompetent për kryerjen e punëve kompetente nga lëmi i mjedisit jetësor, më së voni deri më 31 mars gjatë vitit në vijim për vitin e kaluar.

(11) Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar që të dhënat nga evidentimi nga parografi 1 i këtij nenit t'i ruajnë më së paku pesë vjet, përvëç operatorëve të deponive të cilët kanë obligim t'i ruajnë të dhënat nga evidentimi deri në mbarim të afatit të caktuar për punë të deponisë, si dhe në afatin e zgjatjes së fazës në përkujdesje të mëtejme pas mbylljes së deponisë.

(12) Forma dhe përmbajtja e formularëve nga paragrafët (6) dhe (8) të këtij nenit i përcakton ministri, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor.

## Neni 40

### **Veprimi me hedhurinën që gjendet në pasuri në pronësi private**

(1) Veprimi me hedhurinën që gjendet në pasuri private, por i cili mund t'i shkaktojë pasojat nga nenit 24 të këtij ligji, është obligim i pronarit ose shfrytëzuesit të pasurisë.

(2) Nëse pronari ose shfrytëzuesi i pasurisë në të cilën gjendet hedhurina nuk e mënjanon hedhurinën në mënyrë të paraparë me këtë ligj, hedhurinë do ta largojë dhënësi i shërbimit, përkatësisht i personit fizik ose juridik i autorizuar për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës në bazë të aktit juridik të dhënë nga prefekti i komunës, përkatësisht prefekti i Qytetit të Shkupit me shpenzimin e pronarit ose shfrytëzuesit të pasurisë.

(3) Nëse hedhurina është lënë në pronë private pa lejen e pronarit ose shfrytëzuesit të pronës, pronari ose shfrytëzuesi i pronës e informon

prefektin e komunës dhe Qytetit të Shkupit, i cili duhet të ndërmarrë masa adekuate për mënjanimin e hedhurinës, si dhe masa kundër krijuesit.

(4) Nëse ekzistojnë njohuri se në pronë që është në pronësi private ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga neni 32-a paragrafi (7) të këtij ligji dhe/ose kryhet magazinim dhe grumbullim i hedhurinave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, inspektori i autorizuar për mjedis jetësor dhe/ose inspektori shtetëror për mjedis jetësor, kanë të drejtë të kryejnë mbikëqyrje inspektuese në pronë që është në pronësi private.

## **Neni 41**

### **Mirëmbajtja e pastërtisë publike**

(1) Prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit janë të obliguar që ta mirëmbajnë pastërtinë publike dhe të veprojnë me hedhurinën e lëshuar në sipërfaqet publike dhe komunikacionit në mjediset urbane dhe në hapësirën e paurbanizuar të rajonit të vet në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

## **Neni 42**

### **Autorizimi për ndërmarrjen e masave të përkujdesit**

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor, në bashkëpunim me ministritë tjera kompetente, institucionet shtetërore, organizatat, persona fizikë dhe juridikë, i ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë, nëse në bazë të njohurive të cilat dalin nga niveli ekzistues i zhvillimit të shkencës dhe të teknikës mund të vlerësohet se disa veprimtari dhe aktivitete lidhur me menaxhimin me hedhurinën mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, para se të fitohen dëshmi shkencore se do të vijë deri te paraqitja e pasojave të dëmshme.

## **IV. VEPRIMI ME HEDHURINËN E PARREZIKSHME**

### **IV.1. VEPRIMI ME HEDHURINËN E PARREZIKSHME**

#### **Neni 42-a**

##### **Obligimi për dorëzimin e hedhurinës**

Personat juridikë dhe fizikë që krijojnë ose posedojnë hedhurinë komunale ose lloj tjetër të hedhurinës janë të detyruar hedhurinën t'ia dorëzojnë personave fizikë dhe juridikë që posedojnë leje për grumbullim dhe/ose transportim të hedhurinës, respektivisht leje për kryerje të veprimtarisë magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave, ose ta vënë në vende të caktuara nga ana e kryetarit të komunës, të komunës në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

## **Neni 43**

### **Rregullat për veprim me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të hedhurinës së parrezikshme**

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor i përcakton rregullat e përgjithshme për veprim me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të hedhurinës së parrezikshme.

(2) Rregullat e veçanta për veprim me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të parrezikshme në rajonin e vet i përcaktojnë, me rregull të veçantë këshilli i komunave dhe Qytetit të Shkupit, me propozim të prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit.

(3) Personat fizikë dhe juridikë të cilët krijojnë hedhurinë komunale dhe lloj tjetër të hedhurinës së parrezikshme janë të obliguar që ta selektojnë hedhurinë sipas llojit dhe sipas karakteristikave të saja, në pajtim me rregullat nga neni 1 dhe 2 të këtij neni dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(4) Personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (3) të këtij neni janë të obliguar që ta grumbullojnë hedhurinën e tyre dhe t'i dorëzojnë dhënësit të shërbimit për grumbullimin e hedhurinës komunale dhe të parrezikshme në rajonin e komunës ose të Qytetit të Shkupit.

(5) Para se ta dorëzojnë hedhurinën në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (3) i këtij neni janë të obliguar që komponentët shfrytëzuese nga hedhurina komunale t'i dorëzojnë në vendet (qendrat grumbulluese) të përcaktuara për grumbullimin e hedhurinës së selektuar.

(6) Hedhurinat komunale dhe llojet tjera të parrezikshme grumbullohen dhe transportohen nga ana e personave fizikë dhe juridikë, të cilët janë regjistruar për kryerjen e veprimtarisë dhe që posedojnë leje për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës, në pajtim me nenin 45 nga ky ligj.

(7) Personat juridikë dhe fizikë që krijojnë ose posedojnë lloj tjetër të hedhurinës jo të rrezikshme në sasi më të vogla se të caktuarat me nenin 21 paragrafi (1) nga ky ligj detyrohen t'i shfrytëzojnë shërbimet e dhënësit të shërbimit nga paragrafi (4) të këtij neni.

(8) Krijuesit e hedhurinës komunale janë të obliguar të lidhin marrëveshje të veçantë për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës me dhënësin e shërbimit në rajonin e komunës ose Qytetit të Shkupit.

(9) Personat juridikë dhe fizikë të cilët në kryerjen e veprimtarisë së tyre gjatë një viti kalendarik krijojnë ose posedojnë hedhurina më shumë se sasitë e caktuara në nenin 21 paragrafi (1) nga ky ligj, mund të lidhin marrëveshje për grumbullim dhe/ose për transportimin e hedhurinës komunale dhe llojit tjetër të hedhurinës jo të rrezikshme me persona juridikë dhe fizikë që kanë leje për kryerjen e veprimtarisë.

## Neni 44

### **Grumbullimi dhe selektimi i hedhurinës komunale**

(1) Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar që hedhurinën komunale që e krijojnë, ta lënë në vendet për grumbullimin dhe selektimin e hedhurinës komunale, të caktuar nga prefekti i komunave dhe Qyteti i Shkupit.

(2) Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar ta ndajnë pjesën e rrezikshme të përmbajtur në hedhurinën komunale dhe ta lënë në vendet për grumbullimin e pjesë së rrezikshme të hedhurinës komunale, të caktuar nga prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit.

(3) Dhënësit e shërbimeve janë të obliguar që në vendet nga paragrafi (1) të këtij neni të vendosin enë për grumbullimin dhe selektimin e hedhurinës komunale, me të cilat mundësohet selektimi i hedhurinës para grumbullimit të saj, e veçanërisht grumbullimin e pjesë së së rrezikshme të përfshirë në hedhurinën komunale.

(5) Prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit kujdesen për përbushjen e obligimit nga paragrafi (3) të këtij neni. **[6]**

## **Neni 45**

### **Lejet për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës komunale dhe llojeve tjera të hedhurinës së parrezikshme**

(1) Grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve tjera të hedhurinës së parrezikshme, mund ta bëjnë personat juridikë dhe fizikë, të cilët posedojnë leje të dhënë nga Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) të këtij nenii i paraqesin kërkesë përmarrjen e lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve tjera të hedhurinës së parrezikshme organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor.

(3) Për kryerjen e veprimtarisë grumbullim dhe transportim të hedhurinës komunale dhe të hedhurinave tjera të parrezikshme, subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të kenë të punësuar së paku një person me përgatitje profesionale në pajtim me dispozitat për regjistrim për kryerjen e veprimtarisë si dhe të disponojnë me mjete materiale teknike për kryerjen e veprimtarisë.

(4) Personi juridik ose fizik, i cili e ka paraqitur kërkesën, ka të drejtë për ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e lejes, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

(5) Leja për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme, jebet për periudhë kohore që nuk mund të jetë më e gjatë se 20 vjet. Afati i vlefshmërisë së lejes mund të vazhdohet më shumë herë.

(6) Në çdo 5 vjet personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) të këtij neni i paraqesin raport për përgatitjen e tyre teknike dhe kadrovike, si dhe për punën e tyre materialo-financiare Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(7) Nëse vjen deri te ndryshimi në kushtet teknike dhe kadrovike përkryerjen e veprimtarisë, personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) të këtij neni janë të obliguar të paraqesin kërkesë përtëritjen e lejes.

(8) Kërkesa për vazhdimin e lejes detyrimisht duhet të dorëzohet katër muaj, përkatësisht më së voni dy muaj para skadimit të vlefshmërisë, respektivisht nga momenti i paraqitjes së ndryshimeve të parapara nga paragrafi (7) i këtij neni.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, i përcakton formën dhe përbajtjen e kërkesës, formën dhe përbajtjen e lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve tjera të hedhurinës së parrezikshme, si dhe kushtet minimale teknike përkryerjen e veprimtarisë nga paragrafi (3) të këtij neni.

(10) Organi kompetent përkryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor mban evidencë për lejet e lëshuara.

## **Neni 45-a**

### **Heqja e lejes për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave komunale dhe të llojeve tjera të parrezikshme**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e

mjedisit jetësor, miraton aktvendim për heqjen e lejes për tregti me hedhurina të parrezikshme, nëse personat juridikë apo fizikë më shumë se tri herë në periudhe prej tre vjetësh i kanë cenuar kushtet teknike minimale për kryerjen e veprimitarisë dhe transportimit të hedhurinave komunale dhe të llojeve tjera të parrezikshme.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij nenit mund të parashtronhet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhëniet të Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 30 ditësh nga dorëzimi i aktvendimit.

### **Neni 45-b**

(1) Për kërkësën nga nenit 45 paragrafi (2) i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor lëshon leje për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkësës së parashtruar.

(2) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk lëshon leje për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme, përkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkësës për lëshim të lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme në afatin nga paragrafi (1) i këtij nenit, parashtruesi i kërkësës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës pas skadimit të afatit, të parashtrojë kërkësë në sekretarinë e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor që të miratojë aktvendim me të cilin jepet pëlqim përlëshimin e lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkësa parashtronet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkësës nga paragrafi (2) i këtij nenit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Me kërkësën nga paragrafi (2) i këtij nenit, parashtruesi i kërkësës parashtron edhe kopje të kërkësës përlëshimin e lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor detyrohet që në afat prej pesë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkësës nga paragrafi (2) i këtij nenit në sekretarinë, të miratojë aktvendim me të cilin kërkësa përlëshimin e lejes për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinave të komunaleve dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme pranohet apo refuzohet.

(6) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk e miraton aktvendimin nga paragrafi (5) i këtij nenit, parashtruesi i kërkësës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(7) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (6) i këtij nenit, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent përkryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkësës përgjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(8) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dërgohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(9) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk vendos në afatin nga parografi (8) i këtij neni, inspektori do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dërgohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(10) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga parografi (9) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(11) Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga parografi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(12) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga parografi (11) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës në pajtim me paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni dhe/ose nuk ka parashtruar kallëzim në pajtim me paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(13) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga parografi (12) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(14) Në rastin nga parografi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(15) Në rastet nga parografi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(16) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (12) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(17) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (10) i këtij nenit, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(18) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(19) Akti nënligjor nga paragrafi (3) i këtij nenit, do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(20) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (3) i këtij nenit, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 46

### **Mënyra e zbatimit të shërbimit publik nga ana e komunave dhe Qytetit të Shkupit**

(1) Grumbullimi dhe transportimi i hedhurinës komunale, mbajtja e pastërtisë publike dhe trajtimi i hedhurinës komunale, si dhe përdorimi dhe mirëmbajtja e vendeve për grumbullimin e hedhurinave komunale, paraqesin shërbime publike me rëndësi lokale.

(2) Me propozim të prefektëve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, Këshilli i komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të themelojnë ndërmarrje publike për grumbullimin, transportimin dhe/ose trajtimin e hedhurinës komunale dhe të hedhurinës tjetër të parrezikshme.

(3) Dy e më shumë komuna, si dhe komuna dhe Qyteti i Shkupit mund të themelojnë ndërmarrje të përbashkët publike për kryerjen e veprimtarisë nga paragrafi (2) i këtij nenit.

(4) Grumbullimin, transportimin dhe/ose trajtimin e hedhurinave të parrezikshme komunale dhe llojeve tjera të hedhurinave të parrezikshme, për një ose më shume komuna, kryetari i komunës dhe i qytetit të Shkupit mund t'i ngarkojnë personave juridikë dhe fizikë, në procedurë në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

(5) Ndërmarrjet publike nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij nenit dhe personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (4) i këtij nenit doemos duhet të posedojnë leje për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës, të dhënë në pajtim me nenin 45 nga ky ligj si dhe leje në pajtim me nenin 32 të këtij ligji.

(6) Marrëveshja nga paragrafi (4) i këtij nenit hyn në fuqi nga dita e marrjes së lejes nga ana e këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit.

(7) Me marrëveshjen nga paragrafi (4) të këtij nenit detyrimisht përcaktohen kushtet dhe mënyra e punës së dhënësit të shërbimit, çmimi dhe mënyra e pagesës së shërbimit dhe rajoni në të cilin bëhet shërbimi.

(8) Në rastet nga paragrafi (3) të këtij nenit dhe kur marrëveshja nga paragrafi (4) i këtij nenit u dedikohet dy e më shumë komunave ose Qytetit të Shkupit, komunat ose Qyteti i Shkupit lidhin marrëveshje të përbashkët.

(9) Komunat dhe/ose Qyteti i Shkupit, të cilët kanë lidhur marrëveshje nga paragrafi (9), mund të tërhiqen nga marrëveshja veçanërisht nëse të gjitha palët nga marrëveshja pajtohen për tërheqje nga marrëveshja.

(10) Në rast kur është marrë leja për grumbullim, transportim dhe/ose trajtim të hedhurinës komunale, dhënësi i shërbimit, prefekti i komunës dhe Qytetit të Shkupit, ngrenë procedurë për prishjen e marrëveshjes nga paragrafi (4) të këtij nenit, në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

(11) Për mbrojtjen e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, si dhe përvendosjen e sistemit të integruar përmenaxhim me hedhurina të parrezikshme komunale dhe llojtit tjetër të hedhurinave të parrezikshme në nivel rajonal, procedurën për ndarjen e koncesionit ose partneriteti privat publik për veprimtaritë nga paragrafi (4) i këtij neni me pëlgjim paraprak nga komunat dhe qyteti i Shkupit, mund ta zbatojë organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 47

### Sigurimi i zbatimit të parimit të univerzalitetit në shërbimin e nivelit lokal

(1) Këshilli i komunave dhe Qytetit të Shkupit, me propozim të prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, në bazë të dispozitave të përgjithshme të miratuar në pajtim të nenit 43 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, në pajtim me parimin e univerzalitetit të shërbimit, do t'i përcaktojnë kushtet, mënyrën dhe skemat për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës komunale dhe të llojeve të hedhurinës së parrezikshme, si dhe procedurat për ndarjen e komponentave të rrezikshme nga hedhurina komunale.

(2) Me dispozitën nga paragrafi (1) i këtij neni do të përcaktohet edhe:

- 1) rrajan ku do të zbatohet shërbimi universal;
- 2) kushtet që duhet t'i plotësojë dhënësi i shërbimit;
- 3) rregullimi i mënyrave në të cilat do të shfrytëzohen shërbimet;
- 4) llojet e masave ndëshkuese dhe stimulative;
- 5) kërkesat teknike dhe tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e shërbimeve për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës komunale dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike, dhe
- 6) mënyra e caktimit të kompensimit për shërbimet e kryera.

(3) Prefekti i komunave dhe i Qytetit të Shkupit janë të obliguar që, përveç shpalljes në gazetat zyrtare të komunave dhe Qytetit të Shkupit, t'i informojnë shfrytëzuesit e shërbimeve për aktet e miratuar nga paragrafi (1) i këtij neni.

## IV.2. Veprimi me llojet e veçanta të hedhurinës së parrezikshme

### 1. Veprimi me hedhurinën nga prodhimet dhe paketimet

## Neni 48

### Obligimet e përgjithshme për prodhuesin

(1) Gjatë dizajnit të prodhimit dhe të paketimit, prodhuesi është i obliguar të shfrytëzojë teknologji, e cila mundëson përdorimin e sërishtëm më efikas të materialit dhe të energjisë, ta stimulojë ripërdorimin dhe përpunimin e prodhimit dhe të paketimit, kurse në ciklin e fundit të jetës së prodhimit dhe të paketimit prodhuesi duhet të mundësojë trajtim të qëndrueshëm ekologjik, përdorimin, përpunimin ose mënjanimin e prodhimit të shfrytëzuar dhe të paketimit.

(2) Gjatë procesit të prodhimit, prodhuesi duhet të shfrytëzojë lëndë, materiale dhe gjysëmfabrikate me të cilat zvogëlohet krijimi i hedhurinës dhe përdorimi i energjisë dhe materialeve.

(3) Gjatë procesit të prodhimit, prodhuesi është i detyruar që t'i mënjanohet përdorimit të materialeve dhe/ose produkteve që përbajnë substancë të rrezikshme në sasi dhe/ose koncentrime që ndikojnë negativisht ndaj shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor gjatë procesit

të prodhimit, gjatë përdorimit të tyre ose gjatë veprimit me produktin kur bëhet hedhurinë.

## Neni 49

### Informimi i prodhuesve dhe i konsumatorëve

(1) Prodhuesi dhe importuesi i prodhimit janë të obliguar që ta informojnë shitësin dhe konsumatorin me karakteristikat e rëndësishme të prodhimit dhe të paketimit lidhur me menaxhimin me hedhurinën, si dhe me mënyrën e veprimit në rast të ciklit të fundit të jetës së prodhimit dhe të paketimit.

(2) Prodhuesi dhe importuesi janë të obliguar që secilin prodhim ose paketim ta shënojë në mënyrën, me të cilën do të sigurojë të dhëna për ripërdorimin e prodhimit dhe të paketimit, të dhëna për përtëritjen e prodhimit dhe të paketimit, si dhe për mënyrën e veprimit në rast të ciklit të fundit të jetës së prodhimit dhe paketimit.

(3) Të dhënat nga paragrafi (2) të këtij neni duhet të jenë të shënuara në vend të dukshëm të prodhimit ose paketimit.

(4) Prodhuesi dhe importuesi mund të themelojnë mbledhje dhe pranim të kthyeshëm të prodhimeve të shfrytëzuara dhe të paketimit.

(5) Zbatimi i dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me shënimin, nuk duhet t'i pengojë marrëdhëniet tregtare dhe pozitën e barabartë të tregut midis prodhuesve dhe distribuesve të vendit dhe të huaj, në pajtim me parimet për barazi dhe mosdiskrimin.

(6) Mënyrën e shënimit të prodhimit dhe paketimit, llojin e shënimive dhe përbajtjen e tyre bëhet në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

## Neni 50

### Grumbullimi dhe ripranimi i prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara

(1) Gjatë shitjes së prodhimeve dhe paketimeve për të cilat është caktuar pagesa e kaucionit, blerësi është i obliguar që ta paguajë kaucionin dhe për të t'i japë blerësit llogari adekuate ose vërtetim, i cili do të shërbejë si dëshmi për kaucionin e paguar.

(2) Shitësi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar t'ia kthejë kaucionin e paguar blerësit, nëse blerësi e kthen prodhimin dhe/ose paketimin e shfrytëzuar, për çka ofron dëshmi për kaucionin e paguar nga shitësi nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Shitësi nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe prodhuesi ose importuesi janë të obliguar t'i rimarrin prodhimet dhe/ose paketimet e shfrytëzuara që i shesin përkatësisht që i prodhojnë ose importojnë.

(4) Prodhuesi, importuesi dhe/ose shitësi, mund të themelojnë sistem të përbashkët për grumbullimin dhe për pranim kthyes të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimin, si dhe sistem për kompensimin e kaucionit të paguar për prodhimin dhe paketimin.

(5) Personat juridikë dhe fizikë që bëjnë grumbullim, ripranim, përpunim ose mënjanim të hedhurinës nga produktet dhe paketimet e shfrytëzuara janë të detyruar të mbajnë dhe të ruajnë evidencë për sasitë që i kanë grumbulluar, përpunuuar ose larguar, si dhe ta informojnë opinionin për mënyrën e realizimit të sistemit për mbledhje edhe për pranim të kthyeshëm të produkteve dhe paketimeve të shfrytëzuara

(6) Grumbullim dhe pranim të kthyeshëm të produkteve dhe paketimeve të shfrytëzuara bëhet në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

## **Neni 51**

### **Leje për themelim të sistemit për grumbullim dhe pranim kthyes të prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara**

(1) Personat juridikë dhe fizikë të cilët duan të themelojnë sistem për grumbullim dhe pranim kthyes të prodhimeve dhe paketimeve të caktuara të shfrytëzuara duhet të posedojnë leje e cila lëshohet në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe me ligje të tjera.

(2) Lejen nga paragrafi (1) të këtij nenit e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor, në bazë të kërkesës më shkrim të personave juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) të këtij nenit e cila përmban në veçanti:

- 1) identifikim të kërkuesit - të dhëna emri/emërtimi dhe selia;
- 2) regjistrim për veprimtari të grumbullimit dhe/ose trajtim me mbeturina
- 3) lloj të prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara me të cilët do të trajtohet në sistem dhe
- 4) periudhën kohore për të cilën kërkohet leja.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (2) të këtij nenit personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi 1 i këtij nenit janë të detyruar të dorëzojnë:

- 1) program për grumbullim dhe pranim kthyes të prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara;
- 2) provë për përbushje të kushteve minimale-teknike për kryerje të veprimtarisë në pajtim me këtë ligj;
- 3) të dhëna për sistemin për grumbullim dhe për pranim të sérishëm të prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara në mënyrë të pavarur, ose bashkë me prodhues ose importues të tjerrë të cilët posedojnë mjete dhe pajisje, impiante dhe instalime që i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe sigurojnë trajtimin me mbeturinat në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër dhe
- 4) Provë se në mënyrë të pavarur, ose bashkë me nënrealizues dhe/ose importues ka siguar kushte për përpunim dhe mënjanim të mbeturinave në pajtim me këtë ligj dhe me dispozita të tjera.

(4) Leja nga paragrafi (1) i këtij nenit lëshohet për periudhë kohore e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dhjetë vite.

(5) Përveç dokumenteve nga paragrafi (3) i këtij nenit, ndërsa në varësi nga lloji i prodhimeve dhe paketimeve të shfrytëzuara për të cilat kërkohet leja nga paragrafi (1) i këtij nenit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor, sipas nevojës mund të kërkojë që kërkuesi të paraqesë edhe të dhëna të tjera shtesë në pajtim me këtë ligj.

(6) Në qoftë se vjen deri te ndryshimi i të dhënave të përcaktuara me lejen nga paragrafi (1) i këtij nenit, personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të paraqesin kërkeshë për ndryshim të lejes.

(7) Kërkeshë për ndryshim të lejes medoemos të paraqitet më së voni në afat prej dy muajsh, nga momenti i krijimit të ndryshimeve të përcaktuara në nenin (6) të këtij nenit.

(8) Kërkesa për përtëritjen e lejes medoemos të paraqitet më së voni në afat prej dy muajsh para skadimit të vlefshmërisë së lejes.

(9) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në ambientin jetësor mban evidencë për lejet e dhëna.

## **Neni 52**

### **Obligimi i shitësit, prodhuesit ose importuesit**

(1) Prodhimet dhe paketimet, të cilat shkaktojnë ndikim negativ ndaj

mjedisit jetësor dhe të cilat mund të ripërdoren dhe/ose përpunohen, pas shfrytëzimit të tyre detyrimisht i kthehen shitësit në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

(2) Prodhimet dhe paketimet nga paragrafi (1) të këtij neni shënohen me shenjë të veçantë.

(3) Shitësi i prodhimeve nga paragrafi (2) është obliguar i t'i ripranojë prodhimet e shfrytëzuara dhe paketimet, nëse blerësi ia sjellë shitësit dhe ofron dëshmi se prodhimin dhe paketimin ia ka shitur i njëjtë shitës.

(4) Shitësi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar të lidhë marrëveshje pér pranimin ose grumbullimin e prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimit me prodhuesin, importuesin ose person tjetër të autorizuar juridik dhe fizik, i cili mund t'i përpunojë edhe prodhimet e shfrytëzuara dhe paketimet, si dhe të formojnë sistem të përbashkët pér kthimin e prodhimeve dhe paketimeve.

(5) Prodhesi ose importuesi i prodhimeve dhe paketimeve nga paragrafi (1) të këtij neni, pér prodhimet dhe paketimet e veta mund të formojnë sisteme të pranimit dhe grumbullimit të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimeve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(6) Blerësi është i obliguar që pas shfrytëzimit të prodhimit dhe paketimit nga paragrafi (1) të këtij neni t'ia kthejë shitësit, përkatësisht prodhesit ose importuesit ose personit fizik ose juridik të autorizuar nga ata në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

## **Neni 53**

### **Obligimi i konsumatorit**

(1) Konsumatori është i obliguar ta shfrytëzojë prodhimin dhe paketimin sipas udhëzimit nga prodhesi ose importuesi, në mënyrën me të cilën nuk do ta rrezikojë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

(2) Konsumatori ka obligim ta selektojë hedhurinën deri në shfrytëzimin e prodhimit dhe paketimit dhe të njëjtët është i obliguar t'ia dorëzojë:

- 1) shitësit, i cili ia ka shitur prodhimin, ose prodhesit ose importuesit, nëse në prodhim qëndron shenja adekuate pér veprim me prodhimin e shfrytëzar dhe paketimin;
- 2) personit juridik dhe fizik, të cilët grumbullojnë hedhurina, ose
- 3) personit juridik dhe fizik, i cili ka leje pér përpunimin e hedhurinës.

## **2. Veprimi me hedhurinën interne**

### **Neni 54**

#### **Rregullat pér veprim me hedhurinën interne**

(1) Me hedhurinën interne veprohet në pajtim me dispozitat nga ky ligj.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën interne, janë të obliguar të sigurojnë dëshmi se hedhurina interne nuk do të tretet, digjet ose në mënyrë tjetër fizikisht ose kimikisht të reagojë, të bioshkatërohet ose në mënyrë tjetër të ndikojë në materie tjetër me të cilën bie në kontakt, me çka do të shkaktohet rrezikim i mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(3) Personat fizikë dhe juridikë të cilët gjatë realizimit të punëve ndërtimore, përpunuese, zejtarisë dhe veprimitari tjera krijojnë hedhurinë interne (hedhurinë ndërtimi), e cila nuk ka cilësi të hedhurinës komunale, janë të obliguar vetë ta grumbullojnë dhe ta transportojnë hedhurinën në vende të caktuara nga komunat dhe Qyteti i Shkupit ose të njëjtët t'ua dorëzojnë personave të autorizuar fizikë dhe juridikë, të cilët grumbullojnë

dhe transportojnë hedhurinë.

(4) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (3) të këtij nenit janë të obliguar të posedojnë dëshmi se hedhurina ndërtimore dhe hedhurina tjetër interne, që është krijuar gjatë realizimit të aktiviteteve nga paragrafi (3) nga ky nen, ia kanë dorëzuar në mënyrë të caktuar me paragrin (3) të këtij nenit.

(5) Këshilli i komunave dhe Qytetit të Shkupit, me propozim të prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, i caktojnë vendet për trajtimin dhe mënjanimin e hedhurinës interne, në pajtim me planet komunale, planin e Qytetit të Shkupit, për menaxhim me hedhurinën dhe në pajtim me planet urbanistike hapësinore.

### **3. Vodosja me hedhurinën industriale të parrezikshme**

#### **Neni 55**

##### **Rregullat për veprim me hedhurinën industriale të parrezikshme**

(1) Krijuesi dhe/ose poseduesi i hedhurinës industriale të parrezikshme është i obliguar ta përpunojë hedhurinën që krijohet me kryerjen e veprimitarive, në mënyrë të caktuar me këtë ligji.

(2) Me hedhurinën industriale të parrezikshme veprohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 56**

##### **Formulari identifikues për hedhurinën industriale të parrezikshme**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën industriale të parrezikshme, janë të obliguar të dorëzojnë formular identifikues, nëse hedhurina është imponuar për transportin, në pajtim me nenin 39 të këtij ligji.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën industriale të parrezikshme, janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave të shkruara në formularin identifikues nga paragrafi (1) i këtij nenit.

(3) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën industriale të parrezikshme, nuk guxojnë ta marrin hedhurinën pa e marrë formularin identifikues.

(4) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën industriale të parrezikshme, janë të obliguar t'i dorëzojnë ekzemplarë nga formulari identifikues prefektit të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

### **V. Veprimi me hedhurinën e rrezikshme**

#### **V.1. RREGULLAT PËR VEPRIM ME HEDHURINËN E RREZIKSHME**

#### **Neni 57**

##### **Rregullat për veprim me hedhurinën e rrezikshme**

(1) Veprimi me hedhurinën e rrezikshme bëhet në mënyrë të ndarë nga

## Ilojet tjera të hedhurinave

(2) Ndalohet derdhja dhe hedhja e hedhurinës së rrezikshme në tokë, në ujë, në enë për hedhurina komunale, sisteme kanalizimi dhe të infrastrukturës dhe në objekte, si dhe deponimi i saj dhe mënjanimi në vende, të cilat nuk janë paraparë për atë qëllim.

(3) Ndalohet ndezja ose djegia e hedhurinës së rrezikshme në vendet që nuk janë paraparë për atë dedikim, si dhe shfrytëzimi i mjeteve dhe instalimeve gjatë djegies, të cilat mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, i përcakton kushtet më të përaferta për veprim me hedhurinën e rrezikshme.

## Neni 58

### **Ndalimi i përzierjes së hedhurinës së rrezikshme**

(1) Ndalohet përzierja e hedhurinës së rrezikshme me lloje tjera të hedhurinës së rrezikshme, si dhe përzierja e hedhurinës së rrezikshme me hedhurinë të parrezikshme.

(2) Me përashtim nga paragafi (1) të këtij neni, organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, me kërkesë me shkrim nga krijuesi ose poseduesi i hedhurinës së rrezikshme, në pajtim me këtë ligj ose me dispozitë tjetër, do të lejojë përzierjen e hedhurinës së rrezikshme me lloje tjera hedhurinash të rrezikshme, si dhe përzierjen e hedhurinës së rrezikshme me lloje tjera të hedhurinave, me substanca dhe/ose me materiale, nëse konstaton se janë plotësuar rregullat për veprim me hedhurina nga neni 24 të këtij ligji dhe se me atë do të përmirësohet siguria gjatë veprimit me hedhurinë të rrezikshme dhe se përzierja nuk i rezikon mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

## Neni 59

### **Veprimi me hedhurinën e përzier**

(1) Në rast kur hedhurina e rrezikshme është përzier me lloje tjera të hedhurinës, substanca dhe materiale, detyrimisht informohet organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor.

(2) Për hedhurinën nga parografi (1) i këtij neni, doemos duhet të qaset drejt ndarjes së saj, nëse procedura e ndarjes është e mundshme teknikisht dhe e pagueshme ekonomikisht dhe e zvogëlon rrezikun ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve edhe kur është e domosdoshme për plotësimin e rregullave për veprim me hedhurinat nga neni 24 të këtij ligji.

(3) Veprimi me hedhurinën e rrezikshme nga paragrafi (1) i këtij neni dhe fillimit të procedurës nga paragrafi (2) i këtij neni, bëhet në bazë të kërkesës për marrjen e pëlqimit nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor.

(4) Me kërkesën për dhënien e pëlqimit nga paragrafi (3) i këtij neni, kërkuar është i obliguar të paraqesë edhe sertifikat për vlerësimin e bërë të karakteristikave të hedhurinës.

## Neni 60

### **Evidencimi dhe klasifikimi i detyrueshëm i hedhurinës së rrezikshme**

(1) Krijuesi i hedhurinës së rrezikshme dhe personat juridikë dhe fizikë të

cilët veprojnë me hedhurinën e rrezikshme, janë të obliguar të mbajnë evidencë, në pajtim me nenin 39 nga ky ligj, veçanërisht evidencë të karakteristikave të rrezikshme të hedhurinës së rrezikshme të krijuar dhe ta klasifikojnë sipas Listës për llojet e hedhurinës.

(2) Krijuesi, poseduesi dhe përpunuesi mbajnë evidencë për hedhurinën e rrezikshme që është deponuar në vendin ku është krijuar, përkatësisht dorëzuar personit fizik ose juridik të autorizuar për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës së rrezikshme.

(3) Operatori i deponisë dhe operatori i instalimeve për mënjanimin e hedhurinës së rrezikshme, janë të obliguar ta evidentojnë dhe ta identifikojnë hedhurinën e rrezikshme që është pranuar për mënjanim.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1), (2) dhe (3) nga ky nen, në formë të raportit, i dorëzohen një herë në vit organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor në pajtim me nenin 39 nga ky ligj.

(5) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij nen, të cilët menaxhojnë me hedhurinën e rrezikshme, janë të obliguar t'i ruajnë të dhënat në pajtim me nenin 39 nga ky ligj më së paku pesë vjet.

## Neni 61

### **Formulari identifikues për hedhurinë të rrezikshme**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën e rrezikshme, janë të obliguar të jasin formular identifikues dhe t'i bashkëngjisin raport për karakteristikat e hedhurinës, nëse hedhurina është e dedikuar për transport, në pajtim me nenin 39 nga ky ligj.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën e rrezikshme, janë përgjegjës për saktësinë e të dhënavë të shkruara në formularin identifikues nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinën e rrezikshme, nuk guxojnë ta marrin hedhurinën pa e marrë formularin identifikues.

(4) Personat fizikë dhe juridikë, të cilët veprojnë me hedhurinën e rrezikshme, janë të obliguar t'i dorëzojnë ekzemplarë nga formulari identifikues organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor.

## Neni 62

### **Kontrolli i karakteristikave të hedhurinës**

(1) Kontrolli i karakteristikave të hedhurinës bëhet për shkak të:

- 1) importit dhe eksportit të hedhurinës;
- 2) trajtimit edhe përpunim të hedhurinës dhe
- 3) heqjen e hedhurinës.

(2) Kontrollet nga paragrafi (1) të këtij neni bëhen nga ana e personit juridik i cili është i autorizuar të bëjë kontrollin e karakteristikave të hedhurinës në pajtim me vëllimin e kontrollit për të cilin është akredituar.

(3) Marrja e kampioneve të hedhurinave dhe kontrolli i karakteristikave të hedhurinës bëhet me zbatimin e normave dhe standardeve relevante, nacionale, evropiane dhe ndërkontinentare.

(4) Kontrolli i karakteristikave të hedhurinës bëhet për të gjitha llojet e hedhurinës, përvëç për hedhurinën komunale.

(5) Secili që dyshon në atë se hedhurina përmban karakteristika të rrezikshme, respektivisht se nuk u përgjigjet të dhënavë të deklaruara,

është i detyruar për atë që ta informojë organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

(6) Në rastin kur dyshimi në karakteristikat e hedhurinës është treguar si i arsyeshëm, shpenzimet për kontrollin e hedhurinës bien në llogari të krijuesit dhe/ose poseduesit të hedhurinës. Nëse dyshimet në karakteristikat e hedhurinës është treguar se janë të paarsyeshme, shpenzimet për kontrollimin e hedhurinës bien mbi paraqitësin.

(7) Personat juridikë nga paragrafi (2) të këtij neni, përgatitin raport për kontrollin e karakteristikave të hedhurinës dhe janë të detyruar një kampion nga rapporti ta dorëzojnë në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

## Neni 63

### Kushtet për marrjen e autorizimit të kontrollit të karakteristikave të hedhurinës

(1) Që të marrin autorizim për kontrollin e karakteristikave të hedhurinës, personat juridikë janë të detyruar që të dorëzojnë në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor kërkesë e cila i përban të dhënët si vijon:

- 1) certifikatën për akreditim për kryerjen e kontrolleve laboratorike;
- 2) listën e personave që do t'i kryejnë punët e kontrollit të karakteristikave të hedhurinës me llojin dhe shkallën e përgatitjes profesionale, respektivisht titullin shkencor;
- 3) listën e pajisjes me numrin e inventarit;
- 4) numrin dhe dedikimin e lokaleve (skica etj.);
- 5) listën e karakteristikave të hedhurinave që do të kontrollohen dhe
- 6) listën e metodave që do të zbatohen për kontrollet adekuate.

(2) Autorizimin nga paragrafi (1) të këtij neni e jep ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor me propozimin e komisionit të cilin do ta formojë ministri për një periudhë prej katër vjetësh e cila mund të vazhdohet.

(3) Autorizimi për kontrollin e karakteristikave të hedhurinës mund t'i merret nëse konstatohet në mënyrë plotësuese se personi juridik i autorizuar nuk i plotëson kushtet e përcaktuar ose konstatohet se autorizimi është dhënë në bazë të të dhënavë jo të sakta dhe/ose të pavërteta.

(4) Autorizimet dhe marrja e autorizimit nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor mban evidencë të personave juridikë dhe fizikë që kanë marrë autorizim për kontrollin e karakteristikave të hedhurinës që është në qasje për opinion dhe e shpall në ueb faqen e vet.

## Neni 64

### Paketimi adekuat dhe shënimi i hedhurinës së rrezikshme

(1) Hedhurina e rrezikshme që është e dedikuar për transportim, përpunim, deponim dhe për mënjanim, doemos duhet të jetë e paketuar dhe shënuar në mënyrë të caktuar, me çka sigurohet mbrojtja e plotë e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(2) Mbeturina e rrezikshme paketohet në enë të veçanta, të konstruktuara varësisht nga lloji i hedhurinës (ndezës, eksplozues, infektues etj.), në të cilat detyrimisht duhet të qëndrojë shenja "Hedhurinë e rrezikshme".

(3) Ministri i Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e përcakton

mënyrën e paketimit dhe shënimin e hedhurinës së rrezikshme.

(4) Ndalohet transportimi i hedhurinës së rrezikshme që nuk është e paketuar dhe shënuar në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

## **Neni 65**

### **Marrëveshja për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme**

(1) Personat fizikë dhe juridikë, të cilët krijojnë ose posedojnë hedhurinë të rrezikshme, mund të lidhin marrëveshje për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme me persona juridikë, të cilët posedojnë leje për grumbullim dhe transportim të hedhurinës së rrezikshme.

(2) Transportimi i hedhurinës së rrezikshme bëhet në pajtim me Ligjin për transportimin e materieve të rrezikshme, si dhe në bazë të konventave ndërkombëtare, të cilat e rregullojnë këtë lëmi.

(3) Personat juridikë për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme nga paragrafi (1) i këtij neni, themelojnë skemë për transportimin e hedhurinës së rrezikshme nga vendi i krijimit të saj në pajtim me planin për menaxhim me hedhurinën e Republikës së Maqedonisë.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor, jep pëlqim për skemën e vendosur nga paragrafi (3) të këtij neni.

(5) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë sasi më të vogla hedhurinë të rrezikshme, mund ta deponojnë hedhurinën, në pajtim me ligjin dhe dispozitat tjera dhe janë të obliguar t'i informojnë personat juridikë për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme nga paragrafi (1) i këtij neni se kur mund ta grumbullojnë dhe ta transportojnë hedhurinën e rrezikshme.

## **Neni 66**

### **Leja për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme**

(1) Leja për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës së rrezikshme fitohet në bazë të kërkesës me shkrim dërguar Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, e cila kryesisht duhet të përbajë:

- 1) identifikimin e kërkuesit;
- 2) të dhënat për kapacitetet organizative dhe udhëheqëse të kërkuesit në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat për transport të materieve të rrezikshme;
- 3) të dhënat përgatitjen teknike dhe për mjetet për grumbullim dhe për transportim të hedhurinës së rrezikshme në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat për transport të materieve të rrezikshme;
- 4) programi me specifikacionin e llojit dhe të sasisë së hedhurinës së rrezikshme që duhet të jetë grumbulluar dhe transportuar;
- 5) periudhën kohore për të cilën kërkohet dhënia e lejes; dhe
- 6) dëshminë se kërkuesit nuk i është shqiptuar masa e sigurisë, përkatesisht ndalim për kryerjen e veprimitarisë.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, ka të drejtë të kërkojë të dhëna plotësuese, nëse vlerëson se të dhënat e shënuara në kërkesë nuk janë të mjaftueshme për dhëni e lejes.

(3) Personi juridik i cili e ka paraqitur kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e lejes, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

(4) Leja për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës së rrezikshme, jepet për periudhë kohore që nuk mund të jetë më e gjatë se 15 vjet. Afati i vlefshmërisë së lejes mund të vazhdohet më shumë herë.

(5) Kërkesa për vazhdimin e lejes detyrimisht duhet të paraqitet katër e më së voni dy muaj para skadimit të vlefshmërisë së lejes

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin e Transportit dhe Lidhjeve, përcakton formën dhe përbajtjen e lejes për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së rrezikshme.

(7) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor mban evidencë për lejet e lëshuara.

## Neni 67

### Marrja e masave në rast të rrezikut të madh

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë veprimtari të grumbullimit, transportimit, trajtimit, përpunimit, deponimit dhe mënjanimit të hedhurinës, janë të obliguar të përgatitin plan të brendshëm për gjendje të jashtëzakonshme, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrimisht e informojnë Organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor për masat e ndërmarra për siguri dhe mbrojtje nga avaritë, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(3) Në rast kur do të krijohet avaria, si pasojë e menaxhimit joadekuat me hedhurinë, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar t'i ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për mënjanimin e pasojave ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit e njerëzve, që janë paraparë në planet e brendshme për gjendje të jashtëzakonshme, në pajtim me ligjin për mjedisin jetësor.

(4) Nëse avaria e krijuar është me përmasa më të mëdha dhe nëse është e sigurt se personat juridik dhe fizik nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të ballafaqohen dhe t'i mënjanojnë pasojat negative ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit e njerëzve, Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor do të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për mënjanimin e rrezikut, në pajtim me Ligjin e mjedisit jetësor.

## V 2 VEPRIMI ME LLOJET E VEÇANTA TË HEDHURINËS SË RREZIKSHME

## Neni 68

### Veprimi me vajra të ndotur të rrezikshëm

(1) Ndalohet:

- hedhja e vajrave të përdorura dhe mbetja e vajrave të përdorura gjatë përpunimit të tyre në tokë, në ujë, në enët për hedhurina komunale, në sistemet e kanalizimit dhe në sistemet dhe objektet tjera të infrastrukturës, si dhe depozitimi, përpunimi dhe heqja e vajrave të hedhura në vende në të cilat nuk është e paraparë për atë qëllim, dhe
- përpunimi dhe/ose mënjanimi i vajrave të hedhura të cilat shkaktojnë

ndotje të ajrit mbi vlerat kufitare të përcaktuara në pajtim me dispozitat për mbrojtje të ajrit, shëndetit të njerëzve dhe mjedisin jetësor

(2) Ndalohet përzierja e vajrave të ndotur me hedhurinë të rrezikshme dhe të parrezikshme, e veçanërisht përzierja e vajrave të ndotur me BPK/TPK gjatë grumbullimi, transportimit, deponimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të tyre.

(3) Poseduesit e vajrave të hedhur janë të detyruar t'i dorëzojnë vajrat për hedhje në vend grumbullues, në qendrën për grumbullim ose në instalime për përpunim ose për heqjen e vajrave të hedhur;

(4) Poseduesit e vajrave për hedhje varësish me sasitë e vajrave për hedhje që në vit i krijojnë, janë të detyruar të sigurojnë vend grumbullues për vajra të hedhura, depozitimin e tyre të përkohshëm, ose bartjen e tyre të siguruar në qendrën për grumbullim

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, i përcakton procedurat dhe mënyrën e grumbullimit, transportimit, përpunimit, deponimit, trajtimit dhe mënjanimit të vajrave të ndotur, mënyrën e mbajtjes së evidentimit dhe dorëzimin e të dhënavë

## Neni 69

### Veprimi me BPK

(1) Ndalohet:

- 1) prodhimi, importi dhe përpunimi i BPK;
- 2) ripërdorimi dhe përpunimi i BPK hedhurinat, dhe
- 3) rimbushja dhe plotësimi i pajisjes me BPK.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët posedojnë BPK ose ka përmbajtur BPK, BPK e shfrytëzuar dhe pajisjen janë të obliguar t'ia paraqesin sasinë, prejardhjen, natyrën dhe përmbajtjen e BPK, BPK e shfrytëzuar dhe pajisjen, e cila përmban BPK, organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Lloji i pajisjes e cila mund të përmbajë BPK trajtohet si të përmbajë BPK përveç nëse nuk ekziston arsyë të supozohet e kundërtë.

(3) Personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të mbajnë evidencë dhe të bëjnë regjistrimin e pajisjes në pajtim me këtë ligj dhe me dispozita të tjera. Regjistrimi detyrimisht duhet të azhurnohet dhe plotësohet.

(4) Personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar në pajtim me këtë ligj dhe me dispozita tjera të përgatisin plan për dekontaminim dhe/ose heqjen e pajisjes së regjistruar dhe të BPK të përmbajtura në të, si dhe shemave për grumbullim dhe për heqjen e mëtejmë të pajisjes që nuk është lëndë e regjistrimit.

(5) Personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar që ta shënojnë pajisjen që përmban ose ka përmbajtur PHB që është lëndë e regjistrimit si dhe ta shënojë vendin ose lokacionin ku është vendosur pajisja e tillë në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat tjera.

(6) Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do t'i përcaktojë mënyrën dhe kushtet për veprim me BPK, mënyrën dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë instalimet dhe objektet për mënjanimin dhe për dekontaminimin e BPK, BPK e shfrytëzuara, mënyrën e shënimit të pajisjes, e cila përbën BPK, si dhe mënyrën e shënimit të lokalit ose lokacionit ku është vendosur pajisja e tillë.

## Neni 70

### Veprimi me bateritë dhe akumulatorët e harxhuar

*Jashtë fuqisë* 7**Neni 71****Veprimi me hedhurinën nga pajisjet elektrike dhe elektronike***Jashtë fuqisë* 8**Neni 71-a****Kufizimet dhe ndalesat për përdorim dhe përbajtja e substancave të caktuara në pajisjen elektrike dhe elektronike***Jashtë fuqisë* 9**Neni 71-b****Obligimet e prodhuesit***Jashtë fuqisë* 10**Neni 72****Veprimi me automjetet e shfrytëzuara**

(1) Gjatë planifikimit dhe prodhimit të automjeteve, për shkak të pengimit të ngarkimit të mjedisit jetësor, prodhuesi duhet automjetet t'i dizajnojë ashtu që do të lehtësohet çmontimi i tyre, përdorimi i sérishëm dhe përpunimi, ndërsa veçmas riciklimi i automjeteve të shfrytëzuara, komponentët dhe materialet e tyre.

(2) Prodhuesi është i detyruar të mbajë dhe të ruajë evidencë për të gjitha mjetet transportuese të prodhua dhe/ose të importuara dhe të lëshuara në qarkullim si edhe të sigurojë informata për çmontimin e automjeteve, komponentët e tyre dhe materialet e instaluar.

(3) Pronari i automjetit është i detyruar t'ia dorëzojë automjetin e shfrytëzuar personit juridik ose fizik i cili posedon leje për grumbullim, trajtim ose përpunim në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitë tjetër.

(4) Ndalohet lëshimi në treg i komponentëve dhe materialeve të automjeteve që përbajnë plumb, zhivë, krom gjashtëivalentë dhe kadmium përvëç në sasi ose pjesëmarrje proporcionale të tyre në pajtim me dispozitën nga paragrafi (9) i këtij neni.

(5) Ndalohet heqja ose dorëzimi i komponentëve dhe materialeve nga automjetet e shfrytëzuara si hedhurinë komunale.

(6) Personat juridikë dhe fizikë që bëjnë trajtim ose përpunimin e automjetit të shfrytëzuar janë të detyruar:

- t'i ndajnë komponentët dhe materialet e rrezikshme që paraqesin hedhurinë të rrezikshme dhe/ose që përbajnë hedhurinë të rrezikshme, të njëjtat t'i selektojnë dhe të sigurojnë trajtim ose heqjen e tyre të mëtejme.
- pronarit ose grumbulluesit të automjetit të shfrytëzuar t'i japidh vërtetim përmarrjen e automjetit të shfrytëzuar për prishje;
- të mbajë dhe të ruajë bazë të të dhënavë për ndjekjen e përdorimit dhe përpunimit të sérishëm të automjeteve të përdorura dhe të qëllimeve që duhet të arrihen me përdorim dhe përpunim të sérishëm të automjeteve të përdorura,
- vërtetimin përmarrjen e automjetit të shfrytëzuar për prishje t'ia dorëzojë organit kompetent për regjistrimin e automjetit;

- të mbajnë dhe të ruajnë evidencë për të gjitha fazat e përpunimit ose trajtimit të automjeteve të shfrytëzuar.

(7) Të dhënat e evidencës nga paragrafi (2) dhe (6) alinetë 3 dhe 5 të këtij neni dorëzohen në formular të caktuar më së voni deri 31 mars gjatë vijues për vitin e kaluar kalendarik, në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitë tjetër.

(8) Organi kompetent për kryerjen e punëve kompetente në mjedisin jetësor mban evidencë dhe bazë të të dhënave për të dhënat nga paragrafi (7) të këtij neni.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ekonomisë, i përcakton masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor që detyrimisht duhet t'i ndërmarrin prodhuesit, poseduesit dhe subjektet që veprojnë me automjetet e shfrytëzuar, komponentët dhe materialet e tyre, qëllimet dhe afatet për arritjen e tyre dhe mënyrën dhe kushtet për vendosjen, formën dhe përbajtjen e vërtetimit për marrjen e automjetit për prishje, formën dhe përbajtjen e formularit për lajmërim si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës.

(10) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, i përcakton mënyrën e udhëheqjes si dhe formën dhe përbajtjen e formularit të bazës së të dhënave nga paragrafi (6) alineja 3 të këtij neni.

## **Neni 73**

### **Veprimi me hedhurinën medicinale**

(1) Me hedhurinat mjekësore veprohet sipas dispozitave për hedhurina të rrezikshme nga ky ligj dhe dispozitave nga sfera e menaxhimit me hedhurina.

(2) Hedhurinat e rrezikshme nga objektet në të cilat zhvillohet mbrojtje shëndetësore e njerëzve i përfshijnë hedhurinat infektive, kimike, farmaceutike, si dhe barnat citostatike, sendet e mprehta dhe lloj tjetër të hedhurinave të rrezikshme.

(3) Programet për menaxhim me hedhurina në objektet për mbrojtje shëndetësore dhe veterinare, i miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mbrojtjes shëndetësore, përkatësisht ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë veterinare në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë veterinare e përcakton mënyrën e veprimit me hedhurina mjekësore, si dhe mënyrën e paketimit dhe shënimit të hedhurinave mjekësore.

## **Neni 74**

### **Veprimi me titaniumdioksidin**

(1) Ndalohet mënjanimi i hedhurinës nga titaniumdioksid i hedhurina e krijuar gjatë prodhimit të titaniumdioksidit, si dhe përpunimet e saja, nën sipërfaqet e ujit.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë, prodhojnë ose përpunojnë titaniumdioksid, janë të obliguar që organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor t'i paraqesin të dhëna për hedhurinë nga titaniumdioksidi, që është e dedikuar për mënjanim.

(3) Të dhënat nga paragrafi (2) të këtij nenii veçanërisht përmbajnë:

- 1) cilësitë fizike, kimike, biokimike dhe biologjike të hedhurinës;
- 2) gjendjen fizike;
- 3) stabilitetin fizik, kimik dhe biologjik të hedhurinës;
- 4) akumulacionin dhe biotransformimin te organizmat e gjalla ose sedimentet;
- 5) predispozitat e hedhurinës drejt transformimeve fizike, kimike dhe biokimike dhe sjelljen e tyre gjatë kontaktit me ndonjë medium të caktuar ose me substanca tjera organike dhe joorganike;
- 6) mënyrën e paketimit dhe metodat me të cilat do të mbrohet shkatërrimi i hedhurinës; dhe
- 7) masat e kujdesit për mbrojtjen e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(4) Krijuesi, poseduesi dhe përpunuesi i titaniumdioksidit dhe të hedhurinës së titaniumdioksidit, janë të obliguar të bëjnë monitorimin e tokës, ujërave dhe të ajrit në vendet ku përpunohet, depojohet dhe mënjanohet hedhurina nga titaniumdioksidi, si dhe në zonën pérreth, e cila konsiderohet si e pandotur.

(5) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët prodhojnë titaniumdioksid janë të obliguar që në raportet të cilat ia dorëzojnë organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor të inkuadrojnë edhe informata plotësuese për përbajtjen e sulfateve dhe klorideve në hedhurinë, për secilin tonelatë të prodhuar të titaniumdioksidit.

(6) Nëse në bazë të të dhënave të marra nga monitorimi konstatohet se cilësitë e rrezikshme dhe efektet nga mënjanimi i hedhurinës nga titaniumdioksidi mund t'i shkaktojnë pasoja të dëmshme dhe afatgjate mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin e Ekonomisë mund ta ndalojë prodhimin dhe përpunimin e titaniumdioksidit, si dhe mënjanimin e hedhurinës nga titaniumdioksidi.

(7) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët prodhojnë dhe përpunojnë titaniumdioksid, janë të obliguar të bëjnë analiza plotësuese për hedhurinë e titaniumdioksidit dhe të efekteve të tij ndaj ujërave, tokës, ajrit, si dhe kushteve për monitorim të deponive dhe të depove për hedhurina nga titaniumdioksidi.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, do ta përcaktojë mënyrën e veprimit me hedhurinën nga titaniumdioksidi, mënyra e kryerjes së monitorimit, si dhe formën, përbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të të dhënave.

## Neni 75

### **Rregullat për veprim me hedhurinën nga asbesti dhe me hedhurina nga prodhime të cilat përmbajnë asbest**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët veprojnë me hedhurinë nga asbesti dhe me hedhurinë nga prodhimet të cilët përmbajnë asbest, janë të obliguar të veprojnë me kujdes dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për mbrojtje me të cilat pengohet lirimi i grimcave, qimeve dhe pluhurit të asbestit në ajër, si dhe pengimi i derdhjes së lëngjeve që përmbajnë qime asbesti.

(2) Hedhurina që përmban dhe liron grimca, qime ose pluhur asbesti, mund të deponohet dhe të mënjanohet në vende të parapara kryesishët për

atë qëllim, si dhe të jetë i ndarë nga llojet tjera të hedhurinës, të selektuar dhe të paketuar në mënyrë adekuate.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, do të përcaktojë mënyrën e veprimit me hedhurinën nga asbesti dhe me hedhurinën nga prodhimet që përbajnjë asbest.

## Neni 75-a

### **Veprimi me hedhurina gome**

(1) Prodhuesi i gomave të cilat shiten veçmas ose janë pjesë përbërëse të automjeteve është i detyruar të sigurojë përpunimin e tyre dhe riciklimin e komponentëve përbërës.

(2) Personat juridikë dhe fizikë të cilët grumbullojnë, transportojnë, përpunojnë ose mënjanojnë hedhurina gome janë të detyruar të mbajnë dhe të ruajnë evidencë për hedhurina gome dhe për sasinë e gomave të përpunuara.

(3) Importi i gomave të përdorura është i ndaluar.

(4) Me përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, importi i gomave të përdorura lejohet nëse është ekonomikisht i arsyeshëm dhe nëse nuk e rrezikon shëndetin e njerëzve dhe ambientin jetësor.

(5) Importi i gomave të përdorura bëhet në bazë të lejes të cilën e lëshon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

(6) Mënyrën e veprimit me hedhurina gome, si dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë personat juridikë dhe fizikë të cilët importojnë goma të shfrytëzuara, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor.

## Neni 76

### **Rregulla për veprimin me hedhurina që krijohet gjatë veprimtarive shkencore-hulumtuese**

(1) Hedhurina që krijohet gjatë veprimtarive hulumtuese-shkencore duhet të jetë e përpunuar dhe pastruar nga substancat e dëmshme, nëse është e mundur, me qëllim që të mënjanohet ndikimi i dëmshëm ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(2) Me hedhurinën që krijohet gjatë veprimtarive hulumtuese-shkencore, veprohet në pajtim me dispozitat nga ky ligj dhe dispozitat tjera që kanë të bëjnë me hedhurinën e rrezikshme.

## Neni 77

### **Veprimi me lloje tjera të hedhurinave**

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor në pajtim me ministrin e Ekonomisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, do të përcaktojë lloje tjera të hedhurinës, si dhe veprimin me llojet tjera të hedhurinave, për të cilat si rezultat i zhvillimit të njohurive shkencore, do të përcaktohet se paraqesin kërcënëm për mjedisin jetësor dhe jetën dhe shëndetin e njerëzve.

## VI. Plehërishta

## **Neni 78**

### **Klasat e plehërishtave**

Sipas llojit të hedhurinës që mënjanohet, plehërishtat klasifikohen në:

- 1) plehërishta për hedhurina të rrezikshme
- 2) plehërishta për hedhurina të parrezikshme, dhe
- 3) plehërishta për hedhurina interne

## **Neni 79**

### **Kushtet që duhet t'i plotësojë plehërishta**

Për shkak të pengimit dhe zvogëlimit të ndikimeve të dëmshme të hedhurinës dhe të plehërishtave ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor për së afërmë i përcakton kushtet që duhet t'i përbushë plehërishta, e veçanërisht në raport me:

- 1) vendpozitës, përkatësisht lokacionit;
- 2) kontrollin e ujërave që hyjnë në plehërishtë;
- 3) kontrollin e lëngut rrjedhës;
- 4) mbrojtjen e tokës dhe ujtit nga ndotja;
- 5) kontrollin e gazit të plehërishtës;
- 6) zvogëlimin e rreziqeve që dalin nga plehërishta, përmes emetimit të pluhurit, ajrit të keq, zhurmës, komunikacionit, bartjes së materialeve, zjarreve, krijimit të aerokripave;
- 7) stabilitetit të hedhurinës në plehërishtë, dhe
- 8) sigurimit fizik të plehërishtës.

## **Neni 80**

### **Kushtet për themelimin e plehërishtës**

(1) Plehërishtë për hedhurinë të rrezikshme mund të themelojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën, nga neni 17 nga ky ligj.

(2) Plehërishtë për hedhurinë të parrezikshme dhe hedhurinë inerte, mund të themelojnë një ose më shumë komuna ose Qyteti i Shkupit ose person i vendit dhe/ose i huaj, nëse themelimi i plehërishtës është në pajtim me Planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën, nga neni 17 i këtij neni, me dorëzimin e kërkesës për themelimin e plehërishtës Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor është i obliguar t'i përgjigjet kërkesës në afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit.

(4) Kur plehërishta nga paragrafi (2) e këtij neni themelohet nga dy e më shumë komuna dhe/ose Qyteti i Shkupit, kërkesës i bashkëngjitet marrëveshja për themelimin e plehërishtës së përbashkët.

(5) Kur plehërishtën e hedhurinave të parrezikshme dhe inerte e themelon personi juridik i vendit dhe/ose i jashtëm, është i detyruar që në kërkesën për themelimin e plehërishtës ta përcaktojë edhe vëllimin (numrin e banorëve dhe rajonet) për të cilat plehërishta do të sigurojë pranimin e hedhurinave.

(6) Kërkesa për themelimin e plehërishtës nga paragrafi (2) të këtij neni përmban edhe të dhënrat për lokacionin e planifikuar për ndërtimin e plehërishtës, mjetet financiare të nevojshme për ndërtimin e plehërishtës, numrin e banorëve prej të cilëve do të grumbullohet hedhurina, si dhe të dhëna tjera, të cilat janë të domosdoshme që të përcaktohet nevoja e ndërtimit të plehërishtës.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor me dispozitë të veçantë përcakton formën dhe përbajtjen e kërkesës për themelimin e plehërishtës nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor si kusht për dhënien e lejes për themelimin e plehërishtës mund të kërkojë që themeluesi ta zgjeron përfshirjen e propozuar përkatësisht marrëveshjes nga paragrafi (4) i këtij neni t'i përfshijë edhe komuna të tjera si dhe t'i zgjerojë veprimtaritë për trajtim të mbeturinave, nëse në atë mënyrë kontribuohet në menaxhimin më të mirë dhe më ekonomik me hedhurinën, në pajtim me Planin për menaxhim me hedhurinën të Republikës së Maqedonisë.

(9) Kërkesa për themelimin e plehërishtës dorëzohet para dërgimit të kërkesës për ndërtimin e plehërishtës.

(10) Pa lejen nga paragrafi (3) të këtij neni nuk mund të fillojë procedura për ndërtimin e plehërishtës.

(11) Komunat dhe/ose Qyteti i Shkupit të cilët i kanë lidhur marrëveshjet nga paragrafi (4), mund të tërhiqen nga marrëveshja vetëm nëse të gjitha palët nga marrëveshja pajtohen në térheqjen dhe kushtet e térheqjes nga marrëveshja.

(12) Për shkak të mbrojtjes së ambientit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve, nëse komunat dhe qyteti i Shkupit nuk pajtohen, ose nuk formojnë deponi për mbeturina të parrezikshme, respektivisht inerte në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të themelojë deponi në pajtim me planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me mbeturina nga neni 17 i këtij ligji, ose t'ia besojë themelimin e deponisë për mbeturina të parrezikshme ose inerte personit juridik të vendit dhe/ose të huaj në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

## Neni 81

### **Planet operative dhe revizioni ekologjik për plehërishtet**

(1) Operatorët e plehërishteve ekzistuese, janë të obliguar të paraqesin kërkesë për marrjen e lejes për harmonizim me planet operative në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Nëse operatorët e plehërishteve posedojnë leje integrale ekologjike, ato janë të obliguar të sigurojnë revizion të përgjithshëm ekologjik, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 82

### **Personat të cilët mund të bëjnë veprimtari grumbullim të hedhurinës**

(1) Veprimtarinë grumbullimit të hedhurinës, mund ta bëjnë:

- 1) ndërmarrjet publike ose shërbimet tjera publike, në pajtim me ligjin;
- 2) persona juridikë të vendit dhe të huaj (në tekstin e mëtejmë: operatorët e plehërishtës) dhe
- 3) dy ose më shumë komuna, dhe/ose qyteti i Shkupit përmes themelimit të ndërmarrjes së përbashkët ose shërbimeve tjera publike në pajtim me ligjin

(2) Subjektet nga paragrafi (1) pika 2 i këtij neni, veprimtaria nga paragrafi (1) i këtij neni mund të bëhet edhe në bazë të marrëveshjes në procedurë në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

(3) Operatori i deponisë për hedhurina të rrezikshme është ndërmarrje publike e themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose person juridik, i cili si ofertues më i volitshëm është zgjedhur për koncesionar ose partner publik në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

## Neni 83

### Sigurimi i marrëveshjeve

(1) Kur operatori i plehërishtës nuk është në gjendje t'i mbulojë harxhimet për punë, mirëmbajtje, përcjellje dhe kontrollimin e plehërishtes në fazën operative dhe në fazën e mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes, harxhimet do të mbulohen me garancinë financiare të caktuar në marrëveshjen e lidhur në procedurë në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik.

(2) Afati për të cilin lidhet marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij nenit nё vete përfshin kohën e nevojshme për ndërtimin, punën dhe kujdesin për plehërishten pas mbylljes së saj.

(3) Nëse marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij nenit prishen para kohe nga ana e operatorit të plehërishtes, mjetet për sigurimin e marrëveshjes sigurohen nga garancia financiare.

## Neni 84

### Leja për operator të plehërishteve

(1) Operatori i plehërishtes duhet të posedojë leje për kryerjen e veprimtarisë grumbullim të hedhurinës të cilën e jep Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(2) Kërkesa për marrjen e lejës për kryerjen e veprimtarisë grumbullim të hedhurinës, operatori i plehërishtes ia dorëzon Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(3) Pas pranimit të kërkesës për marrjen e lejes, Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor është i obliguar të konstatojë se:

- 1) operatori a është i përgatitur teknikisht dhe materialisht për kryerjen e veprimtarisë;
- 2) kapacitetet organizative dhe udhëheqëse të operatorit a mundësojnë menaxhim të ndërgjegjshëm me plehërishten;
- 3) Ekipimi kadrovik dhe trajnimi i të punësuarve të cilët veprojnë me hedhurinat a mundësojnë punë të papenguar dhe të sigurt të plehërishtes;
- 4) përgatitja teknike dhe mjetet (kompaktorët, buldozerëve, mjetet për matjen e peshës së hedhurinës, mjetet për dezinfektim, mjetet për transport etj.) a janë të mjaftueshëm për veprimit;
- 5) kapaciteti i plehërishtës a është përkatës me periudhën kohore për të cilën kërkohet leja;
- 6) lloji dhe sasia e hedhurinës që duhet të mënjanohet në plehërishte a është përkatëse me klasën dhe kapacitetin e plehërishtës;
- 7) a është i përgatitur programi për punë, monitorim dhe për kontrollin e punës së plehërishtës dhe a është ai në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
- 8) personi i caktuar për udhëheqës me hedhurinën e plehërishtës a i plotëson kushtet e caktuara me këtë ligj;
- 9) a janë përgatitur programe për përsosjen e vazhdueshme profesionale dhe shkencore të personave të punësuar në plehërishte;
- 10) a janë miratuar dhe aprovar plane dhe programe për mënjanimin dhe përvogëlimin e pasojave nga avaritë;
- 11) shuma e garancive financiare a mundet t'i mbulojë harxhimet për realizimin e obligimeve të plehërishtës gjatë punës, mbylljes dhe përkujdesit të mëtejmë pas mbylljes së plehërishtës;

12) projekti i plehërishtës a është në pajtim me planet për menaxhim me hedhurinën, të miratuar në pajtim me këtë ligj, dhe

13) e shfuqizuar [11]

14) shuma e sigurimit përkatës mund t'i mbulojë harxhimet në rast të fatkeqësisë ose të dëmit të shkaktuar personave të tretë.

(4) Që të mund të kryhet veprimtaria e deponimit të hedhurinës, operatori i hekurishtes duhet të ketë të punësuar më së paku tre persona me përgatitje sipërore profesionale nga lëmi i shkencave natyrore dhe teknike, si dhe të disponojë me pajisje adekuate dhe mjete teknike.

(5) Operatori i plehërishtës është i detyruar që në pajtim me këtë ligj ose me dispozita tjera të refuzojë pranimin e hedhurinave të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me leje ose të refuzojë pranimin e hedhurinave që janë të përziera me hedhurina tjera dhe paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe për ambientin jetësor. Për refuzimin e hedhurinave operatori është i detyruar ta njoftojë organin i cili e ka lëshuar lejen.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor i përcakton kushtet lidhur me mjetet teknike dhe pajisjen për kryerjen e veprimtarisë mënjanim të hedhurinës, si dhe kushtet dhe mënyrën për aftësim dhe trajnim-programi për të punësuarit.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor i përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës për marrjen e lejes, si dhe formën dhe përmbajtjen e lejes për operator të plehërishtës.

(8) Personi juridik ose fizik, i cili e ka paraqitur kërkesën ka të drejtë t'i paraqesë ankesë Komisionit Shtetërorë për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, kundër vendimit me të cilën refuzohet dhënia e lejes, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

## Neni 85

### Ndërtimi i plehërishtës

Ndërtimi i plehërishtës bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 30 nga ky ligj.

## Neni 86

### Hedhurinat të cilat nuk janë të kapshme në plehërishte

Në plehërishte për hedhurina është e ndaluar deponimi i:

- 1) hedhurinës së lëngët;
- 2) hedhurinës që në kushtet e plehërishtës, është eksplodues, i ndryshkur, oksiduar, lehtë ndezës ose ndezës;
- 3) hedhurinës medicinale dhe hedhurinë tjetër klinike, që rrjedh nga institucionet medicinale ose veterinare, që është infektiv;
- 4) hedhurinë e krijuar si rezultat i hulumtimit shkencor, që është e re ose që nuk mund të identifikohet, ndërsa cilësitetë e saja mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- 5) goma tërësish të shfrytëzuara, përveç gomave të shfrytëzuara si material makinrik në inxhinieri, ose goma të copëzuara dhe të shfrytëzuara (me përjashtim të gomave të bicikletave dhe gomave me diametër të jashtëm mbi 1.400 mm);
- 6) hedhurinë që është e përzier me substanca tjera, me qëllim që t'i realizojë kriteret për pranimin e hedhurinës në plehërishte dhe
- 7) hedhurinë që përmban shkallë të lartë të përbërësve bioshkatërruese (p.sh. letër, hedhurinë kopshtesh, etj.).

## **Neni 87**

### **Mënjanimi i hedhurinës që nuk është i pranueshëm në plehërishte**

(1) Operacionet për mënjanimin e hedhurinës duhet të zbatohen në mënyrë përkatëse, në bazë të llojit dhe karakteristikave të hedhurinës që mënjanohet me qëllim që të sigurohet mbrojtja e mjedisit jetësor, jeta dhe shëndeti i njerëzve.

(2) Mënjanimi u hedhurinës që nuk pranohet në plehërishte do të bëhet me pranim adekuat në operacionet e përmendura në nenin 35, paragrafi 1 nga ky ligj.

(3) Mënjanimi i hedhurinës nga neni 86 i këtij neni, mund të bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit paraprak nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, e përcakton sasinë e përbërësve bioshkatërrues në hedhurinë që guxon të deponohet.

(5) Gjatë pranimit të hedhurinës në plehërishte, operatorët e plehërishteve janë të obliguar të vaprojnë në pajtim me Planin e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinën, në drejtim të zvogëlimit të sasisë së hedhurinës bioshkatërruese që pranohet në plehërishte.

## **Neni 88**

### **Pranimi i hedhurinës në klasa të ndryshme në plehërishte**

(1) Ndalohet të mënjanohet hedhurina në plehërishte të klasës joadekuate, si dhe mënjanimi i hedhurinës që nuk është i nënshtuar trajtimit.

(2) Ndalohet klasifikimi i përzierjes së hedhurinave me qëllim që të plotësohen kriteret që hedhurinat të pranohen në plehërishtë.

(3) Plehërishtet për hedhurinë inerte do të shfrytëzohen vetëm për deponimin e hedhurinës inerte.

(4) Me përjashtim, hedhurina inerte mund të mënjanohet në deponitë për hedhurina të parrezikshme, nëse trajtimi dhe përpunimi i saj është teknikisht i parealizueshëm ose ekonomikisht jo profitabil.

(5) Plehërishtja për hedhurina të parrezikshme mund të shfrytëzohet për:

- 1) hedhurina komunale;
- 2) hedhurinë të parrezikshme prej çfarëdo prejardhjeje, kush i plotëson kriteret për pranimin e hedhurinës në plehërishte për hedhurinë të parrezikshme;
- 3) hedhurinat stabile, joreaktive (p.sh. të ngurta, hedhurina të shndërruar në zgjyrë), me cilësi të kullimit e barabartë me atë të hedhurinës së parrezikshme të përmendor në pikën 2, të cilët i plotësojnë kriteret relevante për pranim, me kusht që të mos depojojen në qeli të dedikuara për hedhurinë bioshkatërruese të parrezikshme.

(6) Hedhurina që në Listën e llojeve të hedhurinës është theksuar si e rrezikshme, deponohet ekskluzivisht në plehërishte për hedhurinë të rrezikshme.

(7) Hedhurina e rrezikshme, e cili sipas trajtimit fizik dhe kimik nuk reagon me llojet tjera të hedhurinës, mund të depojohet në pjesë të veçanta të plehërishteve për hedhurinë të parrezikshme, pas sigurimit paraprak të pëlqimit nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në

mjedisin jetësor.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, do t'i përcaktojë kriteret për pranimin e hedhurinës në plehërishte prej secilës klasë, procedurat përgatitore për pranimin e hedhurinës, procedurat e përgjithshme për testim, marrjen e mostrave dhe pranimin e hedhurinës.

## Neni 89

### **Harxhimet e operatorëve të plehërishteve**

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, kujdeset që të gjitha harxhimet, të cilat janë përfshirë në formimin dhe në punën e një plehërishteje, duke i përfshirë edhe harxhimet e garancisë financiare ose ekuivalentin e saj edhe harxhimet e llogaritura për mbylljen dhe për kujdesin e mëtejmë për lokacionin pas mbylljes së plehërishtës, për një periudhë prej së paku 30 vjetësh, do të mbulohen me çmimin që operatori do ta arkëtojë për mënjanimin e secilit lloj të hedhurinës së plehërishtës, dhe me propozim nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, ndërmerr masa adekuate për sigurimin e të gjitha harxhimeve.

## Neni 90

### **Çmimi për mënjanimin e hedhurinës së plehërishteve**

(1) Çmimin për deponimin e hedhurinës e përcakton operatori i plehërishtës, në Librin tarifor për deponimin e hedhurinës.

(2) Libri tarifor për deponimin e hedhurinës formohet në bazë të llogarisë së harxhimeve të plota për investimin, ndërtimin, punën, mirëmbajtjen e plehërishtës, si dhe harxhimeve për kujdesin për plehërishtet pas mbylljes së tyre.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e lejon lartësinë e çmimit nga Libri tarifor për depojimin e hedhurinës së rrezikshme.

(4) Këshilli i komunave ose Qytetit të Shkupit e lejojnë lartësinë e çmimit nga Libri tarifor për deponimin e hedhurinave komunale dhe hedhurinave tjera të parrezikshme.

(5) Libri tarifor nga paragrafi (3) i këtij neni shpallet në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa libri tarifor nga paragrafi (4) i këtij neni shpallet në fletën zyrtare të komunave ose Qytetit të Shkupit.

## Neni 91

### **Obligimi për përcjelljen dhe për informimin e organeve kompetente**

(1) Operatori i plehërishtës është i obliguar ta realizojë Programin për menaxhim me hedhurinën, si dhe të bëjë monitorimin dhe kontrollin e ndikimit të plehërishtës ndaj mjedisit jetësor.

(2) Operatori është i obliguar që me shkrim ta informojë organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor për të gjitha ndikimet e rëndësishme negative ndaj mjedisit jetësor, të përcaktuara me zbatimin e procedurës për kontroll dhe përcjellje.

(3) Laboratoritë e akredituara bëjnë kontroll të procedurave analitike dhe të metodave që i zbaton operatori i plehërishtës gjatë kryerjes së analizave për cilësitë fiziko-kimike të hedhurinës.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përcakton mënyrën dhe

procedurën për punën, përcjelljen dhe kontrollin e plehërishtës gjatë kohës së punës, si dhe përcjelljen dhe kontrollin e plehërishtës në fazën e mbylljes dhe kujdesit të mëtejmë për plehërishten pas mbylljes.

## Neni 92

### **Pushimi nga puna e plehërishtes**

Plehërishtja ose pjesë nga e saj pushon të punojë kur:

- 1) me vendimin e Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, kur janë përbushur kushtet dhe/ose afatet për mbyllje të theksuara në lejen për punë të plehërishtes,
- 2) me vendimin e Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, në bazë të kërkesës së paraqitur për mbylljen e plehërishtes nga ana e themeluesit ose operatorit; dhe
- 3) me vendimin e Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, kur konstatohet se puna e mëtejme e plehërishtes ose pjesa e saj paraqet rrezik për mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

## Neni 93

### **Përkujdesi pasi që plehërishtja të pushojë të punojë**

(1) Për plehërishten ose për pjesën e saj mund të konsiderohet se ka përfunduar të punojë vetëm pasi që Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor ka bërë inspektimin përfundimtar në vetë vendin, i ka vlerësuar të gjitha raportet e dërguara nga ana e operatorit dhe i ka dorëzuar vendim për ndërprenjen me punë të plehërishtes. Pasi që plehërishtja të përfundojë të punojë, operatori do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e saj, për përcjelljen dhe për kontrollin në fazën e kujdesit të mëtejmë për plehërishten, në afatin që është përcaktuar në lejen për punë.

(2) Operatori i plehërishjtes është i obliguar t'i përcjellë dhe t'i analizojë sasinë dhe gjendjen e gazit që lirohet nga plehlërishtja dhe të lëngut nga plehërishtja, si dhe gjendjen e ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësor në afërsinë e plehërishtes.

(3) Operatori është i obliguar ta informojë organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor për të gjitha ndikimet e rëndësishme negative ndaj mjedisit jetësor, të zbuluar me procedurën për kontroll dhe për përcjellje.

(4) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor është i obliguar që, për shkak të përjashtimit të mundësisë që plehërishtja të paraqesë rrezik potencial për mjedisin jetësor, të bëjë vlerësimin e gjendjes vijuese të plehërishteve nga aspekti teknik, administrativ dhe shkallës së mbushjes së plehërishtes dhe t'i japë udhëzim operatorit për marrjen e masave korrigjuese, për çka e informon Organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga lëmi i mjedisit jetësor.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përcakton mënyrën dhe kushtet për kujdesin e plehërishteve pasi që ato do të pushojnë të punojnë.

## VII. NDEZJA OSE DJEGIA E HEDHURINËS

### Neni 94

### **Regullat për ndezjen dhe për djegien e hedhurinës**

(1) Mënjanimi i hedhurinës përmes ndezjes ose djegies bëhet në instalimet të veçanta të konstruktuara, varësisht nga lloji i hedhurinës.

(2) Instalimi për ndezje ose djegie, duke përfshirë edhe të gjitha objektet përgatitëse ndihmëse dhe servisit, aparateve dhe pajisjeve, të cilat janë në funksion të aparatit dhe pajisjes për ndezje dhe për djegie, duhet të konsrtuktohen dhe të punojnë ashtu që do të pengohet të vie në tejkalimin e kufijve të vlerës së substancave ndotëse, të cilat lirohen në ajër, tokë dhe ujëra, lirim i aromave dhe zhurmës, si dhe të sigurohet mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(3) Nëse instalimi për ndezje ose djegie nuk punon në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen, duke përfshirë edhe vlerat kufitare të emitimeve në ajër, ujë dhe në tokë, Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, mund ta marrë lejen për punë të stabilimentit dhe ta ndalojë kryerjen e veprimitarisë.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor i përcakton vlerat kufizuese për lëshimin e substancave të caktuara në ajër gjatë djegies dhe shpërbërjes së mbeturinave, vlerat kufizuese për emetimin e lëshimit të ujërave të zeza nga pastrimi i gazrave që lirohen, metoda dhe dinamika e matjes dhe ndjekjes së emetimit të substancave në ajër dhe ujë që krijohen gjatë djegies dhe shpërbërjes nga djegia të mbeturinave, si dhe mënyra dhe afatet kohore për arritjen e vlerave kufizuese për emetimin e substancave në ajër dhe ujë.

## Neni 95

### **Ndërtimi i instalimeve për ndezje dhe djegie**

Ndërtimi i instalimeve për ndezje ose djegie të hedhurinës bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 30 nga ky ligj.

## Neni 96

### **Zgjedhja e lokacionit për ndërtim**

Gjatë zgjedhjes së lokacionit për ndërtim të instalimit për ndezje ose djegie, veçanërisht do të mbahet llogari për:

- 1) karakteristikat klimatike të rajonit;
- 2) karakteristikat gjeologjike, hidrologjike, hidrogjeologjike, topografike, seismologjike dhe pedologjike të tokës;
- 3) "trëndafilit" të erërave përreth rajonit ku duhet të ndërtohet stabilimenti, dhe
- 4) afërsinë deri te vendbanimi.

## Neni 97

### **Planet operative dhe revizioni ekologjik për instalimet për ndezje ose djegie të hedhurinës**

(1) Operatorët e instalimeve ekzistuese për ndezje ose djegie të hedhurinës, janë të obliguar të paraqesin kërkesë për marrjen e lejes për harmonizimin me plane operative në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Nëse operatorët e instalimeve për ndezje ose djegie të hedhurinës posedojnë leje integruese ekologjike, ata janë të obliguar të sigurojnë revizion të përgjithshëm ekologjik, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 98

### **Lejet për punë të instalimeve për ndezje ose djegie të**

## **hedhurinës**

Peronat juridikë, të cilët menaxhojnë me instalimet për ndezje ose djegie të hedhurinës (në tekstin e mëtejmë: operatori i instalimeve) janë të obliguar të posedojnë leje integruese ekologjike për punën e stabilimentit, të dhënë në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

### **Neni 99**

#### **Leja për operator të instalimeve për ndezje dhe djegje**

(1) Për kryerjen e veprimitarisë ndezje ose djegie të hedhurinës, operatori i instalimit duhet të posedojë leje të cilën e jep Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, në pajtim me planin për menaxhim me hedhurinat në Republikën e Maqedonisë.

(2) Operatori i instalimit i paraqet kërkesë për marrjen e lejës Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(3) Pas pranimit të kërkesës për marrjen e lejes, Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor është i obliguar të konstatojë se:

- 1) operatori a është i përgatitur teknikisht dhe materialisht për kryerjen e veprimitarisë;
- 2) kapacitetet organizative dhe udhëheqëse të operatorit a mundësojnë menaxhim të ndërgjegjshëm me instalimin për ndezje dhe djegie;
- 3) ekipimi kadrovik dhe trajnimi i të punësuarve të cilët veprojnë me hedhurinat, a mundësojnë punë të papenguar dhe të sigurt të instalimit për ndezje dhe djegie;
- 4) përgatitja teknike dhe mjetet a janë të mjaftueshme për kryerjen e veprimitarisë;
- 5) periudha kohore për të cilën kërkohet leja, a përshtatet me kapacitetin e instalimit për ndezje dhe djegie;
- 6) lloji dhe sasia e hedhurinës që duhet të mënjanohet në instalimin për ndezjen dhe djegien, a përshtatet me klasën dhe me kapacitetin e instalimit për ndezje dhe djegie;
- 7) a është i përgatitur programi për punë, monitorim dhe për kontrollin e punës së instalimit për ndezje dhe djegie dhe a është ai në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
- 8) personi i caktuar të jetë menaxhues me hedhurinën e instalimit për ndezje dhe djegie, a i plotëson kushtet e caktuara me këtë ligj;
- 9) a janë miratuar programe për përsosjen e vazhdueshme profesionale dhe teknike të personave të punësuar në instalimin për ndezje dhe djegie;
- 10) a janë nxjerrë dhe aprovuar plane dhe programe për mënjanimin dhe për zvogëlimin e pasojave nga avaritë;
- 11) shuma e garancive financiare a mundet t'i mbulojë herxhimet gjatë kohës së punës;
- 12) projekti i instalimit për ndezje dhe djegie a është në pajtim me planet për menaxhim me hedhurinën, të miratuar në pajtim me këtë ligj dhe
- 13) a ekziston dëshmi se kërkuesit nuk i është shqiptuar masa e sigurisë, përkatësisht ndalim për kryerjen e veprimitarisë.

(4) Që të mund të kryhet veprimtaria e ndezjes ose djegies së hedhurinës, operatori i instalimit duhet të ketë të punësuar më së paku tre persona me përgatitje sipërrore profesionale nga lëmi i shkencave natyrore dhe teknike, si dhe të disponojë me pajisje adekuate dhe mjete teknike adekuate.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e ambientit jetësor i përcakton kushtet dhe mënyrën e punës së instalimeve për djegie ose shpërbërje nga djegia të mbeturinave, si dhe procedurat për pranim dhe dërgim të mbeturinave.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përcakton formën dhe përbajtjen e kërkesës për marrjen e lejes, si dhe formën dhe përbajtjen e lejes për operator të instalimit për ndezje ose djegie.

(7) Personi juridik, i cili e ka paraqitur kërkesën ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, kundër vendimit me të cilën refuzohet dhënia e lejes, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

## Neni 100

### Dërgimi dhe pranimi i hedhurinës për ndezje dhe djegje

(1) Para ndezjes ose djegies së hedhurinës, operatori i instalimitës i obliguar të bëjë krahasimin e hedhurinës që e pranon me të dhënat e theksuara në formularin identifikues, me marrjen e ekzemplarëve për shikim për shkak të përcaktimit të:

- 1) Ilojit dhe sasisë së hedhurinës që duhet t'i nënshtronhet djegies ose djegies e ngadalshme;
- 2) përbërjes kimike të hedhurinës;
- 3) karakteristikave të hedhurinës
- 4) përshtatshmërisë së hedhurinës për ndezje ose djegie;
- 5) hedhurinave me të cilat nuk guxon të përzihet, përkatësisht përcaktimin se hedhurina është e përzier me hehurinë tjetër, dhe
- 6) saktësisë së hedhurinave nga formulari identifikues, me marrjen e ekzemplarit nga hedhurina.

(2) Operatori i instalimitës i obliguar ta refuzojë ndezjen ose djegien e hedhurinës, nëse illoji i hedhurinës nuk përputhet me kushtet me lejen ekologjike integruese.

(3) Operatori i instalimitës i obliguar t'i ruajë ekzemplarët nga shikimi i kryer nga paragrafi (1) i këtij neni më së paku 1 muaj pas ndezjes ose djegies së hedhurinës.

## Neni 101

### Veprimi me mbeturinat nga ndezja dhe djegia

Pas ndezjes dhe djegies së hedhurinës, operatori i instalimitës i obliguar që:

1. ta minimizojë sasinë dhe dëmin e mbeturinave që dalin nga puna e instalimeve për djegie ose nga djegia e hedhurinave.
2. t'i përcaktojë karakteristikat e hedhurinës së fituar me ndezje dhe djegie, duke inkuadruar edhe fraksionet e metaleve të rënda;
3. ta grumbullojë hirin e fituar si rezultat i ndezjes dhe djegies në enë të myllur, dhe
4. të sigurojë transport të sigurt të hedhurinës, të fituar me ndezje dhe djegie, që nuk mund të përpunohet, deri në vendin e mënjanimit të saj.

(2) Atje ku është e përshtatshme dhe teknikisht e realizueshme mbeturinat nga djegia dhe djegia riciklohen drejtpërdrejt në instalim ose jashtë tij në pajtim me ligjin ose me dispozitë tjetër.

## VIII. IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANZITI I HEDHURINËS PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## Neni 102

### Lëvizja tejkufitare e hedhurinës

Lëvizja tejkufitare e hedhurinës përbëhet nga importi i hedhurinës që rrjedh nga shteti i huaj në territorin e Republikës së Maqedonisë, eksporti e hedhurinës nga territori i Republikës së Maqedonisë në shtetin tjetër të huaj dhe tranzitin e hedhurinës përmes territorit të Republikës së

Maqedonisë.

## Neni 103

### **Importi i hedhurinës në territorin e Republikës së Maqedonisë**

(1) Ndalohet importi i hedhurinës në territorin e Republikës së Maqedonisë, për deponim për shkak mënjanimit dhe për mënjanim.

(2) Ndalohet importi i hedhurinës së rrezikshme që është e përzier me hedhurinë të parrezikshme ose me komponente tjera, të cilat e zvogëlojnë dëmin dhe karakteristikat e rrezikshme të hedhurinës.

(3) Është i lejueshëm importi i hedhurinës që me siguri mund:

- 1) të përpunohet, pa rrezik për rrezikimin e mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- 2) të përdoret si lëndë e parë, ose
- 3) të shfrytëzohet si burim i energjisë.

## Neni 104

### **Eksporti i hedhurinës**

Lejohet eksporti i hedhurinës, e cila mund të përpunohet dhe mënjanohet pa rrezik ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njerëzve në vendin importues.

## Neni 105

### **Importi, eksporti dhe tranziti i hedhurinës së rrezikshme përmes territorit të Republikës së Maqedonisë**

Importi, eksporti dhe tranziti i hedhurinës së rrezikshme në Republikën e Maqedonisë bëhet sipas Konventës të Bazelit për kontroll të bartjes së hedhurinës së rrezikshme tej kufirit dhe vendosjes së saj.

## Neni 106

### **Lejet për eksport, import dhe tranzit të hedhurinës**

(1) Eksporti, importi dhe tranziti i hedhurinës bëhet në bazë të lejes të cilën e jep Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(2) Leja nga paragrafi (1) e këtij neni jepet pas dorëzimit paraprak Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, e cila veçanërisht duhet të përbajë:

- 1) emrin, mbiemrin dhe selinë e personit juridik dhe fizik që kërkon eksport, import ose tranzit të hedhurinës;
- 2) marrëveshjen midis palëve të interesuara (eksportuesin, importuesin ose personit i cili kërkon tranzit të hedhurinës);
- 3) marrëveshjen midis importuesit dhe përpunuesit, nëse ata janë persona të ndryshëm;
- 4) arsyetimin pse kërkohet eksporti, importi dhe tranziti i hedhurinës;
- 5) dëshminë se është dhënë leje nga organet shtetërore përmjet territorit të të cilit do të bëhet eksporti, importi dhe tranziti i hedhurinës;
- 6) të dhënat për pranuesin dhe përdërguesin e hedhurinës;
- 7) vlerësimin e karakteristikave të hedhurinës;
- 8) të dhënat për vëllimin e eksportit, importit ose tranzitit të hedhurinës;
- 9) të dhënat për personin, i cili bën transportin e hedhurinës;
- 10) dëshminë për posedimin e teknologjisë përkatëse për përpunim të sigurtë të hedhurinës (vetëm për importuesin);

- 11) dëshminë për sigurimin ose garancinë bankare në shumë të duhur për mbulimin e harxhimeve për përpunimin e hedhurinës, pa u shkaktuar dëmi ndaj mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit e njerëzve (vetëm për importuesin);
- 12) të dhënat për lokacionin ku bëhet përpunimi ose mënjanimi i hedhurinës;
- 13) përshkrimin dhe mënyrën e hedhurinës dhe mënyrën në të cilën veprohet me të;
- 14) llojin dhe sasinë e hedhurinës që krijohet me përpunimin;
- 15) llojin dhe sasinë e hedhurinës që eksportohet si rezultat i përpunimit;
- 16) të dhënat për numrin tarifor të hedhurinës, mënyrës së transportit dhe për paketimin;
- 17) informatën për hyrjen, daljen dhe skemën pagesore të transportimit të hedhurinës;
- 18) të dhënat për përpunimin dhe për mënjanimin e hedhurinës jashtë vendit.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, ka të drejtë të kërkojë të dhëna plotësuese, nëse vlerëson se të dhënat e shënuara në kërkesë nuk janë të mjaftueshme për dhëni e lejes.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përshkruan llojet e hedhurinës nga paragrafi (1) i këtij neni; kushtet për eksport, import dhe tranzit të hedhurinës, metodat e mbikëqyrjes ndaj eksportit, importit dhe tranzitit të hedhurinës, si dhe formën dhe përbajtjen e formularit të lejes për eksport, import dhe tranzit të hedhurinës.

(5) Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërksa për marrjen e lejes për eksport, import ose tranzit të hedhurinës, kërkuesi mund të paraqesë ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor në fund të muajit janar gjatë vitit në vijim përgatit report vjetor për llojin dhe sasinë e hedhurinës, e cila është importuar, eksportuar dhe tranzituar në/nga/nëpër Republikën e Maqedonisë.

(7) Raporti nga paragrafi (6) i këtij neni Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor e publikon në opinion.

## **Neni 106-a**

### **Njoftim për eksport të filluar të hedhurinave**

(1) Personi juridik ose fizik, i cili ka leje për eksport të hedhurinave detyrohet që së paku dy ditë pune, me shkrim, ose në formë elektronike ose me faks, të dorëzojë në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor formular transportues për transportim të hedhurinave, si dhe ta njoftojë për orën, ditën dhe vandin, përkatësisht lokacionin në të cilin do të fillojë të kryejë ngarkim të hedhurinave të dedikuar për eksport, numrin e lejes për eksportin e hedhurinave, si dhe të dhëna për vendkalimin kufitar në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe pikës doganore përmes së cilës do të kryhet eksporti.

(2) Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor ka të drejtë që të jetë i pranishëm në ngarkimin e hedhurinave në pajtim me njoftimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 107**

### **Dispozitat e përbashkëta për eksport, import dhe tranzit të hedhurinës**

Nëse leja për eksport, import dhe tranzit të hedhurinës shfrytëzohet në kundërshtim nga dedikimi për të cilin është dhënë, përkatësisht nëse zbulohen cenime të rëndësishme dhe keqpërdorime të së njëjtës, Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, mund ta prishë lejen në dëm të personit, të cilit i është dhënë, pa të drejtën e kompenzimit për dëmin e pësuar, humbjen materiale dhe jomateriale.

## IX MONITORIMI

### **Neni 108**

#### **Organizimi i monitorimit të menaxhimit me hedhurina**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor dhe komunave dhe Qytetit të Shkupit, në pajtim me kompetencat e tyre të përcaktuara me ligjin ose me dispozita tjera, janë të obliguar të sigurojnë monitorim të përhershëm të menaxhimit me hedhurinën, monitorimin e gjendjes së mjedisit jetësor dhe të ndikimit ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, përmes vendosjes të rrjetit shtetëror për monitorim të menaxhimit me hedhurinën, që është pjesë përbërëse e rrjetit shtetëror për monitorim të mjedisit jetësor.

(2) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor bën monitorimin e hedhurinës së rrezikshme në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa komunat dhe Qyteti i Shkupit zhvillojnë dhe zbatojnë monitorim në nivelin lokal, për menaxhim me hedhurinën e parrezikshme.

(3) Të dhënat nga monitorimi i kryer nga ana e njësive të vëtadministritimit lokal i dërgohen organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, në pajtim me ligjin dhe me dispozitat tjera.

(4) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor administron me punët e rrjetit shtetëror, duke e miratuar Programin për monitorim të menaxhimit me hedhurina.

(5) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor së paku njëherë në vit, ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor i dorëzon raport nga të dhënat e fituara nga monitorimi i menaxhimit me hedhurina.

(6) Dy ose më shumë komuna dhe/ose Qyteti i Shkupit mund të themelojnë administratë të përbashkët, e cila do të bëjë monitorimin e territorit të komunave dhe/ose Qytetit të Shkupit, ose t'ia besojnë personit juridik ose fizik ta bëjnë monitorimin në emër dhe në llogari të tyre, që rregullohet me marrëveshje të veçantë.

### **Neni 109**

#### **Vëllimi dhe përbajtja e monitorimit dhe menaxhimit me të dhënat**

(1) Monitorimi i menaxhimit me hedhurinat përbëhet prej:

- 1) përcjelljes së gjendjes me menaxhim me hedhurinat;
- 2) grumbullimit dhe dërgimit të të dhënavë për llojin, sasinë dhe për prejardhjen e hedhurinës së krijuar, përpunuar dhe mënjanuar;
- 3) marrjes dhe hulumtimit të mostrave;
- 4) të dhënavë për eksportin, importin dhe tranzitin e hedhurinës;
- 5) kontrollit, përpunimit dhe analizës së të dhënavë;
- 6) informimit dhe paralajmërimit të organeve kompetente për rrezikun e mundshëm
- 7) sigurimit ë informatave për ndikimin e hedhurinës së krijuar ndaj

mjedisit jetësor;

8) bashkëpunimit dhe këmbimit të të dhënave dhe informatave me rrjetin ndërkontëtar informativ.

## Neni 110

### Sigurimi i monitorimit

Rrjeti shtetëror për monitorim ka për qëllim të sigurojë të dhëna për menaxhimin me hedhurinë, për ndikimin e hedhurinës ndaj gjendjes së mjedisit jetësor, t'i zbulojë proceset dhe praktikat negative, ta parashohë zhvillimin, ta vlerësojë efikasitetin e masave për mbrojtje dhe për informimin e organeve kompetente për secilin ndryshim të gjendjes.

## Neni 111

### Monitorimin të cilin e bëjnë personat fizikë dhe juridikë

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë pronarë, përkatësisht shfrytëzues të instalimeve të caktuara që krijojnë, përpunojnë dhe mënjanojnë hedhurinë, janë të detyruar që monitorimin e menaxhimit me hedhurina ta bëjnë në pajtim me kushtet e përcaktura në lejen integrale ekologjike ose lejet për punë.

(2) Monitorimin e hedhurinave mund ta bëjnë subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe organizatat shkencore dhe profesionale dhe persona tjerë juridikë, nëse janë të akredituar për kryerjen e monitorimit, në pajtim me ligjin dhe dispozitave tjera.

(3) Të dhënat nga monitorimi nga paragrafi (1) i këtij neni, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar t'ia dorëzojnë organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga lëmi i mjedisit jetësor në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 112

### Kushtet për kryerjen e monitorimit

*I fshirë* 12

## X. SISTEMI INFORMATIV

## Neni 113

### Organizimi i sistemit informativ

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, organizon sistem informativ për menaxhim me hedhurinat e rrezikshme, si pjesë përbërëse e Sistemit të përgjithshëm informativ maqedonas për mjedisin jetësor (në tekstin e mëtejmë: qendra informative), përmes vendosjes së rrjetit për fitimin e të dhënave për menaxhim me hehurinat nga ministritë, organizatat, institucionet shkencore-hulumtuese, personat juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinat dhe subjektet tjera.

(2) Komunat dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguar ta organizojnë sistemin informativ në nivelin lokal, me çka sigurohet grumbullimi dhe prezantimi i të dhënave për gjendjen e përgjithshme lidhur me menaxhimin me hedhurinën e parrezikshme.

(3) Komunat dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguar të që dhënat e marra t'i përpunojnë dhe t'ia dorëzojnë organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

(4) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor është i obliguar që të dhënat e grumbulluara nga menaxhimi me hedhurinat, të përpunuara, t'ia dorëzojë Organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, e organizon funksionimin e sistemit informativ, në mënyrë me të cilën do të sigurohet grumbullimi i informatave shpejtë, saktë dhe me kohë lidhur me menaxhimin me hedhurina dhe është i obliguar t'i selektojë, klasifikojë, përpunojë, azhurnojë dhe t'i ruajë në bazën e të dhënave.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit jetësor, e organizon sistemin informativ, në atë mënyrë që do të sigurohet:

- 1) qasje, në çdo kohë, deri te informatat palëve lidhur me menaxhimin me hedhurinat dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë;
- 2) publikimi i të dhënave, raporteve, masave dhe aktiviteteve të Ministrisë për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në menaxhimin me hedhurinat;
- 3) transparenca e të dhënave nga lëmi i menaxhimit me hedhurinat.

## Neni 114

### Përbajtja e sistemit informativ

Sistemi informativ për menaxhim me hehurinat përmban:

- 1) të dhëna nga monitorimi i menaxhimit me hedhurinat nga ana e rrjeteve shtetërore dhe rrjeteve lokale;
- 2) të dhëna për monitorimin nga burimet e ndotjes së mjedisit jetësor, të shkaktuar nga menaxhimi me hedhurinat;
- 3) të dhëna nga monitorimi nga burime të veçanta;
- 4) të dhëna për llojin dhe përsasinë e hedhurinës;
- 5) të dhënat nga organizatat shkencore dhe profesionale dhe nga personat juridikë, të cilët e përcjellin gjendjen e menaxhimit me hedhurinat, të dhëna nga organizatat ndërkombëtare për monitorimin e menaxhimit me hedhurinën, dhe
- 6) të dhëna nga Kadastri i krijuesit e hedhurinave.
- 7) të dhënat për planet për administrim me hedhurina nga neni 18, parografi (5),
- 8) raportet për zbatimin e programeve nga neni 23, paragrafët (2) dhe (5),
- 9) të dhënat nga evidenca për administrim me hedhurina nga neni 39, paragrafët (6) dhe (8).
- 10) të dhënat për trupat e akredituar/të autorizuar për vlerësimin e hedhurinave nga neni 63.

(2) Në bazë të të dhënave nga parografi (1) i këtij neni organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor, përgatit raport për gjendjen e administrit me hedhurina si pjesë e raportit të gjendjes së ambientit jetësor në pajtim me Ligjin për ambientin jetësor.

## Neni 115

### Regjistri i hedhurinave

(1) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor është i obliguar të ruajë të dhëna në Regjistrin e hedhurinave për personat juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë, grumbullojnë, transportojnë, përpunojnë, deponojnë dhe mënjanojnë hedhurina, si dhe të dhëna për personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë import, eksport dhe tranzit të hedhurinës.

(2) Të dhënat do të përbajnë:

- 1) emrin dhe mbiemrin e personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinë;
- 2) adresën dhe selinë e personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinë;
- 3) llojin dhe sasinë e hedhurinës me të cilën menaxhojnë;
- 4) informatat për lejet e personave juridikë dhe fizikë.

(3) Përbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së evidencës në regjistrin e hedhurinave e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor.

## Neni 116

### Kadastri i krijuesve të hedhurinave

(1) Kadastri i krijuesve të hedhurinave është pjesë e Kadastrit për mjedisin jetësor që e vendos dhe e mban organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

(2) Në Kadastrin e krijuesve të hedhurinave regjistrohen krijuesit e hedhurinave të parrezikshme dhe të rrezikshme, llojeve dhe sasive të hedhurinës që e krijojnë, si dhe mënyrat për depojim, trajtim, përpunim dhe mënjanim të hedhurinave.

(3) Komunat dhe Qyteti i Shkupit mund të mbajnë Kadastër për rajonin e vet, në të cilin do të evidentohen krijuesit e hedhurinës së parrezikshme.

(4) Mënyrën dhe procedurën për regjistrimin e të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni në Kadastrin e krijuesve të hedhurinave, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(5) Të dhënat nga kadastro nga paragrafi (1) i këtij neni paraqesin pjesë përbërëse të Sistemit informativ për mjedisin jetësor.

## Neni 117

### Obligimi për shpalljen e të dhënave

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, përmes Sistemit informativ për mjedisin jetësor, përgatit dhe shpall raporte vjetore për emituesit e substancave ndotëse nga hedhurinat, raporte vjetore për menaxhimin me hedhurinën, si dhe lloje tjera të raporteve në pajtim me obligimet nga marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat i ka ratifikuar ose të cilave i është qasur Republika e Maqedonisë.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor është e obliguar t'i shpallë planet dhe programet për menaxhimin me hedhurinën, raportet inspektuese, raportet nga evidencat e personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinën, raportet e monitorimit dhe për menaxhimin me të dhënat, si dhe të dhënat tjera statistikore.

(3) Komunat dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguar t'i shpallin programet për menaxhimin me hedhurinat e parrezikshme, informatat për sasitë e krijuara të hedhurinave, informatave për sasinë e krijuar të hedhurinave, për masat, aktivitetet dhe mënyrat e përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në menaxhimin me hedhurinën.

(4) Ministri e përcakton mënyrën, formën dhe transferin e të dhënave dhe informatave nga përcjellja e gjendjes në menaxhimin me hedhurinën.

## Neni 118

## **Obligimi për informimin e opinionit**

Organ i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit janë të obliguar që gjatë viti të informojnë opinionin për gjendjen momentale në menaxhimin me hedhurinën, për përparimin e arritur, për planet dhe kahjet e ardhshme për përmirësimin e gjendjes në menaxhimin e gjendjes në menaxhimin me hedhurinën dhe të bëjë krasasimin dhe vlerësimin e gjendjes së tanishme dhe të kaluar në menaxhimin e hedhurinës.

### **Neni 119**

#### **Qasja në informatat për menaxhimin me hedhurinën**

Organ i administratës shtetërore kompetent për punët e mjedisit jetësor dhe organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor, janë të obliguar që subjektëve të interesuar t'u sigurojnë qasje në informatat në lidhje me menaxhimin me hedhurinën, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **XI. FINANCIMI**

### **Neni 120**

#### **Burimet e financimit**

(1) Realizimi i planeve dhe programeve të Republikës së Maqedonisë për menaxhim me hedhurinat, financohet me mjetet e siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, kreditet, donacionet, mjetet e personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinën, kompensimet dhe burimet tjera të mjeteve, të përcaktuara me ligjin.

(2) Realizimi i planeve dhe programeve të komunave dhe Qytetit të Shkupit për menaxhim me hedhurinën, financohet me mjetet e siguruara nga buxheti i komunave dhe Qytetit të Shkupit, kredive, donacioneve, kompensimeve, dënimive, nga kundërvajtjet e bëra të shqiptuara në rajonin e komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe burimeve tjera të mjeteve, të përcaktuara me ligjin.

(3) Mjetet për ndërtimin e lokaleve, objekteve dhe instalimeve për depojimin, përpunimin dhe për mënjanimin e hedhurinës së rrezikshme sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga personat juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinat, prej kredive, donacioneve dhe burimeve tjera të mjeteve, të përcaktuara me ligjin.

(4) Mjetet për ndërtimin e plehërishteve për mënjanimin e hedhurinës së parrezikshme dhe hedhurinës inerte, kompenzohen nga Buxhetet e komunave dhe Qyteti i Shkupit, nga personat juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinat, prej kredive, donacioneve dhe burimeve tjera të mjeteve, të përcaktuara me ligjin.

### **Neni 121**

#### **Çmimi për shërbimin e kryer**

(1) Lartësinë e çmimit për grumbullimin dhe për transportimin e hehurinave komunale, e lejojnë këshilli i komunave dhe Qyteti i Shkupit, me propozimin e prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, kur dhënësi i shërbimit është ndërmarrje publike e themeluar nga komunat dhe Qyteti i Shkupit në pajtim me nenin 46 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Lartësia e çmimit për grumbullimin dhe për transportimin e hehurinave komunale, përcaktohet me marrëveshje nga neni 46 paragrafi (4) kur dhënësi i shërbimit është person juridik dhe fizik.

(3) Çmimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenii do të përcaktohet në bazë të sasisë dhe llojit të hedhurinës që mund të përcaktohet sipas njësisë si: denarë për metër katror; denarë për metër kub dhe denarë për kilogram.

(4) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë hedhurinë komerciale, lartësinë e çmimit për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës e përcaktojnë me lidhjen e marrëveshjes së veçantë nga neni 43 paragrafi (8) i këtij neni, me dhënësin e shërbimit në bazë të sasisë dhe llojit të hedhurinës së krijuar të shprehur në denarë për kilogram ose denar për metër kub hedhurinë, në pajtim me çmimin e përcaktuar me paragrin (1) ose (2) nga ky nen.

(5) Personat juridikë dhe fizikë nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji, çmimin për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së parrezikshme dhe të rrezikshme, e përcaktojnë me marrëveshje të lidhur me personat juridikë dhe fizikë të autorizuar për grumbullimin dhe për transportimin e hedhurinës, në bazë të sasisë dhe llojit të hedhurinave të krijuara të shprehur në denarë për metër kub ose denarë për tonelatë hedhurina.

(6) Në përcaktimin e çmimit të shërbimit në pajtim me paragrin (1) dhe (2) të këtij neni, me propozim të prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, janë të obliguar të përcaktojnë çmime stimulative për amvisëritë, personat juridikë dhe fizikë, të cilët në bazë të sistemeve të vendosura për selektimin e hedhurinave e zvogëlojnë sasinë e përgjithshme të hedhurinave komunale të dedikuar për mënjanim në plehërishte.

(7) Çmimi për mënjanimin e hedhurinave përcaktohet në pajtim me ninen 90 nga ky ligj, në bazë të sasisë së hedhurinave të dorëzuara për mënjanim të shprehur me denarë për tonelatë të hedhurinave të krijuara.

(8) Gjatë përcaktimit të çmimit për shërbimet e kryera duhet të mbahet llogari që në të përmbahen harxhimet për shërbimin e kryer.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton metodologjinë për llogaritjen e çmimit për grumbullim, transportim dhe largim të hedhurinave.

## Neni 122

### Kompensim për trajtimin e mbeturinave

Prodhuesi dhe/ose importuesi të cilët lëshojnë në treg prodhime dhe paketime të cilat në fund të ciklit jetësor të prodhimeve që i prohijnë, përkatesisht importojnë krijojnë mbeturina të cilat e ngarkojnë ambientin jetësor, janë të detyruar të paguajnë kompensim për trajtimin e tyre në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjeter.

## Neni 123

### Kompensimi për menaxhim me hedhurinat e komunave dhe të Qytetit të Shkupit

(1) Këshilli i komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të përcaktojnë kompensim për menaxhim me hedhurina në lartësi prej 1% deri në 2% nga çmimi për shërbim të kryer për grumbullim dhe për transportim të hedhurinave komunale.

(2) Këshilli i komunave në Qytetin e Shkupit mund të përcaktojnë kompensim për menaxhim me hedhurina në lartësi prej 1% deri në 2% nga çmimi për shërbim të kryer për grumbullim dhe transportim të hedhurinave komunale, vetëm në rast kur dhënësi i shërbimit për grumbullim dhe transportim të hedhurinave komunale është i ndryshëm nga ai i Qytetit të Shkupit.

(3) Kompensimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, arkëtohet gjatë arkëtimit të çmimit për shërbimin e kryer nga neni 121 i këtij ligji dhe paraqitet ndaras në llogarinë për shërbim të kryer.

(4) Mjetet nga kompensimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni janë të hyra të Buxhetit të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe/ose Qytetit të Shkupit dhe paguhënë në llogari pagesore përkatëse në kuadër të llogarisë së thesarit, më së voni deri në ditën e 15 të muajit rrjedhës përmuanjin paraprak, e shfrytëzohen përm finansimin e realizimit të qëllimeve përm menaxhim me hedhurina të përcaktuara në planet dhe programet përmenaxhim me hedhurina të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, planet rajonale përm menaxhim me hedhurina, si dhe përm financim të Qendrave rajonale përm menaxhim me hedhurina në lartësi prej së paku 40%.

## Neni 124

### Mjetet nga pagesa e gjobave të shqiptuara

(1) Mjetet nga gjobat e paguara, të shqiptuara nga inspektorët e Qytetit të Shkupit dhe nga inspektorët komunalë të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe në Qytetin e Shkupit janë të hyra të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

(2) Mjetet nga gjobat e paguara, të shqiptuara nga punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent përm punët nga sfera e punëve të brendshme, janë të hyra të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

## Neni 125

### Garancitë financiare dhe sigurimet

(1) Personat juridikë dhe fizikë të cilët menaxhojnë me hedhurina detyrohen që të sigurojnë garanci financiare ose sigurim tjetër përkatës, që mjafton përm mbulimin e shpenzimeve në lidhje me menaxhimin me hedhurina, shpenzimeve përm mënjanimin e pasojave të dëmshme dhe rreziqet e arsyeshme të krijuara gjatë menaxhimit me hedhurina, si dhe gjatë magazinimit të hedhurinave.

(2) Personat juridikë dhe fizikë përm marrjen e lejes përm import, eksport dhe transitim të hedhurinave dhe lejes përm magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave, detyrohen të paraqesin garanci financiare ose sigurim tjetër përkatës.

(3) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët merren me import, eksport dhe transit të hedhurinave detyrohen që në pajtim me ligj, të lidhin marrëveshje përm sigurim të hedhurinave, si dhe përm përgjegjësinë përdëmin e bërë mbi person të tretë dhe përgjegjësinë përdëmin e bërë nga personi i tretë.

(4) Garancitë financiare ose sigurimi tjetër përkatës lëshohen në dobi të organit të administratës shtetërore kompetent përm kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe realizohen në bazë të aktvendimit me të cilin është përcaktuar se kanë ndodhur rastet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përm punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përm punët nga sfera e financave, i përcakton mënyrën e caktimit të lartësisë së shumës së garancisë financiare dhe lartësisë dhe llojin e sigurimit në bazë të llojeve dhe sasive të hedhurinës me të cilën menaxhon personi juridik apo fizik dhe llojin e veprimit me hedhurinën, lartësinë e shumës së garancisë financiare ose të sigurimit sipas llojeve veç e veç të hedhurinës dhe sasive me të cilat menaxhohet dhe llojin e veprimit, kohëzgjatjen, si dhe mënyrën e arkëtimit të tyre.

## XII. MIKËQYRJA DHE ORGANET KOMPETENTE

### Neni 126

#### **Organet kompetente**

(1) Mbikëqyrje për zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji e bën Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor.

(3) Për punët në kompetencë të komunave dhe Qytetit të Shkupit të përcaktuar me këtë ligj, mbikëqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji e bëjnë inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave dhe inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të Qytetit të Shkupit.

(4) Mbikëqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji në pjesën e krijimit, selektimit dhe paketimit të hedhurinës medicinale, e bën Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor, në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror për mjedisin jetësor.

(5) Mbikëqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji në pjesën e qarkullimit me prodhimet dhe paketimeve, shënimin e prodhimeve dhe paketimeve dhe informimin e konsumatorëve, bën Inspektorati shtetëror i tregut.

### Neni 127

#### **Fushëveprimi i Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor (në tekstin e mëtejmë: inspektori i mjedisit jetësor) ka të drejtë:

- 1) të përcaktojë nëse janë përpiluar programe për menaxhim me hedhurina për vitin rrjedhës dhe nëse i kanë dorëzuar në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (neni 21 paragrafi (3));
- 2) të përcaktojë nëse kanë dorëzuar raport vjetor për zbatimin e programeve të veta, në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (neni 23 paragrafi (5));
- 3) të kryejë inspektim dhe kontroll me hedhurina të rrezikshme dhe hedhurina të parrezikshme industriale nga instalime me A – leje të integruar ekologjike dhe me hedhurina të rrezikshme në instalime me B – leje të integruar, veprohet në pajtim me nenin 24 të këtij ligji;
- 4) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse grumbullimi dhe transportimi i hedhurinave të rrezikshme bëhet me mjete dhe pajisje e cila është veçanërisht e kriuar dhe dedikuar ekskluzivisht për grumbullim dhe transportim të hedhurinave të rrezikshme (neni 27);
- 5) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse përpunohet hedhurina në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;
- 6) të përcaktojë nëse posedohen leje për magazinim, trajtim dhe përpunim të hedhurinave në pajtim me nenin 32 të këtij ligji dhe nëse veprimtarinë e kryejnë në pajtim me lejen;
- 7) të përcaktojë nëse personat fizikë dhe juridikë kane siguruar sistem për ndjekje dhe nëse kanë vendosur videombikëqyrje në pajtim me nenin 32 paragrafi (10) i këtij ligji dhe nëse të dhënat nga videombikëqyrja ruhen në pajtim me nenin 32 paragrafi (11) të këtij ligji, (neni 32 paragrafët (10) dhe (11);
- 8) të përcaktojë nëse personat juridikë ose fizikë mbajnë evidencë dhe i ruajnë të dhënat nga evidenca në pajtim me nenin 32-a paragrafët (3)

dhe (4) të këtij ligji;

9) të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë veprojnë në pajtim me dispozitat nga nen 32-a i këtij ligji;

10) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse hedhurinat e rrezikshme magazinohen në vendet e parapara për atë dedikim në pajtim me nenin 33 të këtij ligji;

11) të kryejë inspektim dhe kontroll me hedhurinat e rrezikshme dhe hedhurinat e parrezikshme industriale nga instalime me A – leje të integruar ekologjike dhe me hedhurina të rrezikshme nga instalime me B – leje të integruar veprohet në pajtim me nenin 34 të këtij ligji;

12) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse hedhurinat mënjanohen në pajtim me operacionet e theksuara në nenin 35 të këtij ligji; 13) të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë nga nen 21 paragrafi (1) i këtij ligji kanë emëruar drejtor me hedhurina dhe nëse ai posedon vërtetim për provim të dhënë profesional në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;

14) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse evidenca mbahet në mënyrë të përcaktuar me nenin 39 të këtij ligji për hedhurina të rrezikshme dhe për hedhurina të krijuara nga instalimet me A - leje të integruar ekologjike;

15) të përcaktojë nëse veprohet në pajtim me nenin 39 të këtij ligji;

16) të kryejë inspektim dhe kontroll në të dhënat nga evidencat për hedhurina të rrezikshme dhe për hedhurina të parrezikshme industriale nga instalimet me A – leje të integruar ekologjike dhe për hedhurina të rrezikshme nga instalimet me B – leje të integruar ekologjike, si dhe të përcaktojë nëse të dhënat ruhen në pajtim me nenin 39 paragrafi (11) të këtij ligji;

17) të përcaktojë nëse të dhënat nga evidencat për deponine ruhen në pajtim me nenin 39 paragrafi (11) i këtij ligji;

18) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse në pronë që është në pronësi private ose te subjektet që posedojnë leje në pajtim me nenin 32 të këtij ligji, ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga nen 32-a paragrafi (8) të këtij ligji dhe/ose kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (nenet 32-a paragrafi (9) dhe 40 paragrafi (4));

19) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse instalime me A – leje të integruar ekologjike veprojnë me hedhurina të parrezikshme industriale në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;

20) të përcaktojë nëse posedohen leje për grumbullim dhe transportim të hedhurinave komunale në pajtim me nenin 45 paragrafi (1) të këtij ligji dhe nëse veprimtarinë e kryejnë në pajtim me lejen;

21) të përcaktojë nëse posedohen leje për themelimin e sistemit për grumbullim dhe për pranim kthyes të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimeve në pajtim me nenin 51 të këtij ligji dhe nëse veprimtarinë e kryejnë në pajtim me lejen;

22) të kryejë inspektim dhe kontroll në përbushjen e detyrimeve për dhëni e formularit të identifikimit për hedhurina të parrezikshme industriale në pajtim me nenet 55 dhe 56 të këtij ligji;

23) të kryejë inspektim dhe kontroll me hedhurina të rrezikshme të veprohet në pajtim me nenin 57 të këtij ligji;

24) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse hedhurinat e rrezikshme përzihen me lloje tjera të hedhurinave të rrezikshme dhe nëse përzihen hedhurina të rrezikshme me hedhurina të parrezikshme (neni 58);

25) të përcaktojë nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor është i njoftuar kur është kriuar përzierja e hedhurinave të rrezikshme me lloje tjera të hedhurinave, substanca dhe materiale (neni 59);

26) të kryejë inspektim dhe kontroll në mbajtjen e evidencës në pajtim me nenin 60 të këtij ligji;

27) të përcaktojë nëse përbushen detyrimet për dhëni e formularit të identifikimit për hedhurina të rrezikshme (neni 61);

28) të përcaktojë nëse trupi i akredituar ka dorëzuar ekzemplar nga certifikata te organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (neni 62 paragrafi (5));

29) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse trupi i akredituar lëshon certifikata për karakteristikat e hedhurinave për të cilat përgjigjet si

krijues ose posedues (neni 63 paragrafi (3));

30) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse hedhurinat e rrezikshme që janë të dedikuara për transportim, magazinim, përpunim dhe mënjanim janë të paketuara dhe shënuara në mënyrë përkatëse (neni 64);

31) të përcaktojë nëse është lidhur marrëveshje me persona juridikë të cilët posedojnë leje për grumbullim dhe transportim të hedhurinave të rrezikshme (neni 65);

32) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me vajrat e hedhura veprohet në pajtim me nenin 68 të këtij ligji;

33) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me BPK veprohet në pajtim me nenin 69 të këtij ligji;

34) *jashtë fuqisë* **[13]**

35) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me automjetet e shfrytëzuara veprohet në pajtim me nenin 72 të këtij ligji;

36) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me hedhurina nga titaniumdioksid veprohet në pajtim me nenin 74 të këtij ligji;

37) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me hedhurinat nga azbesti dhe me hedhurinat prej prodhimeve të cilat përbajnjë azbest veprohet në pajtim me nenin 75 të këtij ligji;

38) të përcaktojë nëse me gomat e përdorura dhe gomat e hedhura veprohet në pajtim me nenin 75-a të këtij ligji;

39) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse me hedhurinat nga veprimtaritë shkencore-hulumtuese veprohet në pajtim me nenin 68 të këtij ligji;

40) të përcaktojë nëse posedohet leje për kryerjen e veprimtarisë depozitim i hedhurinave (neni 84);

41) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse mënjanohen hedhurinat që nuk janë të pranueshme në deponitë (neni 86);

42) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse hedhurinat që nuk janë të pranueshme në deponitë mënjanohen në pajtim me operacionet nga nen 35 paragrafi (1) i këtij ligji;

43) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse mënjanimi i hedhurinave kryhet në klasa përkatëse të deponive (neni 88);

44) të përcaktojë nëse kryhen monitorim dhe kontroll mbi ndikimet e deponisë mbi mjedisin jetësor (neni 91);

45) të përcaktojë nëse për deponinë pas mbylljes së saj veprohet në pajtim me nenin neni 93 të këtij ligji;

46) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse mënjanimi i hedhurinave nëpërmjet djegies apo djegies së ngadalshme bëhet në instalime të krijuara të veçanta dhe nëse ato i plotësojnë kushtet e përcaktuara me lejen, duke i përfshirë edhe vlerat kufitare të emisionit në ajër, ujë dhe tokë (neni 94);

47) të përcaktojë nëse posedohet leje për kryerjen e veprimtarisë djegie ose djegie e ngadalshme e hedhurinave (neni 98);

48) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse para pranimit të hedhurinave për djegie ose djegie të ngadalshme veprohet në pajtim me nenin 100 të këtij ligji;

49) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse pas djegies ose djegies së ngadalshme të hedhurinave veprohet në pajtim me nenin 101 të këtij ligji;

50) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse gjatë importit të hedhurinave veprohet në pajtim me nenin 103 të këtij ligji;

51) të përcaktojë nëse posedohet leje për import, eksport dhe transit të hedhurinave dhe të përcaktojë nëse importi, eksporti dhe transiti i hedhurinave bëhet në pajtim me kushtet nga leja (nenet 106 dhe 107);

52) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse personi juridik dhe fizik që kryejnë eksport të hedhurinave, e kanë njofuar Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor në pajtim me dispozitat nga neni 106-a i këtij ligji;

53) të kryejë inspektim dhe kontroll nëse instalimet me leje A të integruar ekologjike kryejnë monitorim në pajtim me nenin 111 të këtij ligji;

54) të përcaktojë nëse janë plotësuar dhe përbushur kushtet nga lejet në pajtim me nenet 32, 45, 51 dhe 66 të këtij ligji dhe kushtet për akreditim nga neni 63 i këtij ligji dhe

55) përcakton edhe gjendje tjera në kompetencë të tij.

(2) Me kërkesë të inspektorit të mjedisit jetësor, personi i autorizuar i

organit kompetent për punët e brendshme detyrohet të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij nenit.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) pika 7 e këtij nenit, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor ka të drejtë të kryejë monitorim të vazhdueshëm 24 orësh mbi videombikëqyrjen e vendosur në pajtim me nenin 32 paragrafi (10) të këtij ligji.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) pika 18 të këtij nenit, krahas inspektorit shtetëror për mjedis jetësor të drejtë dhe detyrë për të kryer inspektim ka edhe punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme dhe nëse konstaton se në pronë që është në pronësi private ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga neni 32-a paragrafi (8) të këtij ligji dhe/ose kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, do t'u Marrë sendet dhe materialet që janë në përdorim të përgjithshëm dhe/ose prodhimet dhe materialet me të cilat kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me këtë ligji.

(5) Punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme ka të drejtë dhe obligim të ndalojë automjet i cili kryen transport të hedhurinave dhe të kryejë inspektim nëse automjeti është shënuar në mënyrë përkatëse në pajtim me nenin 45 të këtij ligji, si dhe nëse posedon formularë transportues për hedhurina nga neni 39 i këtij ligji.

## Neni 128

### **Marrja e vendimeve të Inspektoriatit shtetëror për mjedisin jetësor**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori për mjedisin jetësor me vendim:

- 1) do t'i obligojë të zgjedhin programe për menaxhim me hedhurinat në afat prej më së shumti 90 ditëve;
- 2) do t'i obligojë ta paraqesin raportin vjetor për realizimin e programeve në afat prej më së shumti 30 ditëve;
- 3) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse nuk veprohet me hedhurinën në pajtim me nenin 24 të këtij ligji në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 4) do ta kufizojë dhe ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse grumbullimi, transportimi, trajtimi, selektimi, depojimi, përpunimi i hedhurinave dhe tregtia me hedhurina të parrezikshme bëhet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditëve afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 5) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse bën grumbullimin, transportimin, trajtimin, selektimin, depojimin, përpunimin e hedhurinave dhe tregti me hedhurina të parrezikshme pa leje, në kohëzgjatje prej 90 ditëve afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 6) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse konstaton se lokacioni në të cilin do të kryhet veprimtaria magazinim, trajtim dhe/ose përpunim i hedhurinave nuk i plotëson kushtet në pajtim me nenin 32 paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni në kohëzgjatje prej 90 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 7) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik, nëse nuk kanë vendosur videombikëqyrje në pajtim me nenin 32 paragrafi (10) të këtij ligji dhe nëse të dhënat nga videombikëqyrja nuk ruhen në pajtim me nenin 32 paragrafi (11) të këtij ligji, në kohëzgjatje prej 90 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 8) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse konstaton se vepron në kundërshtim me rregullën e miratuar në bazë të nenit 32-a paragrafi (5) të këtij ligji në kohëzgjatje prej 90 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 9) do ta kufizojë dhe ndalojë punën e personit juridik nëse me hedhurinat

veprohet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji në kohëzgjatje më shumë se 30 ditë, afat gjatë të cilit duhet të mënjanohen shkaqet për gjendjen e krijuar;

10) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse bën mënjanimin e hedhurinave në kundërshtim me nenin 35 të këtij ligji në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet të mënjanohen shkaqet për gjendjen e krijuar;

11) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse nuk kanë angazhuar menaxhues për hedhurina, në afat prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

12) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse të dhënat nga evidentimi për hedhurinat mbahen, ruhen dhe veprohet me to në mënyrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditëve afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

13) do ta kufizojë dhe ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse nuk kanë vepruar në pajtim me nenin 39 të këtij ligji në kohëzgjatje prej 30 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar.

14) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse hedhurina e rrezikshme përzihet me lloje tjera hedhurinave të rrezikshme dhe me lloje tjera të hedhurinave të parrezikshme pa posedimin e lejes, dhe nëse për këtë nuk është informuar organi kompetent në kohëzgjatje prej 30 ditëve afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

15) do t'ua marrë prodhimet dhe materialet që janë në përdorim të përgjithshëm, nëse gjatë inspektimit dhe kontrollit konstatohet se në pronë që është në pronësi private ose te subjekte që posedojnë leje në pajtim me nenin 32 të këtij ligji, ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga neni 32-a paragrafi (8) të këtij ligji dhe/ose prodhimet dhe materialet me të cilat kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (nenet 32 parrafët (8) dhe (9) dhe 40 paragli (4));

16) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse japid sertifikata për karakteristikat e hedhurinave në kundërshtim me dispozitat e ligjit, në kohëzgjatje prej 30 ditëve;

17) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse nuk kanë lidhur marrëveshje me persona të autorizuar juridikë, të cilët posedojnë leje për veprim me hedhurina, në afat prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë arsyet për gjendjen e krijuar;

18) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse bën depojimin e hedhurinave pa leje, në kohëzgjatje prej 90 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

19) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse bën mënjanimin e hedhurinave të papranueshme për plehërishtën, në kohëzgjatje prej 90 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

20) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse nuk bëjnë monitorim në pajtim me dispozitat nga ky ligj, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

21) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse bëjnë import, eksport ose tranzit të hedhurinave për çka nuk posedojnë leje në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

22) do t'i sekuestrojë hedhurinat me të cilën është bërë import, eksport ose tranzit për çka nuk është siguruar leja deri në realizimin e kushteve për kryerjen e importit, eksportit ose tranzitit, dhe

23) do ta ndalojë ose kufizojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse kryejnë veprimitari të veprimit me hedhurinat pa u siguruar leja adekuate;

24) do ta kufizojë dhe ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse kanë kryer eksport të hedhurinave dhe nuk e kanë njoftuar Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor në pajtim me dispozitat e nenit 106-a të këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditësh

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori për mjedisin

jetësor konstaton se personat juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurina nuk u përbahen ligjeve dhe dispozitave tjera, dispozitave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë dhe padrejtësitë e konstatuara dhe në vendim do të caktojë afatin gjatë të cilit duhet të mënjanohen.

(3) Nëse subjektet nga paragafi (1) të këtij nenit nuk veprojnë në pajtim me vendimin e inspektorit për mjedisin jetësor dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e kriuar të përcaktuar me vendimin, inspektori i mjedisit jetësor do t'i paraqesë fletëparaqitje kundërvajtëse ose penale gjykatës kompetente.

(4) Në rast kur do të konstatohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejtë ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, inspektori do të japë urdhër me gojë për mënjanimin urgjent dhe pa shtyrje të mangësive të caktuara, të cilat me procesverbal i konstaton në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror sanitario-shëndetësor, si dhe do t'i informojë edhe inspektorët tjere kompetentë ose organet tjera shtetërore për parregullsitë e konstatuara dhe do të kërkojë intervenimin e tyre;

(5) Nëse parregullsitë dhe padrejtësitë e konstatuara nga paragafi 4 të këtij nenit, paraqesin rrezik për rrezikimin e mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori menjëherë do ta ndalojë punën e instalimit, objektit, stabilimentit, aparatit, si dhe përdorimin e mjeteve dhe pajisjes për kryerjen e veprimtarisë.

(6) Në rastet e paragrafit 4 të këtij nenit, inspektori merr vendim me shkrim në afat prej 48 orëve nga dhënia e urdhrit me gojë;

(7) Shpenzimet për transport, ruajtje dhe magazinim të prodhimeve të konfiskuara dhe materialeve që janë në përdorim të përgjithshëm, si dhe të prodhimeve dhe materialeve me të cilat bëhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, janë më ngarkim të personit juridik dhe fizik nga i cili janë konfiskuar.

(8) Për kryerjen e punëve nga paragafi (1) të këtij nenit inspektori për mjedisin jetësor ka të drejtë të marrë edhe masa të tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 129

### Fushëveprimi i inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor të komunave dhe inspektori i autorizuar për Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejmë: inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor) ka të drejtë:

- 1) të konstatojë se a janë përpunuar programet për menaxhim me hedhurina për vitin në vijim dhe a ia kanë paraqitur prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit (neni 21 paragafi 2);
- 2) të konstatojë se a i është paraqitur raporti vjetor për realizimin e programeve të veta prefektit të komunave dhe Qytetit të Shkupit (neni 23 paragafi 4);
- 3) të bëjë shikim dhe kontroll se me hedhurinat e parrezikshme nga instalimet me B leje ekologjike integruese a veprohet në pajtim me nenin 24 të këtij ligji;
- 4) të bëjë inspektimin dhe kontrollin nëse hedhurinat janë hedhur, lënë, ndezur, lëshuar ose mënjanuar në mënyrë të kundërt me këtë ligj dhe me dispozitat e nxjerra në bazë të këtij ligji (neni 24-a);
- 5) të bëjë shikim dhe kontroll se personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë transportimin dhe grumbullimin e hedhurinës së parrezikshme a i bëjnë me mjete dhe pajisje, e cila është konstituar veçmas dhe dedikuar për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së parrezikshme (neni 27);
- 6) të bëjë shikim dhe kontroll se hedhurina e parrezikshme a depojohet në

- vendet e parapara për atë dedikim në pajtim me nenin 33 nga ky ligj;
- 7) të bëjë shikim dhe kontroll se me hedhurinat e parrezikshme (përveç nga instalimet me A leje ekologjike integruese) dhe me hedhurinën industriale të parrezikshme prej instalimeve me B leje ekologjike integruese a veprohet në pajtim me nenin 34 nga ky ligj;
- 8) të konstatojë se a mbahet evidencë në mënyrë të përcaktuar me nenin 39 nga ky ligj për hedhurinat e parrezikshme (përveç nga instalimet me A leje integruese) dhe për hedhurinat industriale e parrezikshme të krijuar nga instalimet me B leje ekologjike integruese;
- 9) të përcaktojë nëse veprohet në pajtim me nenin 39 paragrafi (9) të këtij ligji;
- 10) të bëjë shikim dhe kontroll se të dhënat nga evidencat për hedhurinat komunale të parrezikshme dhe për hedhurinat e parrezikshme industriale nga instalimet me B leje ekologjike integruese a ruhen në pajtim me nenin 39 paragrafi (11) nga ky ligj;
- 11) të konstatojë se në pajtim me nenin 40 nga ky ligj a ekzistojnë hedhurina në pronësi private që mund të shkaktojnë pasoja nga neni 24 i këtij ligji;
- 12) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse në pronë që është në pronësi private ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga neni 32- a paragrafi (8) të këtij ligji dhe/ose kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 40 paragrafi (4));
- 12) të bëjë shikim dhe kontroll se me hedhurinat komunale dhe hedhurinat e parrezikshme a veprohet në pajtim me nenin 43 nga ky ligj;
- 14)** të bëjë inspektimin, kontrollin dhe të vërtetojë nëse hedhurinat komunale dhe lloji tjeter i hedhurinave të parrezikshme janë dorëzuar në pajtim me nenin 42-a).
- 15) të konstatojë se krijuesit e hedhurinave komerciale a kanë lidhur marrëveshje për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave me dhënësin e shërbimit në pajtim me nenin 43 paragrafi (8);
- 16) të bëjë shikim dhe kontroll ndaj personave juridikë dhe fizikë se hedhurinat komunale a i vendosin në vendet e caktuara për grumbullim dhe selektimin në pajtim me nenin 44 paragrafi (1) dhe (2) nga ky ligj;
- 17) të konstatojë se dhënësit e shërbimeve në pajtim me nenin 44 paragrafi (1) a kanë vendosur enë për grumbullimin dhe selektimin e hedhurinës komunale nga neni 44 paragrafi (3) nga ky ligj;
- 18) të bëjë shikim dhe kontroll se dhënësit e shërbimit së paku një herë në vit a i plotësojnë kushtet nga leja për grumbullim dhe transport të hedhurinave komunale në pajtim me nenin 45 paragrafi (1) nga ky ligj;
- 19) të bëjë shikim dhe kontroll se me hedhurinën interne a veprohet në pajtim me këtë ligj dhe se vetë a e kanë grumbulluar dhe transportuar hedhurinën interne deri te vendet e caktuara nga komunat dhe Qyteti i Shkupit (neni 54);
- 20) të konstatojë se personat juridikë dhe fizikë, të cilët posedojnë leje B ekologjike integruese a bëjnë monitorimin në pajtim me nenin 111 të këtij ligji; dhe
- 21) konstaton edhe gjendje tjera nga kompetencat e tij.

(2) Në rast kur është përcaktuar ekzistimi i hedhurinave në pronë private në pajtim me paragrafin (1) pika 10 të këtij neni, inspektorë i autorizuar për mjedisin jetësor është i obliguar që menjëherë ta informojë prefektin e komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

(3) Në rast kur është caktuar mosplotësimi i kushteve gjatë kontrollit nga paragafi (1) pika 15 i këtij neni, inspektorë i autorizuar për mjedisin jetësor është i obliguar që menjëherë ta informojë Organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor për shkak zbatimit të procedurës përmarrjen e lejes.

(4) Me kërkesë të inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor, personi i autorizuar i organit kompetent për punë të brendshme është i obliguar të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragafi (1) i këtij neni.

## **Marrja e vendimeve të inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor me vendim:

- 1) do t'i obligojë të përgatisin programe për menaxhim me hedhurinat në afat prej më së shumti 90 ditëve;
- 2) do t'i obligojë ta paraqesin raportin vjetor për realizimin e programeve në afat prej më së shumti 30 ditëve;
- 3) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse nuk veprohet me hedhurinën e parrezikshme dhe hedhurinën industriale të parrezikshme nga instalimet me B leje ekologjike integruese në pajtim me këtë ligj në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 4) do ta kufizojë dhe ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse grumbullimi dhe transportimi i hedhurinave të parrezikshme bëhet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 5) do ta ndalojë punën e personit juridik dhe fizik nëse bën depojimin e hedhurinave të parrezikshme në vende të cilat nuk janë paraparë për atë dedikim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 6) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse të dhënat nga evidentimi për hedhurinat e parrezikshme mbahen, ruhen dhe veprohet me to në mënyrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 7) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse nuk kanë paraqitur raporte të konsoliduara në pajtim me nenin 39 të këtij ligji në kohëzgjtaje prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 8) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë, nëse për hedhurinat komunale, hedhurinat komerciale dhe llojet tjera të hedhurinave të parrezikshme, nuk veprohet në pajtim me nenin 39 paragrafi (9) të këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditësh afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar
- 9) do t'ua marrë sendet që janë në përdorim të përgjithshëm, nëse gjatë inspektimit dhe kontrollit konstatohet se në pronë që është në pronësi private ruhen prodhime dhe materiale që janë në përdorim të përgjithshëm nga nen 32-a paragrafi (8) të këtij ligji dhe/ose kryhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 40 paragrafi (4));
- 10) do ta kufizojë ose ndalojë punën e prsonave juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë ose posedojnë hedhurina komerciale nëse nuk kanë lidhur marrëveshje me dhënësin e shërbimit për grumbullim dhe transportim të hedhurinave komunale, në afat prej 30 ditëve afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 11) do ta kufizojë ose ndalojë punën e dhënësit të shërbimit nëse dhënësi i shërbimit nuk i vendos enët për grumbullim dhe selektim të hedhurinave komunale, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 12) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë, të cilët posedojnë B leje ekologjike integruese nëse nuk bëjnë monitorim në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në kohëzgjatje prej 30 ditëve, afat gjatë të cilit duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor konstaton se personat juridikë dhe fizikë, të cilët administrojnë me hedhurinat nuk u përbahen ligjeve dhe dispozitave tjera, dispozitave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë e caktuara dhe padrejtësitë dhe në vendim do të caktojë afatin gjatë të cilit duhet të mënjanohen.

(3) Nëse subjektët nga paragrafi (1) të këtij neni nuk veprojnë në pajtim me vendimin e inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuar me vendimin, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor do t'i paraqesë fletëparaqitje kundërvajtëse ose penale gjykatës kompetente, si dhe do të fillojë procedurë për marrjen e lejeve dhe autorizimeve të fituara.

(4) Në rast kur do të konstatohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejtë ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, inspektori do të japë urdhër me gojë për mënjanimin urgjent dhe pa shtyrje të mangësive të caktuara të cilat me procesverbal i konstaton në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror sanitaro-shëndetësor, si dhe do ta informojë edhe Inspektoratin shtetëror për mjedisin jetësor si dhe inspektorët tjera kompetentë ose organet tjera shtetërore për parregullsitë e konstatuara dhe do të kërkojë intervenimin e tyre;

(5) Nëse parregullsitë dhe padrejtësitë e konstatuara nga paragrafi 4 i këtij neni, paraqesin rrezik për rrezikimin e mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori menjëherë do ta ndalojë punën e instalimit, objektit, stabilimentit, aparatit, si dhe përdorimin e mjeteve dhe pajisjes për kryerjen e veprimtarisë.

(6) Në rastet e paragrafit (4) të këtij neni, inspektori merr vendim me shkrim në afat prej 48 orëve nga dhënia e urdhrit me gojë;

(7) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij neni, inspektori për mjedisin jetësor ka të drejtë të marrë edhe masa të tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

(8) Shpenzimet për transport, ruajtje dhe magazinim të prodhimeve të konfiskuara dhe materialeve që janë në përdorim të përgjithshëm, si dhe të prodhimeve dhe materialeve me të cilat bëhet tregti me hedhurina në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, janë më ngarkim të personit juridik dhe fizik nga i cili janë konfiskuar.

## Neni 131

### Fushëveprimi i inspektoratit shtetëror të tregut

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektorati shtetëror i tregut ka të drejtë:

1) të përcaktojë nëse personat juridikë ose fizikë gjatë kryerjes së tregtisë me hedhurina të parrezikshme mbajnë evidencë në pajtim me nenin 32-a paragrafi (3) të këtij ligji;

2) të konstatojë se a lëshohen në qarkullim prodhime dhe paketime, të cilat nuk përbajnë shenja me të dhënat për ripërdorim të prodhimit dhe të paketimit, të dhëna për ripërtëritjen e prodhimit dhe paketimit, si dhe për mënyrën e veprimit në rast të fundit të ciklit jetësor të prodhimit dhe paketimit në pajtim me nenin 49 të këtij ligji;

3) të bëjë shikim dhe kontroll se gjatë shitjes së prodhimeve dhe paketimeve a inkasohet dhe kthehet kaucioni, a jepet llogari ose vërtetim për kaucionin e inkasuar, si dhe a ripranohen prodhimet dhe paketimet e shfrytëzuara në pajtim me nenin 50 nga ky ligj;

4) të konstatojë se shitësi a ka lidhur marrëveshje për pranim dhe/ose për grumbullim të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimeve të prodhuesit, importuesit ose personit fizik dhe juridik, i cili posedon leje në pajtim me nenin 51 nga ky ligj;

5) të konstatojë se prodhuesit në mënyrë adekuate a i informojnë prodhuesit për të dhënat për ripërdorim të prodhimit, si dhe a i ripranojnë prodhimet dhe paketimet në pajtim me nenin 52 nga ky ligj.

(2) Inspektorati shtetëror i tregut kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese nga paragrafi (1) të këtij neni e bën në pajtim me ligjin për inspeksion të tregut dhe me këtë ligj.

## Neni 132

## **Fushëveprimi i inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor ka të drejtë:

1) të bëjë shikim dhe mbikëqyrje se personat juridikë dhe fizikë a e grumbullojnë, selektojnë dhe paketojnë hedhurinën medicinale në pajtim me këtë ligj.

(2) Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese nga paragrafi (1) të këtij neni a e bën në pajtim me Ligjin për inspeksionin sanitar dhe shëndetësor dhe me këtë ligj.

### **Neni 132-a**

#### **Fushëveprimi i inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit**

*I fshirë* **[16]**

### **Neni 132-b**

#### **Zbatimi i dispozitave nga ligjet tjera të mbikëqyrjes inspektuese**

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për mjedisin jetësor, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

### **Neni 132-v**

#### **Përgjegjësia e personave zyrtarë**

(1) Personat zyrtarë në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor, duke i përfshirë edhe organet në përbërje, si dhe personat zyrtarë në organet e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit janë të detyruar, që si persona përgjegjës, me kohë dhe me efikasitet t'i ndërmarrin të gjitha masat dhe procedurat e domosdoshme për zbatimin e këtij ligji.

(2) Nëse gjatë zbatimit të masave dhe procedurave të vërtetuara me këtë ligj, vërtetohen kundërvajtje nga ana e personit juridik ose fizik të bëra me veprim dhe/ose moskryerje dhe/ose lëshim të mbikëqyrjes së detyruar mbi personin tjetër i cili ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik, si dhe paraqitjen e të dhënave dhe dokumenteve të rrejshme dhe të pasakta, personat zyrtarë janë të detyruar të ngrejnë iniciativë ose kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Personat juridikë dhe fizikë për të cilët janë paraparë të drejta dhe detyrime të vërtetuara me këtë ligj, nëse vërtetojnë ekzistimin e shkeljes ose të kapërcimit të autorizimeve nga ana e personave zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij ligji, të kryera me veprime dhe/ose moskryerje, janë të detyruar që për këtë ta njoftojnë ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësor, gjegjësisht kryetarin e komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave të Qytetit të Shkupit.

(4) Në rast të vërtetimit të shkeljeve të kompetencave të personave zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ambientit jetësorë, gjegjësisht kryetari i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave të Qytetit të Shkupit është i detyruar të ngrejë procedurë për

vërtetimin e përgjegjësisë së personit zyrtar në pajtim me këtë ose me tjetër ligj.

## Neni 133

### Kompetencat tjera

(1) Inspektori për mjedis jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor është i obliguar t'u paraqesë fletëparaqitje penale dhe kundërvajtëse gjyqeve kompetente për ngritjen e procedurës penale dhe kundërvajtëse, nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstatojnë bazë për të njëjtat.

(2) Inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedis jetësor është i obliguar ta informojë organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor kur pas mbikëqyrjes inspektuese do të konstatojë se personi juridik dhe fizik, i cili menaxhon me hedhurinat, me krijimin dhe moskrijimin ka bërë cënime të rëndësishme të kushteve dhe obligimeve nga leja ose akreditimi.

(3) Nëse inspektori nuk paraqet fletëparaqitje penale, përkatësisht fletëparaqitje për ngritjen e procedurës në pajtim me paragrafin 1 nga ky nen, do të konstatohet se ka bërë cënim më të rëndë të vendit të punës.

## Neni 133-a

### Procedura për edukim

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i mjedisit jetësor konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 139 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2, 140 paragrafi (1) pikat 8, 9 dhe 11, 141 paragrafi (1) pikat 1, 5 dhe 7, 142 paragrafi (1) pikat 1 dhe 5 dhe paragrafi (2) pikat 1, 5 dhe 7 të këtij ligji për herë të parë, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për edukim të personit, përkatësisht kryerësit të kundërvajtjes ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 139 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2, 140 paragrafi (1) pikat 8, 9 dhe 11, 141 paragrafi (1) pikat 1, 5 dhe 7, 142 paragrafi (1) pikat 1 dhe 5 dhe paragrafi (2) pikat 1, 5 dhe 7 të këtij ligji për herë të parë, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit, përkatësisht kryerësit të kundërvajtjes ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Formën dhe përbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Edukimin e organizon dhe realizon inspektori i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(5) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta apo të ngjashme për një ose më tepër subjekte.

(6) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi, nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(7) Nëse personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e konstatuar.

(8) Nëse inspektori i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, miraton konkluzion me të cilin e ndërpert procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(9) Nëse inspektori i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, parashton kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para Komisionit për kundërvajtje.

(10) Inspektori i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese mban evidencë unike për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 133-b**

### **Raporte**

Inspektori i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, është i obliguar që të mbajë evidencë për mbikëqyrjet dhe kontrollet e kryera te personat juridikë dhe fizikë, për të cilët përpilon raport tremujor dhe atë e publikon në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përkatësisht në ueb faqen e komunës, e komunave të qytetit të Shkupit dhe të qytetit të Shkupit.

## **Neni 134**

### **Procedura për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese**

(1) Mbikëqyrja inspektuese ndaj personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurina kryhet si mbikëqyrje inspektuese e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese, si dhe kryhet dhe me fletëparaqitjen e marrë dhe/ose të kuptuarit nga ana e organeve tjera shtetërore, organizatave, institucioneve, personave juridikë dhe fizikë, si dhe nga mjetet e informimit publik.

(2) Drejtori i Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor, përkatësisht prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit, janë të obliguar që çdo vit të miratojnë program për punën e inspektorëve të autorizuar të mjedisit jetësor nga parografi 1 i këtij nenit.

(3) Në kryerjen e inspektimit të rregullt, inspektori i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor në suazat e kompetencave të veta, të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligjet tjera, është i pavarur dhe autonom në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe në marrjen e masave administrative dhe masave tjera të përcaktuara me ligj.

(4) Inspektori i mjedisit jetësor është i autorizuar të bëjë mbikëqyrje inspektimi në çdo kohë dhe aty për aty, pa paralajmërim paraprak në lokalet afariste, instalime, objekte, si dhe në mjetet dhe pajisjet për kryerjen e veprimtarisë së grumbullimit, transportimit, deponimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinave të personave juridikë dhe fizikë, për të cilët është dhënë A leja ekologjike integruese dhe personave juridikë dhe fizikë, për të cilët është dhënë B leja ekologjike integruese, të cilët krijojnë hedhurina të rrezikshme.

(5) Inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor të komunave dhe Qytetit të

Shkupit, është i autorizuar të bëjë mbikëqyrje inspektuese në çdo kohë dhe aty për aty, pa paralajmërim paraprak në lokalet afariste, instalime, objekte, si dhe në mjete dhe pajisje për kryerjen e veprimtarisë së grumbullimit, transportimit, depojimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinave të personave juridikë dhe fizikë, të cilët krijojnë hedhurina të parrezikshme, si dhe personave juridikë dhe fizikë për të cilët është dhënë B leja ekologjike integruese dhe menaxhojnë me hedhurinë të parrezikshme, duke mos i përfshirë instalimet me A leje ekologjike integruese.

(6) Nëse inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton se ka padrejtësi në menaxhimin me hedhurinat e rrezikshme në instalimet, të cilat kanë B leje ekologjike integruese, ose te ndonjë person tjetër juridik dhe fizik, është i obliguar që pa shtyrje ta informojë inspektorin për mjedisin jetësor.

(7) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(8) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(9) Anesa nga paragrafët (7) dhe (8) nga ky nen nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, nëse me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të paraqitet rrezik për rrezikimin e mjedisit jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

(10) Komisioni nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni, është i obliguar që vendimin për ankesën ta miratojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

### **Neni 134-a**

#### **Veprimi për kallëzim nga personi fizik ose juridik**

(1) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, janë të obliguar që në afat prej shtatë ditësh të veprojnë për iniciativën apo kallëzimin për ngritjen e procedurës inspektuese.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, janë të obliguar që ta njoftojnë parashtruesin e iniciativës ose kallëzimit për ngritjen e procedurës inspektuese në afat prej shtatë ditësh nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

### **Neni 134-b**

#### **Të drejtat dhe obligimet për mënjanimin e parregullsive**

(1) Inspektori i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor në pajtim me këtë ligj, për mënjanimin e parregullsive të konstataura, kanë të drejtë dhe obligim që subjektit të mbikëqyrjes:

- 1) t'i sugerojnë për parregullsitë e konstataura dhe të përcaktojnë afat përmes mënjanimin e tyre;
- 2) t'i urdhërojnë që të ndërmarrë masa përkatëse dhe aktivitete në afatin që do ta përcaktojnë;
- 3) përkohësisht t'ia ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë, profesionit apo detyrës;
- 4) t'i parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje dhe
- 5) t'i paraqesë kallëzim penal ose të ngritë procedure tjetër përkatëse.

(2) Për mënjanimin e parregullsive të konstatuara, inspektori i mjedisit jetësor dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor mund të kryejnë edhe autorizime dhe përgjegjësi tjera në pajtim me ligjin.

## Neni 135

### Obligimet e inspektorëve për mjedisin jetësor dhe të inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor është i autorizuar t'i:

- kontrollojë mjetet teknike dhe pajisjen për kryerjen e veprimtarisë së grumbullit, transportimit, depojimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinës se a është në pajtim me kushtet e përcaktuara dhe lejet;
- kontollojë instalimet për plehërishtë, trajtim, përpunim dhe mënjanim të hedhurinave;
- kontollojë librat afaristë, marrëveshjet, programet për menaxhim me hedhurinat dhe dokumentet tjera, të cilat mundësojnë shikim në punën e personave juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinat;
- marrë deklaratë nga personat përgjegjës në personin juridik, personat fizikë dhe nga dëshmitarët;
- të marrë mostra nga hedhurina që është krijuar, grumbulluar, transportuar, depojuar, trajtuar, përpunuar dhe mënjanuar;
- të marrë mostra nga toka, uji dhe ajri;
- i kontrollon dërgesat e hedhurinave të dedikuara për eksport nëse janë në pajtim me lejen për eksport të hedhurinave dhe
- shfrytëzojë shërbimet nga organizata profesionale dhe persona.

(2) Kur mbikëqyrja inspektuese është bërë me kërkësen e personit juridik dhe pesonit fizik, harxhimet e shkaktuara gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese bien në barrë të personit juridik dhe fizik.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i mjedisit jetësor, do t'i përcaktojë lartësinë e harxhimeve nga paragrafi (2) të këtij nenit dhe mënyrën e arkëtit të tyre.

(4) Inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar është i obliguar ta informojë Organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor për ngritjen e procedurës përmarrjen e lejes për kryerjen e veprimtarisë, kur pas mbikëqyrjes inspektuese do të konstatojë se personi juridik dhe fizik, i cili menaxhon me hedhurinat, me krijimin dhe moskrijimin personi juridik dhe fizik, i cili menaxhon me hedhurinat me mënjanimin ose mosmënjanimin ka bërë cënime të rëndësishme të kushteve dhe obligimeve nga leja.

(5) Inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor është i obliguar t'i ruajë si sekret zyrtar të dhënat te të cilët do të vijë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ose që do t'ia paraqesin personat juridikë dhe fizikë në pajtim me ligjin.

## Neni 136

### Obligimet për personat juridikë dhe fizikë

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët menaxhojnë me hedhurinat, janë të obliguar që inspektorit për mjedisin jetësor dhe inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor t'i munësojnë të kryejë punë të papenguar të mbikëqyrjes dhe me kërkësë të tij t'ia paraqesin dokumentacionin e plotë, t'i jasin informata dhe sqarime plotësuese dhe të dhëna tjera me të cilat disponojnë, e që janë në interes të realizimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor është i obliguar të

bëjë procesverbal për konstatimin e gjendjes dhe ekzemplarë nga procesvebali t'i dërgojë personit përgjegjës në personin juridik që ka qenë lëndë e mbikëqyrjes dhe organit të administratës shtetërore kompetent për çeshtjet nga lëmi i mjedisit jetësor.

## Neni 137

### **Mbikëqyrja në legjislaturën e punës së organeve komunale**

(1) Mbikëqyrja në legjislaturën e punës së organeve komunale përkatesisht Qytetit të Shkupit, themelohet në parimin e legjislaturës, përgjegjësisë dhe pavarësisë në realizimin e kompetencave të tyre.

(2) Mbikëqyrjen nga paragafi (1) të këtij neni e bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në punën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, i bën punët si vijon:

1) e përcjell punën e organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe paraqet iniciativë për realizimin e kompetencave të komunës dhe Qytetit të Shkupit që ka të bëjë në përgatitjen, miratimin dhe realizimin e planeve, programeve dhe akteve tjera (neni 22 dhe 24);

2) vlerëson se organet e komunave dhe Qytetit të Shkupit përgatitjen dhe realizimin e planeve dhe programeve, si dhe paraqitjen e raporteve për realizimin e tyre a e bëjnë në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë ligj (neni 18, 19 dhe 23);

3) vlerëson se prefekti i komunave dhe Qytetit të Shkupit a kanë miratuar akte për mirëmbajtjen e higjienës publike dhe a veprojnë me hedhurinën e lëshuar në sipërfaqet publike dhe komunikacionit në mjediset urbane dhe në sipërfaqen të paurbanizuar në rajonin e vet dhe e përcjell mënyrën e realizimit të tyre (neni 22 dhe 41)

4) vlerëson se komunat dhe Qyteti i Shkupit a kanë miratuar rregulla për veprim me hedhurinën komunale dhe me llojet tjera të hedhurinave të parrezikshme dhe e përcjell realizimin e tyre (neni 22, 43 dhe 46);

5) vlerëson se prefektët e komunave dhe Qytetit të Shkupit a i kanë caktuar vendet për grumbullimin dhe selektimin e hedhurinës komunale dhe e përcjell mënyrën e realizimit të tyre (neni 44);

6) e vlerëson realizimin e parimit të universalitetit të shërbimeve (neni 47);

7) vlerëson se prefektët e komunave dhe Qytetit të Shkupit a i kanë caktuar vendet për grumbullim, trajtim dhe mënjanim të hedhurinave inerte dhe e përcjell mënyrën e realizimit të tyre (neni 54);

8) e përcjell mënyrën e themelimit dhe veprimit të plehërishtës për hedhurina të parrezikshme dhe inerte dhe e vlerëson realizimin e marrëveshjes pér themelim të plehërishtës (neni 80);

9) e përcjell se komunat dhe Qyteti i Shkupit a kanë vendosur rrjet monitorimi dhe a bëjnë monitorim në menaxhimin me hedhurinat e parrezikshme dhe të dhënat nga monitorimi i bërë a ia paraqesin organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale (neni 108);

10) vlerëson se komunat dhe Qyteti i Shkupit a kanë vendosur sistem informativ për menaxhim me hedhurinat e parrezikshme dhe të dhënat nga sistemi informativ a i kanë përpunuar dhe a ia kanë paraqitur organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale (neni 113);

11) vlerëson se komunat dhe Qyteti i Shkupit a kanë vendosur Kadastër të krijuesve të hedhurinave dhe e përcjell mënyrën e mbajtjes së tij (neni 116);

12) vlerëson se komunat dhe Qyteti i Shkupit a i kanë shpallur planet dhe programet për menaxhim me hedhurinat e rrezikshme, informatat përsasitë e hedhurinave të krijuara, për masat, aktivitetet dhe mënyrat e përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në menaxhimin me hedhurinën (neni 117);

13) e vlerëson mënyrën me të cilën komunat dhe Qyteti i Shkupit i kanë

- caktuar çmimet për shërbimet e kryera dhe kompenzimit për menaxhim me hedhurinat (neni 121);
- 14) i paralajmëron organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe propozojnë masa adekuate për tejkalimin e kësaj gjendjeje;
  - 15) i paralajmëron për mangësitë e caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, me të cilat do të mund ta pengonin realizimin e të drejtës së opinionit në qasjen te informatat dhe pjesëmarrjen në marrjen e vendimeve dhe të drejtave dhe obligimeve tjera të caktuara me këtë ose me ligj tjetër;
  - 16) u jep rekondime për realizimin e përpiktë të kompetencave komunës dhe Qytetit të Shkupit për punët të cilat duhet t'i bëjnë në pajtim me këtë ligj, me kërkosë të organeve të komunave dhe Qytetit të Shkupit;
  - 17) e përcjellin miratimin në kohë të dokumenteve planore dhe akteve tjera nga ana e komunave dhe Qytetit të Shkupit;
  - 18) paraqet iniciativa dhe propozime që organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit nëse konstatojnë mosrealizimin e këtij ligji si rezultat të ndeshjes së kompetencave midis tyre;
  - 19) e përcjell legjislacionin e vendimeve që i merr prefekti gjatë punëve administrative, si obligimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë në pajtim me këtë ligj;
  - 20) jep mendime dhe ndihmë profesionale me kërkosën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit me propozim sipas dokumenteve planore dhe akteve tjera që dalin nga ky ligj;
  - 21) e përcjell realizimin e mbikëqyrjes paraprake në aktet për çka në pajtim me këtë ligj, është kompetent ta miratojë;
  - 22) e përcjell realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit në realizimin e kompetencave të caktuara me këtë ligj në aspektin e informimit të qytetarëve të rregullt, në kohë, drejt dhe të plotë;
  - 23) i informon në kohë organet e komunës dhe të Qytetit të Shkupit për gjendjet e konstataura në punën e tyre dhe për masat e marra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes;
  - 24) i informon në kohë organet e komunës dhe të Qytetit të Shkupit për gjendjet e konstataura në punën e tyre;

## Neni 138

### Marrja e kryerjes së kompetencave

- (1) Nëse edhe pas vërejtjes dhe masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit nuk e sigurojnë realizimin e punëve për të cilat ato janë kompetent në pajtim me këtë ligj, u merret kryerja e punëve;
- (2) Kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij nenii i merr organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i mjedisit jetësor më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre, në emër dhe në llogari të komunës dhe Qytetit të Shkupit.
- (3) Për marrjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij nenii informohet organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i vetadministrimit lokal dhe organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i financave.
- (4) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor kryerjen e punëve nga paragrafi 1 të këtij nenii, i bën në emër dhe në llogari të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

## XII-a VEPRA PENALE GJATË TREGTISË ME HEDHURINA

### Neni 138-a

## **Kryerja e tregtisë së palejuar me hedhurina të parrezikshme**

Jashtë fuqisë **[17]**

### **Neni 138-b**

## **Kryerja e grumbullimit të prodhimeve dhe materialeve që janë në përdorim të përgjithshëm**

Jashtë fuqisë **[18]**

### **Neni 138-v**

I fshirë **[19]**

## **XIII. SANKSIONE PËR KUNDËRVAJTJE**

### **Neni 139**

#### **Sanksione të përgjithshme për kundërvajtje për personat juridikë dhe fizikë**

Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron me hedhurina, nëse:

- 1) nuk përpilon program për menaxhim me hedhurina për vitin rrjedhës dhe nuk i dorëzon te organet kompetente (neni 21);
- 2) nuk dorëzon raport vjetor për zbatimin e programeve të veta për menaxhim me hedhurina (neni 23 paragrafi (5));
- 3) nuk vepron me kujdes të domosdoshëm dhe i shkakton pasojet e theksuara në nenin 24 të këtij ligji;
- 4) lë, hedh, lëshon, djeg ose në mënyrë të pakontrolluar mënjanon hedhurina (neni 24-a);
- 5) nuk mban evidencë për hedhurinat e pranuara ose të dërguara (neni 32-a paragrafi (3));
- 6) e kryen veprimtarinë në kundërshtim me mënyrën e përcaktuar me rregullën e miratuar në bazë të nenit 32-a paragrafi (5) të këtij ligji;
- 7) nuk cakton drejtor me hedhurina (neni 38);
- 8) nuk mban dhe nuk i ruan dhe nuk i dorëzon të dhënat për evidencë të hedhurinave (nenet 39 dhe 60);
- 9) nuk i mënjanon ose refuzon t'i mënjanojë hedhurinat në mënyrë të paraparë me këtë ligj (neni 40);
- 10) vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenii 42-a i këtij ligji;
- 11) nuk i grumbullojnë, seleksionojnë dhe dorëzojnë hedhurinat komunale (nenet 43 dhe 44);
- 12) nuk kanë lidhur marrëveshje për dhënësin e shërbimit ose me person të autorizuar juridik dhe fizik për grumbullim dhe transportim të hedhurinave (nenet 43 dhe 65);
- 13) hedhurinat komunale që i krijon nuk e lë në vendet për grumbullim të hedhurinave komunale, të përcaktuara nga komunat dhe nga Qyteti i Shkupit (neni 44);
- 14) nuk i informon konsumatorët për ripërdorim dhe përtëritje të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimit (neni 49);
- 15) nuk e shënon prodhimin ose paketimin në mënyrë në të cilën sigurohen të dhëna për ripërdorim dhe përtëritje të prodhimeve të shfrytëzuara dhe paketimit (nenet 49 dhe 52);
- 16) nuk arkëton kaucion për prodhimet e shitura dhe paketimet për të cilat është përcaktuar arkëtim dhe nëse refuzon t'ia kompensojë kaucionin e arkëtuar konsumatorit (neni 50);
- 17) nuk i merr prapa prodhimet e shfrytëzuara dhe paketimet (neni 50);
- 18) nuk e kthen prodhimin e shfrytëzuar dhe paketimin (nenet 53 dhe 71);

- 19) nuk i grumbullon dhe nuk i transporton hedhurinat e krijuara inerte (bërllokun ndërtimor) deri te vendet e përcaktuara për atë ose nuk ua dorëzon personave juridikë dhe fizikë të cilët grumbullojnë dhe transportojnë hedhurina (neni 54);
- 20) nuk mbajnë evidencë përkatëse për hedhurinat e parrezikshme industriale (neni 56);
- 21) kryen import të hedhurinave për magazinim dhe mënjanim (neni 103 parografi (1));
- 22) kryen eksport, import ose transit të hedhurinave pa leje (neni 103 parografi (2));
- 23) hedhurinat shfrytëzohen në kundërshtim me dedikimin për të cilin është dhënë leja (neni 104) dhe
- 24) gjatë eksportit të hedhurinave nuk e ka njoftuar Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor në pajtim me dispozitat e nenit 106-a të këtij ligji.

(2) Gjobë në shume prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik i cili vepron me hedhurina për veprimet nga parografi (1) pikat 3, 4, 9,10, 11, 12, 13, 16, 19, 21, 22,23 dhe 24 të këtij nenii.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron me hedhurina, nëse:

- 1) nuk i seleksionon dhe nuk i klasifikon hedhurinat e rrezikshme, sipas llojit dhe karakteristikave të përcaktuara në Listën e llojeve të hedhurinave dhe vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenii 26 i këtij ligji;
- 2) kryen magazinim, trajtim dhe përpunim të hedhurinave pa leje, si dhe nuk i plotëson kushtet nga nenii 32 parografi (2) alinetë 2 dhe 3 të këtij ligji (neni 32 parografi (2));
- 3) nuk ka vendosur videombikëqyrje në pajtim me nenin 32 parografi (10) dhe të dhënat nga videombikëqyrja nuk ruhen në pajtim me nenin 32 parografi (11) i këtij ligji (neni 32 paragrafët (10) dhe (11));
- 4) nuk i magazinon hedhurinat e rrezikshme në vendet, në objektet ose në instalimet e parapara për atë dedikim (neni 33);
- 5) nuk siguron pëlgim dhe magazinim të rregullt të hedhurinave të rrezikshme, në vendet e përcaktuara në afërsi të vendit ku është krijuar (neni 33);
- 6) para mënjanimit, nuk i vendos hedhurinat e rrezikshme në trajtim (neni 34 parografi (2));
- 7) i ruan hedhurinat e rrezikshme në stacione shkarkimi më gjatë nga e përcaktuara (neni 37 parografi (2));
- 8) nuk vepron në pajtim me nenet 39 dhe 60 të këtij ligji;
- 9) nuk vepron veç e veç me hedhurinat e rrezikshme (neni 57);
- 10) i derdh dhe/ose hedh hedhurinat e rrezikshme në ujëra, tokë, në enë që nuk janë të parapara për grumbullimin e llojeve të caktuara të hedhurinave, në sistemet e kanalizimit dhe sistemet tjera infrastrukturore dhe objektet (neni 57);
- 11) i përzien hedhurinat e rrezikshme me lloje tjera të hedhurinave rrezikshme dhe përzierje të hedhurinave të rrezikshme me hedhurina të parrezikshme (neni 58);
- 12) nuk e njofton organin kompetent kur hedhurinat e rrezikshme janë përzier me lloje tjera të hedhurinave dhe fillon procedurë për veçimin e tyre pa pëlgim (neni 59);
- 13) krijuesi dhe/ose poseduesi i hedhurinave të rrezikshme nuk dorëzon/dorëzojnë formular identifikimi me të dhëna për llojin, vendin e krijimit, sasinë dhe mënyrën e paketimit të hedhurinave të rrezikshme (neni 61);
- 14) krijuesi, përkatësisht poseduesi i hedhurinave të rrezikshme nuk dorëzon të dhëna të sakta në formularin e identifikimit (neni 61);
- 15) krijuesi dhe/ose poseduesi i hedhurinave të rrezikshme me formularin e identifikimit nuk dorëzon raport për karakteristikat e hedhurinave (neni 61);
- 16) nuk dorëzon ekzemplar nga formulari i identifikimit për hedhurinat e rrezikshme në organin kompetent (neni 61);

- 17) nuk ka kërkuar vlerësim të karakteristikave të rrezikshme të hedhurinave të krijuara, edhe pse ka ekzistuar dyshim i arsyeshëm për këtë (neni 62);
- 18) nuk e shënon paketimin e hedhurinave të rrezikshme me mbishkrimin "Hedhurina të rrezikshme", si dhe llojin, karakteristikat fizike dhe kimike të hedhurinave (neni 64);
- 19) nuk i paketon hedhurinat e rrezikshme në enë të veçanta të krijuara varësisht nga lloji, karakteristikat fizike dhe kimike të hedhurinave (neni 64);
- 20) nuk lidh marrëveshje për grumbullim dhe transportim të hedhurinave të rrezikshme (neni 65);
- 21) nuk vepron në pajtim me dispozitat nga neni 68 i këtij ligji;
- 22) nuk vepron në pajtim me dispozitat nga neni 69 i këtij ligji;
- 23) kryen qarkullim të pajisjes elektrike dhe elektronike që përmban plumb, zhivë kadmium, krom gjashtëivalent, polibromide, bifenile të polibromuara ose difeniletere të polibromuar (neni 71-a);
- 24) nuk ia dorëzon automjetin e shfrytëzuar personit juridik ose fizik që posedon leje për grumbullim, trajtim ose përpunim në pajtim me këtë ligj dhe rregull tjetër (neni 72 paragrafi (3));
- 25) mënjanon ose dorëzon komponente dhe materiale nga automjetet e shfrytëzuara si hedhurina komunale (neni 72 paragrafi (5));
- 26) nuk vepron në pajtim me dispozitat nga neni 72 paragrafët (2) dhe (6) të këtij ligji;
- 27) nuk mban evidencë, përkatësisht nuk e dorëzon në mënyrë të përcaktuar në pajtim me nenin 72 paragrafi (7) të këtij ligji;
- 28) nuk vepron në pajtim me dispozitat nga neni 72 paragrafi (9) i këtij ligji;
- 29) me hedhurina medicinale vepron në kundërshtim me nenin 73 të këtij ligji;
- 30) mënjanon hedhurina nga titaniumdioksidi (neni 74);
- 31) nuk vepron në mënyrë të përcaktuar me nenin 75-a të këtij ligji;
- 32) nuk vepron në mënyrë adekuate me hedhurinat nga azbesti dhe me prodhime të cilat përbajnë azbest, si dhe me hedhurinat e krijuara gjatë veprimtarive shkencore-hulumtuese (nenet 75 dhe 76) dhe
- 33) nuk kryen mbikëqyrje të hedhurinave të rrezikshme dhe nuk i dorëzon të dhënat në organet kompetente (nenet 108 dhe 111).

(4) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik që vepron me hedhurinë për veprimet nga paragrafi (3) pikat 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 22, 23, 27, 29 dhe 30 të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 400 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili vepron me hedhurina, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili vepron me hedhurina për veprimet nga paragrafi (3) i këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit juridik të autorizuar që teknikisht e zbaton provimin professional, nëse nuk e incizon, nuk e emiton drejtpërdrejt në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse nuk e vendos incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor (neni 38-x paragrafi (3)).

(8) Gjobë në shumë prej 4 000 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik të autorizuar, i cili e realizon provimin professional, nëse nuk e ndërpret provimin në rastet nga nen 38-i, paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

(9) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet përfaqësuesit të autorizuar nga nen 38-x paragrafi (5) nëse vepron në kundërshtim me nenin 38-i paragrafi (9) i

këtij ligji.

(10) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse nuk e miraton aktvendimin në afatin e përcaktuar në nenin 38-t paragrafi (7) të këtij ligji.

(11) Personit përgjegjës nga paragafët (5) dhe (6) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerje të detyrës në kohëzgjatje prej tre deri në pesëmbëdhjetë ditë.

(12) Për veprimet nga paragrafi (1) pika 4, 11, 13 dhe 19, nga paragrafi (3) pikat 7 dhe 22 e këtij neni, përvèç organeve të mbikëqyrjes së inspektimit nga neni 126 të këtij ligji, të drejtë dhe detyrim për shikim ka edhe punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme.

(13) Në rastet nga paragrafi (12) nga ky nen punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme, është i detyruar që për inspektimin nga mbikëqyrja t'i dërgojë fletëparaqitje për ngritjen e procedurës për kundërvajtje inspektorit kompetent për mjedisin jetësor.

(14) Organ kompetent për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje dhe për shqiptimin e kundërvajtjeve nga ky nen është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për ambientin jetësor.

## Neni 140

### Sanksione për kundërvajtje për grumbulluesit dhe për transportuesit e hedhurinave

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili grumbullon dhe transporton hedhurina të parrezikshme, nëse:

- 1) grumbullimi dhe transportimi i hedhurinave bëhet në kundërshtim me dispozitat nga neni 27 paragrafë (3), (4), (5), dhe (6) të këtij ligji;
- 2) kryen grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave komunale dhe/ose hedhurinave tjera të parrezikshme në kundërshtim me dispozitat nga neni 45 i këtij ligji, si edhe kryen transport të hedhurinave komunale dhe/ose hedhurinave tjera të parrezikshme në automjete të pashënuara (neni 45).
- 3) kryen grumbullim dhe transportim të hedhurinave komunale dhe/ose hedhurinave tjera të parrezikshme pa posedim të lejes (neni 45)
- 4) bëjnë grumbullimin pa poseduari leje dhe pa pranim të kthyer të prodhimeve të shfrytëzuara dhe të paketuara (neni 51);
- 5) nuk e grumbullon dhe nuk e transporton hedhurinën e rrezikshme veças nga llojet e hedhurinave të tjera (neni 57);
- 6) transporton hedhurina të rrezikshme të cilat nuk janë paketuar dhe shënuar në mënyrë adekuate (neni 64);
- 7) hedhurina e cila transportohet nuk u përgjigjet të dhënavë të theksuara në formular identifikues (nenet 60 dhe 56);
- 8) nuk ia dorëzon ekzemplarin nga formulari i identifikimit për hedhurinat e rrezikshme organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor (neni 60);
- 11) të dhënat për hedhurinën e rrezikshme nuk ua parashtron një herë në vit Ministria së Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (nenet 39 dhe 60); dhe **20**
- 12) grumbullimin dhe transportin e hedhurinave të rrezikshme e bën pa leje (neni 66).

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili grumbullon dhe transporton hedhurina të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) nga ky nen.

(3) Gjobë në shumë prej 600 euro me kundërvlerë në denarë do t'i

shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili grumbullon dhe transporton hedhurina të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili grumbullon dhe transporton hedhurina të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(5) Personit juridik për kundërvajtje nga ky nen, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 3 deri në 15 ditë.

(6) Personit përgjegjës nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e detyrës, në kohëzgjatje prej 3 deri 15 ditë.

(7) Organi kompetent për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje dhe për shqiptimin e kundërvajtjeve nga ky nen është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 141

### Sanksione për kundërvajtje për përpunuesit e hedhurinave

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili përpunon hedhurina të parrezikshme nëse:

- 1) nuk përgatit program për administrim me hedhurina (neni 21);
- 2) përpunimin e hedhurinave e bën në kundërshtim me nenin 28 nga ky ligj dhe nuk i zbaton operacionet nga neni 29 të këtij ligji;
- 3) përpunon hedhurina pa posedimin e lejes (neni 32);
- 4) ndërmerr hedhurina për përpunim, të cilat nuk u përgjigjen të dhënavë të theksuara në formularin identifikues (nenet 56 dhe 61);
- 5) nuk u paraqet ekzemplar nga formulari identifikues për hedhurina organeve kompetente (nenet 56 dhe 61);
- 8) nuk bën monitorim për përpunimin e hedhurinës (neni 108) **[21]**

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili përpunon hedhurinë të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili përpunon hedhurina të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 700 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili përpunon hedhurina të parrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) nga ky nen.

(5) Kryerësit të kundërvajtjes nga ky nen, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 3 deri në 15 ditë.

(6) Personit përgjegjës nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej 3 deri në 15 ditë.

(7) Organi kompetent për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje dhe për shqiptimin e kundërvajtjeve nga ky nen është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 142

### Sanksionet për kundërvajtje për mënjanimin e

## **hedhurinës**

(1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri në 12.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron me hedhurinë të parrezikshme, nëse:

- 1) nuk përpunon program për administrim me hedhurinë (neni 21);
- 2) nuk e mënjanon hedhurinën e parrezikshme në vendet, në objektet ose në instalimet e parapara për atë qëllim, si dhe hedhurinën që nuk i është nënshtuar trajtimit (neni 43);
- 3) e mënjanon hedhurinën e rrezikshme pa zbatimin e operacioneve nga neni 35 i këtij neni;
- 6) nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për plehërishtë (nenet 79 dhe 80)
- 22**
- 7) nuk posedon leje për operator të plehërishtave (neni 84);
- 8) mënjanon hedhurinë e cila nuk është e pranueshme në plehërishtë (neni 87);
- 9) pranon hedhurinë e cila nuk i përket klasës së plehërishtës (neni 88);
- 10) nuk e përcjell ndikimin e punës së plehërishtës në mjedisin jetësor dhe nuk e informon organin kompetent për këtë (neni 91);
- 11) plehërishta ndërpret punën pa aktvendim përkatës (neni 92);
- 12) nuk kujdeset për plehërishtën pas ndërprerjes së saj me punë (neni 93);
- 13) nuk i zbaton udhëzimet për mbylljen dhe për kujdesin ndaj plehërishtës pas mbylljes së saj (neni 93);
- 14) kryen ndezjen dhe djegien e hedhurinave pa leje (neni 98);
- 15) nuk posedon leje për ndezje e djegie (neni 99);
- 16) nuk refuzon djegien e hedhurinës që nuk është përkatëse dhe nuk i ruan ekzemplaret nga hedhurina (neni 100); dhe
- 17) nuk e përcjell programin për punë, monitorim dhe kontroll të objektit ose të instalimeve për mënjanimin e hedhurinës (nenet 108 dhe 109).

(2) Gjobë në shumë prej 12.000 euro deri në 20.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron me hedhurina të rrezikshme, nëse:

- 1) nuk përpunon program për administrim me hedhurina (neni 21);
- 2) nuk e mënjanon hedhurinën e rrezikshme në vendet, në objektet ose në instalimet e parapara për atë qëllim, si dhe hedhurinën që nuk i është ekspozuar trajtimit (neni 34);
- 3) e mënjanon hedhurinën e rrezikshme pa zbatimin e operacioneve nga neni 35 të këtij ligji;
- 4) e ndërmerr hedhurinën e rrezikshme për mënjanimin, e cila nuk u përgjigjet të dhënave të shënuara në formularin identifikues (nenet 56 dhe 61);
- 5) nuk i dorëzon ekzemplar nga formulari i identifikimit organit kompetent (nenet 56 dhe 61);
- 6) nuk mban evidencë dhe nuk i ruan të dhënat nga evidencat për llojin dhe për sasinë e mënjanuar të hedhurinës së rrezikshme (nenet 39 dhe 61);
- 7) një herë në vit nuk ia paraqet të dhëna nga evidanca organit kompetent (nenet 39 dhe 61);
- 8) nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për plehërishtë (nenet 79 dhe 80);
- 9) nuk posedon leje për operator të plehërishtës (neni 84);
- 10) mënjanon hedhurina që nuk janë të pranueshme në plehërishtë (neni 87);
- 11) pranon hedhurinë që nuk i përket klasës së plehërishtës (neni 88);
- 12) nuk e përcjell ndikimin e punës së plehërishtës ndaj mjedisit jetësor dhe nuk e informon organin kompetent për këtë (neni 91);
- 13) plehërishta ndërpret punën pa aktvendim përkatës (neni 92);
- 14) nuk kujdeset për plehërishtën pas ndërprerjes së saj me punë (neni 93);
- 15) nuk i zbaton udhëzimet për mbylljen dhe për kujdesin ndaj plehërishtës pas mbylljes së saj (neni 93);
- 16) kryen ndezje dhe djegie të hedhurinave pa leje (neni 98);
- 17) nuk posedon leje për ndezje e djegie (neni 99);
- 18) nuk refuzon djegie për hedhurina të cilat nuk i përkasin dhe nuk i

ruajnë ekzemplarët nga hedhurinat (neni 100); dhe  
19) nuk e zbaton programin për punë, monitorim dhe kontroll të objektit  
ose të instalimeve për mënjanimin e hedhurinës (nenet 108 dhe 109).

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 deri 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili vepron me hedhurinë të parrezikshme për veprimet nga paragrafi (1) nga ky nen.

(4) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i cili vepron me hedhurinë të rrezikshme për veprimet nga paragrafi (2) nga ky nen.

(5) Kryerësit të kundërvajtjes nga ky nen, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje së paku prej një viti deri në më së shumti tri vjet.

(6) Personit përgjegjës nga paragrafët (3) dhe (4) nga ky nen, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion për kundërvajtje - ndalim për kryerjen e detyrës në kohëzgjatje prej më pak një vit ose më shumë prej dy vjet.

(7) Organ kompetent për shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtje nga ky nen është gjykata kompetente.

## **Neni 142-a**

### **Sanksione për kundërvajtje për persona fizikë**

(1) Gjobë në shumë prej 60 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nëse lë, gjuan dhe/ose lëshon hedhurina, bishta të cigares, bateri dhe akumulatorë, hedhurina të mëdha (aparate të amvisërisë, mobilie dhe të ngashme), mbeturina, materiale dhe komponente nga automjetet e përdorura në natyrë dhe/ose në rrugë (neni 24-a).

(2) Gjobë në shumë prej 70 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nëse lë, gjuan dhe/ose lëshon vajra të hedhurinave, hedhurina nga materiale të ndërtimitarisë, goma të hedhurinave në natyrë dhe/ose në rrugë (neni 24-a).

(3) Gjobë në shumë prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për veprimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse ato janë lënë, hedhur dhe/ose lëshuar afër trupave ujore dhe/ose në trupat ujore (lumenj, liqene, këneta, moçale dhe të ngashme).

(4) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për kundërvajtje, nëse:

1) mënjanon (djeg dhe/ose gropon) goma të hedhurinave, vajra të hedhurinave, hedhurina në natyrë dhe/ose në rrugë (neni 24-a).

(5) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, inspektorët e mjedisit jetësor dhe inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunës, të komunës në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, si dhe punëtori i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, mund të shqiptojnë gjobë aty për aty me dorëzim të ftesës për arkëtimin e gjobës, të cilën kryerësi është i obliguar që ta paguajë në afat prej tetë ditësh nga dorëzimi i ftesës në shumë prej 50 për qind nga gjoba e përcaktuar në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(6) Nëse gjoba nga paragrafi (5) i këtij neni nuk paguhet në afatin e përcaktuar, personat nga paragrfi (5) i këtij neni janë të obliguar që të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para Komisionit për kundërvajtje.

(7) Organ kompetent për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje dhe

për shqiptimin e kundërvajtjeve nga ky nen është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton formën dhe përbajtjen e ftesës për arkëtimin e gjobës nga paragafi (5) i këtij neni.

### **Nen 142-b**

#### **Sanksione për kundërvajtje për persona zyrtar**

Sanksionet për kundërvajtje për personat zyrtarë të cilët janë përgjegjës për realizimin e këtij ligji shqiptohen në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

### **Neni 142-v**

#### **Procedura për barazim dhe ndërmjetësim**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 139, 140 dhe 141 nga ky ligj, organet nga neni 126 të këtij ligji janë të detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të dorëzojnë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 142 të këtij ligji, inspektorët për mjedisin jetësor inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor kryerësit të kundërvajtjes mund t'i ofrojnë ndërmjetësim dhe arritjen e pajtimit me të cilën kryerësi i kundërvajtjes duhet ta paguajë gjobën, detyrimet tjera ose t'i mënjanjojë pasojat nga kundërvajtja.

(3) Në rastet në të cilat është arritur pajtueshmëria për barazim ose ndërmjetësim, gjoba kryerësit mund t'i zgjedohet më së shumti për një gjysmë të maksimumit të gjobës së përcaktuar për kundërvajtjen.

(4) Procedurat për barazim dhe ndërmjetësim mbahen në pajtim me dispozitat nga Ligji për mjedisin jetësor."

### **Neni 142-g**

#### **Mbajtja e procedurës për kundërvajtje**

Procedura para komisionit për kundërvajtje mbahet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor.

### **XIV DISPOZIAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 143**

(1) Strategja nga neni 16 i këtij ligji do të miratohet në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Plani nga neni 17 i këtij ligji do të miratohet në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(3) Programet për menaxhim me hedhurinat nga nenet 19, 20 dhe 21 të këtij ligji miratohen në afat prej një viti nga dita e miratimit të planit nga paragafi (2) të këtij neni.

### **Neni 144**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, prefektët e komunave dhe prefekti i Qytetit të Shkupit, do

t'i marrin të gjitha masat e domosdoshme për mbylljen e plehërishteve, të cilat nuk posedojnë leje për kryerjen e veprimtarisë së mënjanimit të hedhurinave.

(2) Prefekti i komunave dhe prefekti i Qytetit të Shkupit në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të obliguar t'i mbyllin dhe rikultivojnë plehërishtet e egra.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, me akt të veçantë do ta rregullojë mënyrën e punës dhe veprimit me lokacionet ekzistuese për mënjanimin e hedhurinave, si dhe do t'i përcaktojë lokacionet e përkohshme për mënjanimin e hedhurinave deri në periudhën e ndërtimit të plehërishteve.

### **Neni 145**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët i kryejnë veprimtaritë e menaxhimit me hedhurinat, janë të obliguar ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji, në afat prej tre viteve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë të obliguar të posedojnë leje për kryerjen e veprimtarisë, janë të obliguar ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji, në afat prej tre viteve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 146**

(1) Dispozitat më të përafërtë për zbatimin e këtij ligji do të miratohen në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nga paragrafi 1 i këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

### **Neni 147**

Me ditën e zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për hedhurina ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 37/98 dhe 16/2004) dhe dispozitat e neneve 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 19 paragrafi 2, 3, 4 neni 20, 21 paragrafi (1) alineja 3,4 dhe 5 dhe neni 22 paragrafi (1) alineja 3,4 dhe 5 nga Ligji për mirëmbajtjen e higjenës publike, grumbullimin dhe transportimin e hedhurinës së fortë komunale dhe teknologjike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 37/98).

### **Neni 148**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa zbatohet nga dita e konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektive të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit, pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë" numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).

#### **DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË**

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë" nr. 107/2007):

#### **Neni 60**

Dispozitat më të përafërtë për zbatimin e këtij ligji do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 102/2008):

**Neni 5**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Dekreti për përcaktimin e materialeve dhe të sendeve që janë në përdorim të përgjithshëm, e të cilat kryerësit e veprimtarisë tregti me hedhurina të parrezikshme nuk guxojnë t'i grumbullojnë nga grumbulluesit individual i hedhurinave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 115/2007).

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 143/2008):

**Neni 31**

Procedurat për kundërvajtje të filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për menaxhim me mbeturina ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 71/2004, 107/2007 dhe 102/2008).

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2010):

**Neni 19**

Dispozitat më të përafërtë të këtij ligji do të miratohen deri më 30 qershori 2011.

Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij nenit do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2010):

**Neni 20**

Dispozitat nga nenit 6 paragrafët (3), (4), (5) dhe (7) të këtij ligji, me të cilin ndryshohet nenit 38 i Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 68/2004, 107/2007, 102/2008 dhe 143/2008), do të zbatohen nga 30 qershori 2011.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011):

**Neni 17**

Rregullat më të përafërtë nga nenit 3, 5, 6, 11 dhe 16 të këtij ligji, do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

**Neni 18**

Planet rajonale për menaxhim me hedhurina nga nenit 1 i këtij ligji, këshillat e komunave nga rajoni përkatës, përkatësisht këshilli i qytetit të Shkupit, do t'i miratojnë më së voni në afat prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011):

**Neni 19**

Dispozitat e nenit 4 të këtij ligji do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror

për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë. Dispozitat e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 123/2012):

### **Neni 33**

Komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit detyrohen që të bashkohen dhe të lidhin marrëveshje për bashkim për themelim të menaxhimit me hedhuria në nivel rajonal më së voni deri më 30 dhjetor 2012.

Komunat dhe Qyteti i Shkupit detyrohen që Këshillin ndërkomunal për menaxhim me hedhurina ta formojnë më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita kur e kanë lidhur marrëveshjen për bashkim për themelim të menaxhimit me hedhurina në nivel rajonal.

Komunat dhe Qyteti i Shkupit detyrohen të themelojnë Qendër rajonale në afat prej nëntë muajsh nga dita kur e kanë lidhur marrëveshjen për bashkim për themelim të menaxhimit me hedhurina në nivel rajonal.

### **Neni 34**

Personat fizikë dhe juridikë të cilët kryejnë veprimtari të magazinimit, trajtimit dhe/ose përpunimit të hedhurinave, si dhe tregti me hedhurina të parrezikshme detyrohen që ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 35**

Rregullat më të përafërtë të këtij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 147/2013):

### **Neni 18**

Lejet për tregti me hedhurina të parrezikshme të lëshuara në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/10, 51/11 dhe 123/12), do të vazhdojnë të vlejnë në afat prej gjashtë muajsh duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas skadimit të afatit nga paragrafi (1) të këtij nenit, lejet e lëshuara për tregti me hedhurina të parrezikshme shfuqizohen.

### **Neni 19**

Procedurat e filluara për lëshimin e lejeve për tregti me hedhurina të parrezikshme, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërpriten për çfarë organi kompetent për kryerje të punëve profesionale në mjedisin jetësor i njofton parashtruesit e kërkeseve për lëshim të lejeve për tregti me hedhurina të parrezikshme në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

### **Neni 5**

Personi fizik që ka dhënë provimin profesional para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të parashtrojë kërkësë për

regjistrim në Regjistrin e menaxhuesve me hedhurina në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji. Personi nga paragrafi 1 i këtij nenit, me kërkesën të shtetërore obliguar ta parashtron dokumentacionin e nevojshëm për dëshmim se e ka dhënë provimin profesional. Organi i administratës shtetërore kompetent për punë nga sfera e mjedisit jetësor në afat prej 30 ditësh nga parashtrimi i kërkuesës në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij nenit, nëse i plotëson kushtet, i lëshon certifikatë dhe e evidenton personin si menaxhues me hedhurina në Regjistrin e menaxhuesve me hedhurina.

#### **Neni 6**

Sistemi elektronik për dhënie të provimit profesional vendoset në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 7**

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji e themelon Regjistrin e menaxhuesve me hedhurina.

#### **Neni 8**

Procedurat e filluara për dhënie të provimit profesional përmarrje të statusit të menaxhuesit me hedhurina deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të rregullave sipas të cilave kanë filluar.

#### **Neni 9**

Aktet nënligjore të këtij ligji do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me hedhurinat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

#### **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse nenet 1 dhe 2 do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e dispozitat nga neni 3 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.

